



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 61/2020 (JR)  
Datë 18.12.2020

Vendim nr. 3 (JR)  
Datë 06.02.2023

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Albana Shtylla</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Relatore</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 06.02.2023, ditën e hënë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Tritan Hamitaj, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 297, datë 17.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet C/5, D dhe F të Aneksit, neni 179/b, pikat 5, 6, 145. Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 1, 3, 63 dhe 66, pika 1, germa “b”. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, nenet 6, 7, 13 dhe 14. Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, nenet 47, 48 pika 1, 49, 51 dhe 55.

**Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Tritan Hamitaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Durrës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe përfundoi hetimin administrativ vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë.
3. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, arriti në konkluzionet, si më poshtë.
  - 3.1 Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
  - 3.2 Subjekti i rivlerësimit nuk ka justifikuar me burime të ligjshme blerjen e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të tij apo të personave të lidhur me të, dhënien e huave prej tij apo të personave të lidhur me të të tretët, aftësinë financiare të të tretëve për kthimin e huave, krijimin e likuiditeteve prej tij apo e personave të lidhur me të, si dhe mbulimin e shpenzimeve prej tij apo të personave të lidhur me të për periudhën e rivlerësimit, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
  - 3.3 Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti prova dhe nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe pasurive të tij, sipas pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
  - 3.4 Subjekti i rivlerësimit në mënyrë të përsëritur ka ndryshuar deklaramin e tij nga deklarata *Vetting*, në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit, si dhe në parashtrimet përfundimtare, duke lindur dyshimet për deklaram të rremë, në kuptim germës “ç”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
  - 3.5 Komisioni, në vlerësimin e tij, mban parasysh qëndrimin jobashkëpunues të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore gjatë procesit administrativ, duke iu përgjigjur në mënyra të ndryshme pyetjeve të njëjta të drejtuara nga Komisioni për çështje të caktuara, për të cilat është kërkuar një shpjegim prej tij ose është shmangur nga përgjigjja. Subjekti i rivlerësimit ka cenuar, qoftë edhe vetëm me këtë mënyrë sjelljeje, besimin e publikut te një funksionar i drejtësisë, i cili duhet të karakterizohet nga sjellja e denjë, serioze dhe e sinqertë, jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe gjatë zbatimit të detyrimeve të tij përgjatë këtij procesi.
4. Në përfundim, bazuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 297, datë 17.09.2020, Komisioni vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Tritan Hamitaj, gjyqtar në Gjykatën të Apelit Durrës.*

## II. Shkaqet e ankimit të subjekti i rivlerësimit

5. Kundër vendimit nr. 297, datë 17.09.2020, të Komisionit ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit duke kërkuar: (i) prishjen e vendimit të Komisionit; (ii) konstatimin e pavlefshmërisë së procedurës së hetimit administrativ, seancës dëgjimore, vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare të Komisionit; (iii) kryerjen e hetimit gjyqësor nga fillimi për të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe marrjen e provave të kërkuara nga subjekti i rivlerësimit dhe provave të reja; (iv) korrigjimin e gabimeve procedurale, duke gjykuar çështjen në seancë gjyqësore publike; (v) pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, për shfuqizimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016; si dhe (vi) konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Tritan Hamitaj, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.
6. Ankimi i subjektit të rivlerësimit përmban shkaqe procedurale, të cilat në mënyrë të përmbledhur lidhen me pretendime për cenim të procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”), nenit 42, pika 2 dhe nenit 179/b, pika 2 e Kushtetutës, për sa i përket: (i) formimit të trupit gjykues të Komisionit dhe të drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj; (ii) marrjen pjesë të vëzhguesit ndërkombëtar dhe përkthyesit në vendimmarrjet e Komisionit, duke prekur privatësinë e dhomës së këshillimit; (iii) si dhe cenimin e parimit të paanësisë dhe pavarësisë, lidhur me përbërjen e trupit gjykues dhe zgjedhjen e anëtarëve në kundërshtim me ligjin. Në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, subjekti i rivlerësimit pretendon se procedura e hetimit dhe gjykimit, si dhe aktet/vendimet e prodhuara nga Komisioni për këtë çështje janë të pavlefshme.
7. Shkaqet e ankimit, lidhur më kriterin e vlerësimit të pasurisë, në mënyrë të përmbledhur konsistojnë si vijon.

### 7.1. Për pasurinë, tokë arë ndodhur në fshatin {\*\*\*}, Mallakastër

- i. Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë në deklaratën e pasurisë *vetting* përfitimin e tokës bujqësore, si dhe nuk ka depozituar Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (në vijim “AMTP”), lëshuar në emër të gjyshit të tij së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*, është i pavërtetë dhe në kundërshtim me provat e administruara.
- ii. Dyshimet e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka fshehur këtë AMTP, me qëllim justifikimin e pronësisë së kësaj pasurie në emër të familjarëve të tij, duke përjashtuar trashëgimtarët e tjerë të H. dhe L. H., janë të pabazuara dhe kontradiktore. Regjistrimi i bashkëpronarëve të tokës bujqësore në 1/6 pjesë takuese secili dhe jo në 1/8 është përgjegjësi e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, Zyra Mallakastër (në vijim “AShK Mallakastër”) dhe nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, i cili nuk ka kryer asnjë ndikim formal apo jo formal dhe as ka pretenduar se ka 1/6 pjesë të kësaj pasurie.
- iii. Konkluzioni i Komisionit, lidhur me vreshtin dhe mbjelljen e 150 rrënjëve ullinj, vjen në kundërshtim me nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parimin e objektivitetit, sigurisë juridike dhe fuqisë prapavepruese të ligjit. Subjekti i rivlerësimit nuk disponon dokumentacion mbi shpenzimet e kryera e, për pasojë, nuk mund të deklarojë një vlerë të saktë të tyre. Shpenzimet janë kryer kohë më parë, përpara se subjekti të ushtronte detyrën e gjyqtarit dhe përpara se t’i lindte detyrimi për deklarimin e pasurisë, rrethana që kanë ndikuar në mosmbajtjen e dokumentacionit provues për një pjesë të tyre.
- iv. Në kundërshtim me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka cilësuar subjektin si jobashkëpunues, ndërkohë që subjektit të rivlerësimit nuk i ka munguar gatishmëria për të paraqitur dokumente e as nuk ka pasur qëllim për të vënë në vështirësi Komisionin në kryerjen e detyrës, por ndodhej në kushtet e pamundësisë objektive për t’i dokumentuar ato.

v. Komisioni, në zbatim të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, duhet të kishte kryer aktin e ekspertimit agronomik, kërkesë e refuzuar me arsyetimin, sipas nenit 49, pika 6, germat “a” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016. Një pjesë e shpenzimeve janë bërë nga familja, si punime me krahë, mbjellje, ujitje, krasitje, në pamundësi të dokumentohen. Edhe nëse do të ishte operuar si tregtar apo shoqëri tregtare, në bazë të nenit 48 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (në vijim “ligji nr. 9920/2008”), detyrimi për të ruajtur dokumentacionin tatimor është maksimumi 5 vjet, afat i cili ka kaluar. Në pamundësi të përcaktimit të shpenzimeve, Komisioni mund t’i referohej aktit të ekspertimit agronomik të depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

vi. Barra e provës dhe konkluzioni i Komisionit, për të deklaruar shpenzimet e mbjelljes së vreshtit dhe ullinjve, vjen në kundërshtim me nenin A dhe nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, ligjin dhe është jo proporcional dhe objektiv. Kushtetuta dhe ligjet e dala në zbatim të saj e kanë ngarkuar subjektin me detyrimin për të deklaruar pasurinë dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe jo të shpenzimeve.

vii. Konkluzioni i Komisionit, lidhur me të ardhurat nga toka bujqësore, vreshti dhe ullinjtë, është i gabuar dhe në kundërshtim me ligjin, parimin e proporcionalitetit, objektivitetit, pa arsyetuar provat dhe shpjegimet e subjektit. Arsyetimi i Komisionit se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe kanë karakter deklarativ të pashoqëruar me dokumentacion provues është i paplotë, pasi duhej arsyetuar se cilat janë dokumentet ligjore që krijohen nga veprimtaria e fermerit, me të cilat dokumentohet shitja e produkteve bujqësore, sasia, mënyra e shitjes, si dhe shuma e përfituar. Veprimtaria e fermerit nuk është e rregulluar me asnjë akt ligjor ose nënligjor lidhur me ruajtjen e dokumentacionit të kësaj veprimtarie, punuar çdo vit, shpenzimet për punimin e mbjelljen, deri në shitjen e produktit, nëse fermeri shet.

viii. Komisioni duhet të kishte vlerësuar pamundësinë objektive të subjektit për të disponuar dokument mbi të ardhurat nga toka bujqësore dhe në përputhje me nenin 49 të ligjit nr. 84/2016, duhet të kryente aktekspertimin e jo të refuzonte kërkesën e tij. Familja e subjektit nuk ka ushtruar veprimtari tregtare që të detyrohej të ruante dokumentacion.

ix. Komisioni nuk mori në konsideratë deklaratat periodike 2005-2016, në të cilat pasqyrohen të ardhurat nga toka bujqësore, dokumente me vlerë provuese, sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në harmoni me të gjitha provat e tjera të administruara. Këto të ardhura mund të ishin vlerësuar për të përballuar shpenzimet e jetesës, pasi do të ishte absurditet të vlerësohen zero.

x. Dokumente indirekte që toka është punuar është pagesa e taksës së tokës çdo vit. Nëse toka do të ishte lënë *djerrë* nuk kishte arsye të paguhej taksa e tokës dhe bashkia do të kishte marrë masa për dhënien me qira të saj. Fakt tjetër provues që prindërit e tij kanë jetuar dhe punuar në fshatin {\*\*\*}, deri në daljen e tyre në pension, është vërtetuar me përgjigjen e ISSh-së dhe me certifikatën e gjendjes civile. Të dhëna të mjaftueshme këto për të qenë objektiv dhe të bindur se toka bujqësore ka krijuar të ardhura.

xi. Ullinjtë dhe vreshti gjenerojnë të ardhura, fotot e tyre të marra si provë nga Komisioni tregojnë ekzistencën e tyre dhe aktekspertimi agronomik pasqyron gjendjen, sipërfaqen, moshën dhe ekzistenca e tyre provohet me ortofoto, googlemap e të dhëna të tjera në internet. Nëse Komisioni nuk bindej për ekzistencën e tyre, e cila është e pamohueshme, mund t’i këqyrte në vend.

xii. Është keqinterpretuar qëndrimi i subjektit se kjo veprimtari, drejtuar nga babai, *nuk ka pasur asnjëherë natyrë si veprimtari ekonomike për të nxjerrë fitim*, ndërkohë që është thënë me qëllim për të diferencuar statusin e fermerit nga ai i tregtarit, për efekt të procedurave tatimore në lidhje me mbajtjen e dokumentacionit.

xiii. Aktekspertimi agronomik, në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat nga toka bujqësore, ullinjë dhe vreshti, duhet të ishte marrë si provë dhe prej Komisionit. Të ardhura të tilla janë një praktikë gjyqësore në gjykatat në vend për të llogaritur dëmin e shkaktuar nga prishja e tokës bujqësore shkaktuar nga ndotja e naftës në zonën e qarkut të Fierit. Praktika gjyqësore tashmë është kthyer në pritshmëri normale për të ardhmen për çdo fermer për të nxjerrë vlerën e dëmshpërblimit nëse toka i dëmtohet dhe të arrihet përfundimi sesa janë të ardhurat që mund të nxirren prej saj po të punohej nga fermeri.

xiv. Ekspertja R. M. ka kryer shumë akte për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe nga informacioni rezulton se ka bërë ekspertime të ngjashme në disa gjykime<sup>1</sup>, për të cilat i ka kërkuar Komisionit të marrë si provë disa prej vendimeve gjyqësore<sup>2</sup>.

xv. Të ardhurat nga toka bujqësore, ullinjë dhe vreshti nga viti 1991 e në vazhdim, Komisioni duhet t'i përfshinte, sipas aktit të ekspertimit agronomik dhe për vitet që të ardhurat janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore të llogariten, sipas deklaramit, në të kundërt Komisioni nuk duhet të kishte llogaritur shpenzimet e jetesës së subjektit dhe të prindërve të tij nga viti 1991 e në vazhdim ose t'i kishte llogaritur ato sipas praktikës<sup>3</sup> së tij.

## 7.2. Për pasurinë, apartament me sipërfaqe 86,18 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Durrës

i. Mospërfshirja e të ardhurave të prindërve si burim është në kundërshtim me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe parimin e sigurisë juridike. Në të ardhura të tjera familjare të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* përfshihen edhe të ardhurat e prindërve. Pasaktësia e mosdeklarimit të të ardhurave të tyre në deklaratën e pasurisë *vetting* është rregulluar gjatë hetimit administrativ, në përputhje me paragrafin e tretë, të nenit D të Kushtetutës.

ii. Burimet e deklaruar në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim të vitit 2003 nuk janë shteruese, pasi në të mungojnë burime të ardhurash të pakontestueshme, si ato nga punësimi i subjektit të rivlerësimit të provuara me dokumentacion justifikues ligjor, depozitat në “ProCredit Bank” ShA, si dhe të ardhurat nga toka bujqësore.

iii. Fakti që nga muaji maj 1998 nuk ka jetuar me prindërit nuk bie në kundërshtim me deklaramet e qëndrimet e subjektit dhe nuk sjell ndryshim për të vlerësuar prindërit si persona të lidhur para datës 06.05.2002. Largimi nga vendbanimi, për arsye pune apo studimi, nuk ndryshon ekzistencën e të qenit një familje, në një ekonomi të përbashkët me prindërit, traditë kjo e vendit tonë.

iv. Depozitat në “ProCredit Bank” ShA kanë qenë nga të ardhurat e të gjithë familjes dhe me tërheqjen e shumave monetare ka filluar ndarja nga ekonomia e përbashkët, *de facto*, në janar dhe ka përfunduar në maj të vitit 2002. Shumat e depozituara në “ProCredit Bank” përbëjnë gati dyfishin e çmimit të blerjes së apartamentit.

v. Konkluzioni i Komisionit se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 2.977.421 lekë, për krijimin e depozitave në vitet 2000-2001, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit, është i gabuar, në kundërshtim me parimin e

<sup>1</sup> Në proceset gjyqësore me: (i) paditës A. Sh., i paditur Bashkia {\*\*\*}; (ii) paditës A. K., i paditur Q. K.; (iii) paditës V. D., i paditur Bordi {\*\*\*} Fier, janar 2017; (iv) paditës V. N., i paditur {\*\*\*} ShA, janar 2019; (v) paditës M. A., Xh. Ç., A. A., i paditur B. K., S. K.; (vi) paditës A. N., i paditur Komuna {\*\*\*}, Fier, shoqëria {\*\*\*}, {\*\*\*} ShPK, etj.

<sup>2</sup> Vendim nr. {\*\*\*}, datë 07.12.2016, vendim nr. {\*\*\*}, datë 09.07.2012, vendim nr. {\*\*\*}, datë 15.12.2017, vendim nr. {\*\*\*}, datë 18.07.2018, vendim nr. {\*\*\*} datë 27.02.2019 dhe vendim nr. {\*\*\*}, datë 07.07.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>3</sup> Shih vendimet nr. 234, datë 20.02.2020, nr. 191, datë 26.07.2019 dhe nr. 241, datë 26.02.2020, të Komisionit.

proporcionalitetit, objektivitetit, ligjit dhe provat e administruara.

vi. Në përlllogaritje duhet të përfshihen shpërblimet e fundvitit të subjektit të rivlerësimit deri në vitin 2004, të cilat kanë qenë të konsiderueshme, madje deri në masën e një page, të cilat nuk evidentohen, pasi paga deri në vitin 2005 jepej *cash* dhe nuk janë përfshirë në analizën e Komisionit, si dhe shpërblimet nga marrëdhëniet e punës së prindërve deri më 06.05.2002.

vii. Mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting* i shumës së të ardhurave nga firmat piramidale dhe trashëgimisë nuk sjell përjashtimin e tyre. Të ardhurat nga firmat piramidale dhe trashëgimia janë deklaruar në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim të vitit 2003. Për këto të ardhura, subjekti, jo për faj të tij, nuk disponon dokumente. Këto të ardhura janë krijuar në një kohë të largët, kur nuk kishte statusin e subjektit deklarues, rrethana që kanë ndikuar në mosmbajtjen e dokumenteve e që Komisioni duhet t'i vlerësonte në bazë të parimit të proporcionalitetit.

viii. Të ardhurat nga emigracioni janë deklaruar në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim vitit 2003 dhe kanë qenë të depozituara në sistemin bankar që në vitin 2001-2002, duke shuar çdo dyshim për abuzim nga subjekti me burimin e të ardhurave vetëm në funksion të deklarimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, çka i bën ato të besueshme e të provueshme. Prova të cilat nuk janë analizuar dhe arsyetuar nga Komisioni. Saktësimi i të ardhurave nga emigracioni në shumën 1.400.000 lekë është bërë gjatë hetimit administrativ, gjë që nuk përbën arsye ligjore për mospërfshirjen e tyre në analizën financiare, derisa nuk është dhënë vendimi.

ix. Në vlerësim të subjektit duhet të mbaheshin në konsideratë disa rrethana që i bëjnë këto të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, informaliteti i ekonomisë shqiptare, remitancat të pashoqëruara me burime ligjore nga punëdhënësit dhe të pataksuara në Shqipëri, licencimi i bankave të nivelit të dytë në vitin 1999, pagesat nëpërmjet sistemit bankar pas vitit 2002 etj.

### *7.3. Për pasurinë, apartament me sipërfaqe 78,24 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Durrës*

i. Konkluzioni i Komisionit se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie dhe konstatimi se ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri është i gabuar, në kundërshtim me ligjin dhe parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit dhe mosdhënies vlerë një prove. Komisioni nuk ka përfshirë të ardhurat e përfituara nga zgjidhja e kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë “{\*\*\*}”, në shumën 51.000 euro.

#### *7.3.1. Lidhur me aftësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për dhënie hua shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK*

ii. Konkluzioni i Komisionit se subjekti nuk ka pasur aftësi financiare për dhënie hua në periudhën 2006-2010 është i pasaktë. Mungesa e të ardhurave nuk përfaqëson të gjithë shumën e dhënë hua dhe, për çdo vit, Komisioni duhet të kishte përcaktuar shumën e munguar dhe në fund të marrëdhënies së huas të deklaronte shumën e parave të subjektit. Vlera që mbulohej me burime të ligjshme duhet të ishte zbritur nga totali 14.836.427 lekë, fakt i pa arsyetuar në vendim.

iii. Në kundërshtim me parimin e ligjshmërinë, paanësisë, proporcionalitetit e objektivitetit, Komisioni nuk ka përfshirë të ardhura të ligjshme, ato nga toka bujqësore për vitet 2006-2010, të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes në Institutin e Kulturës Italiane për vitet 2004-2008, si dhe të ardhurat nga interesat e kontratave të huas me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK në vitet 2006-2010, të deklaruara në deklaratat e interesave privatë periodikë përkatës.

iv. Shuma 900.000 lekë nuk është hua dhënë M. G., por detyrim i lindur nga pjesëtimi i dy pasurive, apartamentit dhe gjendjes në llogarinë bankare, mes bashkëshortes, nënës dhe motrës së saj. Subjekti kërkon përfshirjen si të ardhur të ligjshme të shumës 900.000 lekë, në vitin 2007.

v. Konkluzioni i Komisionit se shuma 1.500.000 lekë, e derdhur në llogarinë bankare të nënës së bashkëshortes nga bashkëshortja në vitin 2008, është pasuri e R. H., në kushtet kur subjekti nuk provoi me dokumentacion provues se kjo shumë i përket nënës së bashkëshortes, është i gabuar dhe jo në vlerësim objektiv të provave.

vi. Komisioni ka mbivlerësuar dokumentin bankar të “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, i cili është i paplotë në përshkrimin e arsyes së derdhjes së shumës dhe i krijuar në mënyrë të njëanshme nga punonjësi i bankës dhe nuk provon faktin se shuma i përket R. H.. Dokumenti i firmosur nga bashkëshortja nuk është administruar si provë në hetim, për shkak të pamundësisë që rrjedh nga kalimi i afatit të ruajtjes prej 10 vitesh. Bashkëshortja nuk mban mend të ketë bërë një derdhje të tillë dhe, aq më pak, nëse ka bërë përshkrim në të dhe dokumenti bankar do të kishte fuqi të plotë provuese vetëm nëse në të do të ishte përshkrimi se ia kishte hua nënës së saj, shlyerje detyrimi etj.

vii. Komisioni nuk ka vlerësuar faktin se nëna e bashkëshortes ka qenë invalide e plotë dhe vetëm për arsye të forta lëvizte nga shtëpia dhe R., si e bija, thjesht ka derdhur shumën për llogari të L. H..

viii. Konstatimi i Komisionit se nëna e bashkëshortes nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e shumës është i pabazuar, pasi totali i të ardhurave të saj nga shitja e qira dyqanesh, kullotash, shtëpive, fitim nga hoteleria në Gjirokastrë, dëmshpërblimi si ish të përndjekur politikë, pjesëtim pasurie në Lushnjë, pa llogaritur të ardhurat pas vitit 2004, provon të kundërtën.

### *7.3.2. Lidhur me konkluzionin e Komisionit se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për kthimin e huave*

ix. Barra e provës, lidhur me personin tjetër të lidhur, duhet të jetë proporcionale vetëm për provat e ndodhura pranë tij e jo për ato që ndodhen te personi tjetër i lidhur e në pamundësi marrjeje. Parashikimi në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk është autorizuar nga Kushtetuta dhe bie në kundërshtim me të. Ky parashikim ligjor ngarkon njësoj me subjektin e rivlerësimit, si personin e lidhur dhe personin tjetër të lidhur. Barra e provës ndaj tij ka mbaruar në momentin që ka dorëzuar kontratat e huas, shlyerjen e detyrimit, përpjekjet për të siguruar dokumente pranë shoqërisë dhe pamundësinë e marrjes së tyre.

x. Komisioni kishte detyrimin të merrte provat e ndodhura pranë “{\*\*\*}” ShPK, thirrjen si dëshmitar të administratorit dhe ortakëve, si dhe dokumente të ndodhura në AShK, noter, banka etj., pasi detyrimi i tij për të hetuar prevalon në raport me detyrimin e subjektit për të provuar elementët e përcaktuar prej ligjit. Pavarësisht detyrimit të subjektit, Komisioni nuk mund të qëndrojë pasiv e të kryejë një hetim të paplotë.

xi. Komisioni nuk ka vlerësuar faktin se dokumentacioni i nevojshëm nuk disponohet nga shoqëria, për shkak të kalimit të afatit të ruajtjes së tyre (neni 48 i ligjit nr. 9920/2008), për pasojë duhet të ishte zbatuar neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

xii. Aktet e nënshkruara me shoqërinë janë shkresa të thjeshta, të cilat përbëjnë provë të plotë, sipas nenit 246 të Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit Civil referuar neneve 850 deri 876, si dhe nenit 1050, të cilët nuk parashikojnë që kontratat duhet të jenë noteriale. Kontratat janë të vlefshme nga ana ligjore dhe vijnë në harmoni me deklaratat periodike të viteve 2006-2011

dhe 2014 e duhet të ishin vlerësuar në unitet me to.

xiii. Bilancet e viteve 2008-2011 të shoqërisë nuk janë verifikuar për vërtetësinë e tyre nga aktet e kontrollit nga organet tatimore. Në këto kushte, bilancet kanë fuqinë e një shkrese të thjeshtë, sipas nenit 246 të Kodit të Procedurës Civile dhe nuk plotësojnë kriteret e një dokumenti zyrtar. Bazuar në nenin 273 të Kodit të Procedurës Civile, subjekti i rivlerësimit ka provuar falsitetin e bilanceve, pasi në to nuk janë pasqyruar ngjarje ekonomike, si kredi bankare, kontrata sipërmarrje, shitje apo kontratat e huas me të.

xiv. Komisioni në vendim në mënyrë përgjithshme shprehet se subjekti i rivlerësimit ka shkelur detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligji për parandalimin e pastrimit të parave, por nuk përcakton veprimet apo mosveprimet në kundërshtim me dispozitën ligjore konkrete të shkelur nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni duhet t'i bënte me dije subjektit këtë mangësi apo situatë që mund ta çonte drejt prezumimit të masës disiplinore të shkarkimit apo ndonjë mase tjetër, në mënyrë që t'i jepte mundësinë të ushtronte të drejtën për të provuar të kundërtën, për t'u mbrojtur efektivisht e për t'u dëgjuar në kuadër të procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 6, pika 1 e KEDNj-së. Në jurisprudencën<sup>4</sup> e Kolegjit nuk është konstatuar shkelje marrja e huas në vlerën rreth 20.000 euro *cash* nga subjekti i rivlerësimit.

xv. Komisioni nuk ka asnjë provë apo indicie se vullneti i subjektit të rivlerësimit përputhet me atë të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Përpjekjet e subjektit kanë hasur neglizhencë e papajtueshmëri me shoqërinë, mungesa e vullnetit të së cilës e detyroi të kryejë veprime jo në rrugë bankare, por nuk e ngarkon me përgjegjësi për zbatimin nga shoqëria të legjislacionit tatimor. Detyrimi ligjor për kalimin e shumave nëpërmjet bankës ka lindur në vitin 2009 dhe përfshin vetëm dhënien e kthimin e huave për vitet 2009 e 2010, por ligji nuk detyron subjektin të bëjë veprime me bankë. Nëpërmjet deklarimit të huas në deklaratat periodike vjetore pranë ILDKPKI-së, subjekti ka përmbushur të vetmin detyrim ligjor që ka pasur në ngarkim të tij.

xvi. Konkluzioni i Komisionit se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK nuk provohet që të ketë ushtruar aktivitet për vitin 2014, nuk ka pasur të ardhura për këtë vit e, për rrjedhojë, nuk ka pasur aftësi financiare për t'i dhënë subjektit 51.000 euro, të ketë paguar tatimet për penalitetin në shumën 10.000 euro apo të ketë deklaruar si shpenzim shumën 51.000 euro, është i pabazuar në prova e në zbatim të gabuar të ligjit. Mosdorëzimi i bilancit në vitin 2014 nuk tregon që shoqëria nuk ka pasur të ardhura, për të cilat subjekti ka depozituar kontrata shitje apartamentesh në shuma të konsiderueshme të lidhura nga kjo shoqëri, si dhe nxjerrje të lëvizjeve të llogarisë bankare të saj.

#### 7.4. Për pasurinë, apartament me sipërfaqe 103,82 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Tiranë

i. Komisioni duhet t'i kishte vlerësuar dokumentet në harmoni dhe në raport me njëra-tjetrën dhe me kohën e krijimit të tyre. Veprimet juridike, me pasurinë e përbashkët të bashkëshortes me nënën dhe motrën e saj, kryer në vitin 2007 janë: dhurimi i apartamentit në Durrës, mbyllur llogaria e bonove të thesarit, si dhe kalimi i shumës 6.000.000 lekë të ndodhura në “Intesa Sanpaolo Bank ShA” nga R. te M., njëkohësisht deklaruar në deklaratën e interesave privatë 2007.

ii. Shuma 900.000 lekë e ka burimin nga kalimi i shumës 6.000.000 lekë nga R. te M. dhe përfitimi i një pasurie apartament me vlerë më të vogël. Kjo vlerë është përfituar nga marrëveshja e pjesëtimit. Subjekti kërkon përfshirjen e kësaj shume si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2014.

iii. Në analizën financiare, subjekti kërkon të përfshihen si të ardhura: shuma prej 3.000 eurosh

<sup>4</sup> Shih vendimin, datë 31.07.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit.



e përfituar nga “{\*\*\*}” ShPK në datën 10.01.2014, si dhe shuma prej 150.000 lekësh e përfituar nga të ardhurat e tokës bujqësore, ullinjve, vreshtit e deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2014, në të kundërt të mos llogariten shpenzimet e jetesës.

iv. Llogaritja e shpenzimeve të djalit nga kontrata e donacionit është rrjedhojë e mozbatimit të ligjit, kalimit të barrës së provës në kundërshtim me ligjin, parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit në vlerësimin e provave. Natyra e veçantë e këtyre shpenzimeve e bën të vështirë dokumentimin e tyre. Jo e gjithë shuma e donacionit është shpenzuar për djalin, një pjesë janë bashkë me shpenzimet familjare. Për disa shpenzime nuk janë ruajtur kuponët tatimor, pasi shuma për çdo zë të veçantë nuk e kalonte vlerën 300.000 lekë, që do të detyronte deklarimin dhe dokumentimin e tyre. I vetmi shpenzim që ka pasur mundësi të dokumentojë është blerja e autoveturës në vitin 2015.

v. Kontrata e donacionit nuk është vlerësuar në mënyrën e duhur, pasi donacioni mund të jepej edhe pa paraqitur dokumentacion për shpenzimet, pasi shoqëria “{\*\*\*}” ShPK në financim ka vepruar në bazë të bindjes së krijuar dhe nuk ka kërkuar dokumentacion.

vi. Donacioni nuk është bërë si rrjedhojë e shpenzimit dhe as është barazuar me të. Komisioni ka pasur tendencë njëanshmërie dhe, pa asnjë provë, e ka shpërndarë shpenzimin në mënyrë të barabartë çdo muaj, me arsyetimin se nuk provohet pagesa e kryer në kohën e marrjes së shërbimit apo blerjes. Subjekti kërkon heqjen nga analiza financiare e shpenzimeve të djalit si pasojë e kontratës së donacionit.

vii. Konkluzioni i Komisionit se M. G. ka qenë në pamundësi mjetesh financiare për të kryer pagesën prej 8.368.900 lekësh te shitësi A. G. është në kundërshtim me ligjin, provat e marra në hetim, parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit. Komisioni nuk duhet të hetonte dhe analizonte mundësinë financiare të shtetases M. G. në blerjen e pjesës së saj të apartamentit dhe subjekti i rivlerësimit referuar jurisprudencës<sup>5</sup> së Kolegjit nuk ka detyrim të provojë aftësinë e saj paguese, në kushtet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk është person tjetër i lidhur në këtë proces.

viii. Burimi i pronësisë prej 37.1 % së bashkëshortes së subjektit në apartamentin, në Tiranë, vjen nga apartamenti në pronësi të saj, në Durrës dhe hetimi i mëtejshëm për pasurinë e motrës M. G. ka qenë i panevojshëm.

ix. Komisioni nuk ka vlerësuar apo arsyetuar tërheqjen prej saj të shumës 2.000.000 lekë nga llogaria bankare nr. {\*\*\*}, në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, ndonëse provohet me dokument bankar.

x. Komisioni duhet të kishte përfshirë në të ardhurat e shtetases M. G. të gjitha burimet e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, përfshirë të ardhurat e të ndjerës L. H. në shumën 3.500.000 lekë, për pjesën takuese 1/12 nga pjesëtimi i bashkëpronësisë të sipërfaqes truall dhe ndërtesë, në Lushnjë. Kjo shumë duhej të llogaritej si e ardhur e ligjshme në vitin 2003 për krijimin e llogarisë bankare triemërore në vitin 2004, pranë “Intesa Sanpaolo Bank” ShA.

xi. Në kushtet kur dy depozitat në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, që kanë shërbyer për krijimin e llogarisë në emër të shtetases M. G., nr. {\*\*\*} në lekë dhe nr. {\*\*\*} në euro, janë krijuar nga të ardhura të ligjshme dhe Komisioni duhet t’i kishte vlerësuar të ligjshme.

xii. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë kontratën e punës, datë 15.10.2007 dhe vërtetimin e lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, datë 17.07.2020, të cilat janë dokumente zyrtarë në

---

<sup>5</sup> Shih vendimet nr. 15, datë 17.07.2019 dhe nr. 20, datë 08.09.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit.

përputhje me nenin 246 të Kodit të Procedurës Civile, po ka mbivlerësuar pa asnjë shkak librezën e punës, duke mos marrë për bazë informalitetin e ekonomisë shqiptare, pamundësinë e punëmarrësit për të ndikuar në formalizimin e marrëdhënieve të punës, duke u deklaruar në zyrën e punës dhe pagesën e detyrimeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore.

xiii. Komisioni nuk ka llogaritur të ardhurat e bashkëshortit të shtetasës M. G.: (i) nga punësimi pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për periudhën 15.10.2007-01.11.2009, me një pagë 30.000 lekë/muaj, si dhe shpërblimet në fund të vitit dhe orët jashtë orarit deri në ndërprerjen e marrëdhënies së punës më datë 03.09.2013, në një shumë totale prej 2.015.000 lekësh pagë dhe 180.000 lekësh shpërblim në fund të vitit; (ii) shumën 286.800 lekë përfituar, në periudhën 2005-2006, nga punësimi pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, sipas vërtetimit nr. {\*\*\*} prot., datë 16.04.2020, të ISSh-së Tiranë; si dhe (iv) vlerën e plotë të të ardhurave nga kontrata e qirasë edhe të pjesës takuese 2/3 të shumës 2.250.000 lekë.

*7.5. Për pasurinë, garazh me sipërfaqe 48 m<sup>2</sup>, me dy vendparkime, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Durrës*

i. Konkluzioni i Komisionit se subjekti nuk ka depozituar gjatë hetimit administrativ zgjidhjen e kontratës së shitjes me kusht, datë 26.12.2009, është i pavërtetë, pasi subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit të datës 03.04.2020 ka depozituar dokumentin pa asnjë kundërshtim.

ii. Mosnënshkrimi i kontratës së dytë në vitin 2011 para noterit nuk e bën atë fiktive. Deklarata noteriale e shtetasit V. Ç. ka vlerë në kushtet kur nga Komisioni është hedhur dyshimi se kontrata e vitit 2011 nuk ka vullnetin e shitësit. Subjekti nuk ka refuzuar të saktësojë situatën për këtë pasuri. Komisioni nuk ka vlerësuar si prova të ligjshme zgjidhjen e kontratës së shitjes me kusht të datës 26.12.2009, marrje huaje nga “{\*\*\*}” ShPK, datë 20.08.2009, mandatarkëtimin nr. {\*\*\*}, datë 26.12.2009, të kësaj shoqërie dhe kontratë shitje të vitit 2011, të cilat janë shkresa të thjeshta që kanë fuqi provuese, sipas nenit 246 të Kodit të Procedurës Civile dhe duhen vlerësuar në harmoni me deklaratat e interesave privatë, deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe qëndrimet e subjektit gjatë hetimit administrativ.

iii. Përfundimi i Komisionit se shuma e kthyer nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK nuk mund të shërbejë si burim të ardhurash, me arsyetimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar aftësinë financiare të shoqërisë në vitin 2011, është i gabuar, në kushtet kur edhe subjekti ka pasur aftësi paguese për dhënien hua edhe shoqëria për kthimin e shumën 3.500.000 lekë.

*7.6. Për pasuritë, 2 (dy) apartamente me sipërfaqe 126 m<sup>2</sup> secili, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Durrës*

i. Parashikimi i pagesës së shumës 63.800 euro në momentin e regjistrimit të pasurisë në ASHK nuk është një parashikim kontraktor fiktiv, por real dhe ka ndodhur për faktin e imazhit negativ të shoqërisë ndërtuese në regjistrimin e objekteve të ndërtuara prej saj, e pasigurisë në realizimin e kontratës përfundimtare të shitjes, si dhe rreziku i rishitjes disa herë prej shoqërisë.

ii. Përdorimi i apartamenteve për biznes nuk i ndryshon të dhënat e pasurisë dhe nuk e detyron subjektin t’i deklarojë si njësi kur nuk janë të tilla. Përdorimi i tyre si njësi nuk është fshehur prej tij, por rezulton i deklaruar në deklaratën e interesave privatë 2015 dhe atë *vetting*, shoqëruar me kontratat e qirasë së apartamentit, gjë që tregon se për çfarë është përdorur.

iii. Lidhur me dyshimet e Komisionit për çmimin e blerjes poshtë vlerës së tregut, subjekti i rivlerësimit pretendon se çmimi referues është orientues për administratën fiskale në llogaritjen e tatimit dhe nuk mund të ketë vlerë të paracaktuar. Çmimi i blerjes përcaktohet në kontratë në një marrëveshje të lirë mes palëve dhe rrethanave në të cilat lidhet një kontratë, në përputhje me nenin 706 i Kodit Civil, ligj që ka përparësi në zbatim përpara udhëzimit për përcaktimin e

çmimeve të referencës.

iv. Kontrata premtim shitje ka fuqi të plotë ligjore në përputhje me nenin 246 të Kodit të Procedurës Civile. Çmimi i nxjerrë nga Komisioni përfshin dhe ambientin e përbashkët dhe është bërë për njësi jo për apartament, ndërkohë sipas udhëzimit duhet të llogaritet për sipërfaqe të shfrytëzueshme, i cili rezulton më i lartë se 350 euro/m<sup>2</sup>.

v. Konkluzioni i Komisionit se subjekti është përpjekur të mosdeklarojë në mënyrë të saktë dhe të plotë pasuritë njësi/apartament është i gabuar dhe vjen në kundërshtim me deklaratën e pasurisë *vetting*, përgjigjet e AShK-së Durrës, të paargumentuara në vendim, kontratën e shitjes, planimetritë, kontratën e sipërmarrjes dhe dorëzimit, kontratat nënshkruar mes shoqërive “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK, si dhe argumentet e subjektit.

*7.7. Për pasurinë, apartament me sipërfaqe 146,3 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Durrës, përfituar me kontratë shitblerje me kusht nga Rr. H.*

i. Aludimet e Komisionit se ky apartament mund të jetë pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit bien poshtë me kontratën e shitjes me kusht dhe shlyerjen e çmimit nga blerësi, babai i subjektit të rivlerësimit, si dhe faktin që ai përdor apartamentin në pronësi të subjektit.

ii. Konstatimi i Komisionit se ky apartament është në të njëjtin kat dhe lidhet me apartamentin tjetër në pronësi të subjektit është i pavërtetë dhe i papabuar në prova. Vendimi i Komisionit në këtë pjesë është i paarsyetuar.

iii. Për pasuritë në përdorim, detyrimi i subjektit ka qenë të deklarojë përdorimin dhe jo burimin e krijimit të pasurisë, duke e kuptuar kështu ligjin, e duke mos pasur asnjë qëllim tjetër për mosdeklarimin e burimit dhe mosshoqërimin me dokumentacion të të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e tij. Babai i subjektit nuk klasifikohet në cilësinë e personit tjetër të lidhur, parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pasi posedimi nuk është asnjë nga kategoritë e marrëdhënieve që përcakton dispozita e, në këto kushte, nuk ka pasur detyrimin të dorëzojë me deklaratën e pasurisë *vetting* dokumentacion që provonte të ardhurat e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

iv. Komisioni ka konstatuar se babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme për të blerë këtë apartament e, si rrjedhojë, sipas subjektit, nuk ka pasur arsye të mos ishte bashkëpunues dhe transparent.

v. Marrëdhënia e huas me babain nuk është deklaruar si burim në përgjigjet e pyetësorit të datës 03.04.2020, pasi subjekti ka menduar se pyetja i referohej burimit të të ardhurave deri ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting* e, pas kësaj date, Komisioni nuk ka të drejtë të hetojë.

*7.8. Lidhur me të ardhurat nga qiratë e apartamentit me sipërfaqe 103,82 m<sup>2</sup>, në Tiranë dhe apartamentit me sipërfaqe 78,24 m<sup>2</sup>, në Durrës*

i. Të ardhurat nga qiraja e apartamentit me sipërfaqe 103,82 m<sup>2</sup>, në Tiranë, në shumën 14.283 euro, nuk vijnë në kundërshtim me asnjë provë dhe kontrata e qirasë, datë 13.08.2014, për këtë apartament, është reale dhe jo fiktive. Gjithashtu, për të ardhurat nga qiraja e apartamentit me sipërfaqe 78,24 m<sup>2</sup>, në Durrës, kontrata e qirasë e datës 05.03.2014 është reale dhe subjekti nuk është përpjekur të rrisë në mënyrë fiktive të ardhurat e tij. Komisioni duhet të kishte vlerësuar me objektivitet datën e kontratës së shitjes, pagesat e çmimit të bërë dhe kontratën e qirasë, prova të ligjshme dhe të pakontestuar nga Komisioni, për secilin nga apartamentet.

*7.9. Lidhur me krijimin e depozitave, në shumën 520.000 lekë dhe shumën 2.000.000, në Bankën Amerikane, nga bashkëshortja*

i. Konkluzioni i Komisionit se bashkëshortja nuk ka pasur të ardhura të ligjshme në shumën 2.366.287 lekë është në kundërshtim me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, ligjin, provat e administruara, parimin e ligjshmërisë, objektivitetit, proporcionalitetit në barrën e provës, si dhe fuqisë prapavepruese të ligjit.

ii. Komisioni duhet të mbante në konsideratë provat e administruara, komunikimet elektronike dhe deklaratën noteriale e përgjegjëses I. K., të cilat provojnë marrëdhënien e punës, pranë Institutit të Kulturës Italiane, për periudhën 2001-2003. Në lidhje me provueshmërinë dhe vlerën e të ardhurave, duhej të merrej parasysh fakti që bashkëshortja nuk ishte subjekt deklarimi, kohën e largët, punën në informalitet, duke u referuar në të ardhurat për periudhën 2004 e në vazhdim, e duke i llogaritur 600.000 lekë në periudhën 2001-2003 dhe 200.000 lekë për vitin 2004.

iii. Komisioni nuk ka përfshirë të ardhurat e bashkëshortes nga puna pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, sipas dokumentit zyrtar librezë e punës, në shumën 100.000 lekë, pasi nuk analizon vlerën e këtij dokumenti, siç ka vepruar për të ardhurat nga puna e shtetasit A. G..

iv. Komisioni duhet të kishte përfshirë të ardhurat nga dëmshpërblimi i ish të përndjekurve politikë me vlerë të saktë dhe të ardhurat nga pasuritë në Gjirokastrë, shtëpitë, hoteli, qira kullotash e dyqanesh, për vitet 1994-2004, në shumën 904.524 lekë. Mosdeklarimi i tyre si burime në deklaratën e pasurisë *vetting* nuk sjell përjashtimin nga analiza. Të ardhurat janë krijuar kur bashkëshortja kur nuk ishte person i lidhur dhe, për to, nuk është e nevojshme të provohet shlyerja e detyrimeve tatimore, pasi disa janë krijuar para miratimit të ligjit për tatimin mbi të ardhurat e për disa është dokumentuar tatim i paguar.

*7.10. Lidhur me gjendjen e likuiditeteve në vitin 2016*

i. Konkluzioni i Komisionit se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e gjendjes *cash* në fund të vitit 2016 është i pabazuar dhe i paarsyetuar, pasi: (i) në analizën financiare të vitit 2016 nuk janë përfshirë të ardhurat nga toka bujqësore, në shumën 150.000 lekë; (ii) gjendja e llogarisë në emër të shoqërisë së thjeshtë “{\*\*\*}” në “Raiffeisen Bank” ShA nuk duhet të llogaritet si likuiditet për R. H., në shumën 550.000 lekë, pasi në këtë llogari janë kryer pagesa vetëm për llogari aktivitetit ekonomik të shoqërisë, sipas mandatarëketimeve për klientët të ndryshëm dhe jo për llogari të R. H..

ii. Lidhur me depozitimin e shumës 6.000 euro më datë 06.07.2016, në “Alpha Bank” ShA, konkluzioni i Komisionit nuk është i bazuar në vlerësimin objektiv të provave, pasi më datë 22.01.2016 janë tërhequr 15.000 euro nga llogaria, me burim të ligjshëm kontratën e shitjes, përdorur për nevoja të subjektit, pasi e motra e bashkëshortes, pjesën e saj prej 8.000 eurosh nga kontrata e shitjes nuk e mori menjëherë nga momenti i derdhjes në llogari.

*7.11. Lidhur me analizën financiare për periudhën e rivlerësimit 2003-2016*

i. Konkluzioni i Komisionit nuk është rezultat i provave të marra në proces dhe vetë burimeve të pranuar prej tij. Në kushtet kur Komisioni pranon se toka bujqësore krijon të ardhura, nga viti 1991 deri në vitin 2016, këto të ardhura afektojnë rezultatin negativ të Komisionit. Komisioni nuk mund të përcaktojë shifër, kur nuk është në gjendje të vlerësojë në sasi numerike një të ardhur. Analizën financiare të Komisionit e afekton e ardhura nga puna *part-time* e bashkëshortes në Institutin e Kulturës Italiane në vitet 2004 – 2008, burim i njohur nga Komisioni, që lë të pacaktuar sa është e ardhura.

ii. Komisioni pranon se huaja e dhënë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK nuk mbulohet e gjitha me të ardhura të ligjshme dhe, si rrjedhim, nuk e ka vlerësuar si të dhënë hua. Komisioni duhet të kishte përfshirë të ardhurat e ligjshme për çdo vit ose në momentet që ka bërë investimet. Mënyra si është nxjerrë analiza për vitet e dhënies dhe marrjes së huave ka paqartësi dhe pasaktësi, të cilat vijnë si pasojë e mosarsyetimit dhe mungesës së analizës së detajuar.

### III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

#### A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

##### a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Tritan Hamitaj, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara, në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

##### b) Legjitimimi i ankuesit

9. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

##### c) Shqyrtimi i kërkesave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në Kolegji

10. Trupi gjykues i Kolegjit, në kuadër të garantimit të një procesi të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 6, paragrafi 1 të KEDNj-së dhe në dispozitat kushtetuese dhe ligjore, përkatësisht nenet 42, 179/b, pika 2 e Kushtetutës dhe nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mori në shqyrtim fillimisht kërkesat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në Kolegji, si vijon.

10.1. Më datë 07.10.2022, në Kolegji, administrohen dy kërkesat e subjektit të rivlerësimit Tritan Hamitaj: (i) kërkesa nr. {\*\*\*} prot., me objekt: *Të gjykohej nga një trup gjykues që plotëson kriteret e nenit 6 të KEDNj-së*; (ii) dhe kërkesa nr. {\*\*\*} prot., me objekt: *1. Të konstatohet se trupi gjykues i KPK-së i përbërë nga Genta Tafa, Suela Zhegu dhe Lulzim Hamitaj janë zgjedhur në shkelje të ligjit procedural dhe material dhe nuk plotësojnë standardin e një gjykate të formuar me ligj. 2. Të konstatohet se anëtarët e trupit gjykues në KPA-së, Natasha Mulaj, Ina Rama, Sokol Çomo, Rezarta Schuetz dhe Albana Shtylla, janë zgjedhur në shkelje të ligjit procedural dhe material dhe nuk plotësojnë standardin e një gjykate të formuar me ligj. 3. Të gjykohej nga një trup gjykues në KPA që është zgjedhur në përputhje me ligjin procedural dhe material, duke plotësuar standardin e një gjykate të formuar me ligj. Në këto kërkesa, subjekti ngre pretendime, që lidhen me shkelje të ligjit procedural dhe material në përzgjedhjen e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, që cenojnë standardin e parashikuar nga neni 6 i KEDNj-së, për një proces të rregullt ligjor.*

10.1.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nuk plotëson standardin e parashikuar nga neni 6 i KEDNj-së, pasi anëtarët e tij nuk barazohen me

gjqtarët e Gjykatës Kushtetuese, as në status, as me kushtet e rekrutimit, as gjatë ushtrimit të funksionit. Subjekti analizon dispozitat ligjore lidhur me procedurën dhe afatet kohore të zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit nga Avokati i Popullit, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit dhe Kuvendi, të cilët, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk kanë bërë një vlerësim dhe renditje të kandidatëve mbi bazën e meritës dhe vlerësimit profesional të secilit kandidat me një akt të arsyetuar, por vetëm mbi plotësimin ose jo të kritereve formale dhe më pas me vlerësimin politik të tyre. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë natyrën *sui generis* të procesit të rivlerësimit dhe qëllimin e ligjvënësit, që në kontekstin e një vlerësimi kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përzgjedhjen e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit t’ia nënshtronte procedurave të mirëpërcaktuara nga Aneksi i Kushtetutës dhe ligji i posaçëm nr. 84/2016. Në këtë drejtim, dispozitat kushtetuese dhe ligjore përcaktuan në detaj procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, institucionet e ngarkuara në çdo hap të këtij procesi përzgjedhës, deri në emërimin përfundimtar të tyre. Procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të rivlerësimit, e parashikuar në legjislationin e sipërcituar, ishte në përputhje me vullnetin e legjislatorit e, në këto kushte, nuk cenon parimin e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj, në kuadër të procesit të rregullt ligjor, në zbatim të nenit 6, paragrafi i parë të KEDNj-ve.

**10.1.2.** Me të njëjtin arsyetim, trupi gjykues i Kolegjit gjen të pabazuar dhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në kushtet kur neni C, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës parashikon se gjyqtarët e Kolegjit gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese e, për këtë arsye, duhet të bënin betimin para Presidentit të Republikës, mungesa e të cilit nuk e bën një gjykatë të pavarur, pavarësisht rregullimit specifik kushtetues e ligjor të tij. Qëllimi i legjislatorit në pozicionimin e Kolegjit, nën të njëjtën *ombrellë* të Gjykatës Kushtetuese, duke e kompozuar këtë të fundit në dy dhoma, përgjatë mandatit të Kolegjit, si dhe atribuimi i statusit të gjyqtarit të kësaj gjykate, nuk prezumon se kriteret për përzgjedhjen e tyre duhet të jenë të njëjta me ato të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, por lidhet me forcimin e garancive kushtetuese të Kolegjit dhe gjyqtarëve të tij, në kuadër të konsolidimit të pavarësisë së tyre gjatë ushtrimit të detyrës. Një gjykatë e krijuar me ligj në një situatë të jashtëzakonshme dhe kalimtare nuk përjashton në vetvete që të konsiderohet si një “tribunal i krijuar me ligj”, sipas kuptimit të Konventës, qëndrim i mbajtur nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”), në paragrafët 284-288 të vendimin *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, ku, ndër të tjera, theksohet se [...] *për qëllimet e nenit 6/1, një gjykatë nuk ka nevojë të jetë një gjykatë e integruar brenda mekanizmit standard gjyqësor. Ajo mund të krijohet për të shqyrtuar një çështje specifike, e cila mund të administrohet në mënyrë të përshtatshme jashtë sistemit të zakonshëm të gjykatës [...].* Në këto kushte, moskryerja e betimit para Presidentit, si një procedurë e paparashikuar nga dispozitat kushtetuese për gjyqtarët e Kolegjit, nuk afekton në asnjë formë integritetin e tij, si një gjykatë e krijuar me ligj.

**10.1.3.** Pretendimin e subjektit të rivlerësimit se mungesa e verifikimit të pasurisë së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit përpara fillimit të detyrës, si gjyqtarët e zakonshëm dhe kushtetues, si dhe moskryerja e kontrollit nga ILDKPKI-ja çdo dy vjet, sipas parashikimit të nenit 25/1, germa “a” të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ul pavarësinë e anëtarëve të këtyre institucioneve, trupi gjykues i Kolegjit, gjithashtu, e konsideron të pabazuar. Neni 26 i ligjit nr. 84/2016, si një zberthim i nenit C, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, parashikon detyrimin e anëtarëve të institucionit të rivlerësimit që me fillimin e detyrës të plotësojnë deklaratën vjetore të pasurisë, detyrim i përmbushur, ndërkohë që pika 3 e këtij neni përcakton se *anëtari i institucionit të rivlerësimit nuk i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, sipas nenit 179/b të Kushtetutës.* Kontrolli i pasurisë, nëpërmjet procesit të rivlerësimit përpara emërimit të anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, nuk u pa me vend

nga ligjvënësi edhe në këndvështrim praktik që lidhet me elementin kohë në procedurat e ngritjes së këtyre institucioneve, mandatit të përkohshëm të tyre, përkatësisht 5 dhe 9 vjet, duke mos paraparë kështu as organet që do të kryenin këtë proces rivlerësimi për ta, në ndryshim nga kontrolli me disa etapa që i nënshtrohen anëtarët e organeve të përhershme, e që vijnë jashtë sistemit gjyqësor. Në ndryshim nga anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, Aneksi i Kushtetutës, në nenin C, pika 4 të tij, ka përcaktuar se: *“Anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit, komisionerët publikë, si dhe punonjësit e tjerë të këtyre institucioneve nënshkruajnë deklaratë me shkrim, sipas ligjit, për të autorizuar kryerjen e kontrollit vjetor të pasurisë së tyre, monitorimin sistematik të llogarive dhe transaksioneve financiare, si dhe kufizimet e posaçme të së drejtës së fshehtësisë së komunikimeve gjatë gjithë kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në detyrë. Deklaratat e pasurisë së tyre bëhen publike”*. Verifikimi i pasurisë, për anëtarët e Kolegjit dhe institucioneve të tjera të rivlerësimit, përpara përzgjedhjes së tyre, i është nënshtruar një procedure të posaçme të përcaktuar nga ligji nr. 84/2016 dhe se është po ashtu nën procesin kontrollues të ILDKPKI-së, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar. Fakti që anëtarët nuk i janë nënshkruar procesit të rivlerësimit kalimtar është një çështje e rregulluar posaçërisht nga Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016, duke qenë se ata i janë nënshtruar proceseve verifikuese para zgjedhjes së tyre, në të cilin janë angazhuar, jo vetëm institucionet shqiptare, por edhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.

**10.1.4.** Lidhur me pretendimin se shkaqet për përgjegjësinë disiplinore të anëtarëve të Kolegjit nuk janë parashikuar në Kushtetutë, por i janë deleguar ligjit, i cili, gjithashtu, nuk garanton patundshmërinë e parashikuar nga Kushtetuta për gjyqtarët e zakonshëm dhe kushtetues, të cilët shkarkohen vetëm për shkelje të rënda, si dhe mosparashikimi i të drejtës së ankimit kundër vendimit të Komisionit Disiplinor, sjell cenim të pavarësisë të anëtarit të Kolegjit, trupi gjykues i Kolegjit i referohet në analizë, vendimit të GjEDNj-së në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, që në paragrafin 298, ka arsyetuar se: *[...] Mungesa e parashikimit zyrtar të mosheqjes nga detyra të gjyqtarëve në ligjin nr. 84/2016 nuk nënkupton në vetvete mungesën e pavarësisë, përderisa ajo të njihet në gjendje faktike dhe të ekzistojnë garancitë e tjera të nevojshme [...]. Mund të shihet nga vetë dispozitat e ligjit nr. 84/2016 se me të vërtetë ky është rasti. As pushteti legjislativ dhe as ai ekzekutiv nuk mund të kërkojnë dorëheqjen ose largimin nga detyra të anëtarëve të organeve të vetting-ut. Neni 17 i ligjit nr. 84/2016 përcakton rastet specifike kur ata mund të hiqen nga detyra [...]. Fakti që anëtarët e institucioneve të rivlerësimit mund të hiqen nga detyra vetëm në rast të kryerjes së një shkeljeje disiplinore, në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji, nuk vë në dyshim garancitë e nevojshme për mosheqjen e tyre nga detyra, të cilat janë të pranishme në çështjen në fjalë.*

**10.1.5.** Subjekti i rivlerësimit në kërkesën e tij i referohet procedurës, afateve kohore të zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit nga Avokati i Popullit, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit dhe Kuvendi, si dhe mënyrës sesi kanë proceduar, duke pretenduar shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së, për një gjykatë të krijuar me ligji, për rrethanat si vijon.

- i.* mungesa e së drejtës së ankimit për kandidatët e klasifikuar në rekomandimin negativ nga ONM-ja apo në listën e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret formale, si dhe përzgjedhja nga komisioni *ad hoc* parlamentar me një shumicë të cilësuar të një kandidati nga lista e atyre që nuk plotësojnë kriteret në vlerësim të subjektit të rivlerësimit, prek pavarësinë e krijimit të organeve të rivlerësimit;
- ii.* mungesa e një akti të arsyetuar nga këto institucione për kandidatët dhe dokumentet e marra kryesisht nga ONM-ja;
- iii.* hetimi informal për kandidatët nga ONM-ja është bërë në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë së mbledhjes së provave, parimin e transparencës, duke mos i vënë në dispozicion të komisionit parlamentar;

- iv. ONM-ja është krijuar në mënyrë të paligjshme, gjë që bën të pavlefshme rekrutimin e anëtarëve të organeve të rivlerësimit;
- v. përzgjedhja e kandidatëve është bërë politikisht, duke mos krijuar një institucion të pavarur;
- vi. zgjedhja në bllok e tyre i ka mohuar të drejtën Kuvendit për të përzgjedhur dhe skualifikuar;
- vii. afatet e shkurtra kohore për verifikim dhe vlerësimin e kandidatëve nuk i kanë lejuar organet e caktuar nga ligji të bëjnë verifikimin dhe plotësimin e kushteve. Nga ana tjetër, dhënia e një kohe të dytë kandidatëve për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm vjen në kundërshtim me nenin 7, pikat 2 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016;
- viii. vlerësimi i kushteve të zgjedhshmërisë me vetëdeklarim është në kundërshtim me nenin 7, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ndërkohë që janë të identifikueshme institucionet ku gjenden dokumentet e kërkuara;
- ix. diskrecioni i Kuvendit, i parashikuar nga neni C, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 8, pika 3 e ligjit nr.84/2016, bën që zgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit sjell mungesën e garancive ligjore për të krijuar një gjykatë të pavarur, të paanshme dhe të pandikueshme.

**10.1.6.** Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues vlerëson se ndryshe nga çështja *Gudmundur Andri Astraosson kundër Islandës*, apo raste të tjerë, për të cilat GjEDNj-ja ka konstatuar cenim të gjykimit nga një gjykatë e krijuar me ligj, pasi janë vërejtur shkelje të dispozitave ligjore të ligjit vendas në procedurën e emërimit të anëtarëve të gjykatës, duke afektuar parimin e pavarësisë dhe paansisë, për shkak të ndikimit të pushteteve të tjera, kryesisht ekzekutivit, duke bërë të parregullt emërimin e tyre, procesi i rivlerësimit si pjesë e reformës në drejtësi ishte produkt i një konsensusi të gjerë politik në vend, që inicioi me miratimin e paketës ligjore, përfshirë ndryshimet kushtetuese dhe ligjin nr. 84/2016, që parapanë kompetencën e komisionit *ad hoc* parlamentar në procesin përzgjedhës. Në këtë proces, Kuvendi nuk ka qenë në ushtrim të pushtetit të tij të mirëfilltë legjislativ, por ka ushtruar kompetencat kushtetuese në përzgjedhjen dhe emërimin e organeve kushtetuese apo të krijuara me ligj, që rrjedhin nga parimi themelor i sovranitetit të popullit të ushtruar nga përfaqësuesit e tij.

**10.1.7.** Proces i përzgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, si një proces *atipik*, mbi bazën e një vlerësimi diskrecionar të kriterëve nga komisioni *ad hoc* që lejonte vlerësimin prej tyre të përmbushjes ose jo të kriterëve formale të kandidatëve, shprehur qartësisht në përmbajtjen e dispozitës kushtetuese dhe ligjore, nenit C, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 8, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Këto dispozita qartësojnë faktin se plotësimi i kriterëve formale kushtetuese e ligjore, të parashikuara nga neni C, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 6 i ligjit nr. 84/2016, nuk ishin domosdoshmërisht përcaktues në përzgjedhjen e kandidatëve të institucioneve të rivlerësimit, kur komisioni *ad hoc*, me një balancë përfaqësimi dhe nën frymën e vullnetit të ligjvënës, mund të kalonte me shumicë të cilësuar votash një kandidat nga lista e atyre që nuk plotësojnë kriteret formale të lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale. Me fjalë të tjera, përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit është kryer mbi një vullnet të gjerë të ligjvënës dhe e mbështetur plotësisht nga dispozitat kushtetuese e ligjore, që i përgjigjej kërkesës imediate të vendit për kryerjen e procesit kalimtar të rivlerësimit. Qëllimi i zgjedhjes në bllok të anëtarëve nuk duhet interpretuar si cenim i parimeve për një proces të rregullt, por si një garanci në ngritjen e këtyre institucioneve dhe në pacenueshmërinë e anëtarëve të tyre gjatë ushtrimit të detyrës. Në të kundërt, veprimtaria e këtyre organeve do të ishte lehtësisht e ndikueshme, nga mjete ankimi apo kontrolli rreth kushteve të vlefshmërisë, të cilat logjikshëm do të përdreshin për këtë qëllim prej subjekteve të rivlerësimit. Vlen të sille në vëmendje se procesi i rivlerësimit kalimtar ishte një nevojë për t'iu përgjigjur dhe ndalur korrupsionin endemik të konstatuar se ekzistonte në sistemin e drejtësisë në vend, nga faktorët e brendshëm, por edhe organizmat ndërkombëtar. Rikthimi i



besimit te sistemi i drejtësisë u konceptua si një qëllim i vështirë për t'u arritur dhe për të cilin duhej të zbatoheshin masa të jashtëzakonshme dhe mbi të gjitha anëtarët e zgjedhur me konsensus dhe që merrnin përsipër kryerjen e tij të kishin të garantuar qenien në detyrë, të fituar nëpërmjet një mekanizmi të posaçëm kushtetues dhe të pakontestueshëm si të tillë.

**10.1.8.** Trupi gjykues gjen me vend të theksojë se prezenca e ONM-së dhe monitorimi i kësaj procedure nga faktori ndërkombëtar, i parashikuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore dhe i udhëhequr nga Komisioni Evropian, ka kontribuar duke garantuar një proces transparent dhe mbi të gjitha të paanshëm. Pezullimi i procedurave përzgjedhëse nga Kuvendi, kthimi i dosjeve të depozituara të kandidatëve që kishin shprehur interesin për të kandiduar në institucionet e rivlerësimit, duke i njoftuar për riplotësimin e dokumentacionit, nuk duhet konsideruar si shkelje ligjore, sidomos në kushtet kur lista e kandidatëve që plotësonin kriteret formale përbëhej vetëm nga 29 kandidat, ndërkohë që lista e kandidatëve që nuk plotësonin kriteret nga 164 kandidat, të cilët, referuar informacionit të Avokatit të Popullit, nuk plotësonin kriteret formale, kryesisht për mangësi në dokumentacion. Fakti i dhënies kohë për plotësimin e dokumentacionit mundësoi rritjen në 84 të numrit të kandidatëve që plotësonin kriteret formale dhe zhvillimin e një procesi konkurrues për përzgjedhjen e kandidatëve më të përshtatshëm.

**10.1.9.** Për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se procedura e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, nga institucionet kushtetuese si Avokati i Popullit, nën monitorimin e ONM-së, sipas *“Protokollit të procedurave të punës për vlerësimin se cili prej kandidatëve plotëson kriteret formale për institucionet rivlerësuese”*, të dakordësuar mes tyre, vlerësimi me shkrim dhe rekomandimet e vëzhguesve ndërkombëtarë të ONM-së, lidhur me kandidatët, si dhe procedurat përzgjedhëse në Kuvend, kanë qenë në përputhje të plotë me dispozitat kushtetuese dhe ligjore e, në këto kushte, pretendimi për shkelje të ligjit procedural, sa mund të cenonin pavarësinë dhe paanshmërinë e institucioneve të rivlerësimit, është i pabazuar.

**10.1.10.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se detyrimin për verifikimin e plotësimit të kushteve për çdo kandidat e ka konstatuar edhe GjEDNj-ja në çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, dështimi në verifikim ka sjell krijimin e një gjykatë të formuar jo sipas ligjit. Kolegji, sipas subjektit të rivlerësimit, ka detyrim të zbatojë drejtpërsëdrejti vendimet e GjEDNj-së. Sa i përket shkeljes së ligjit material, subjekti evidenton mangësi në dokumentacion provues të kushteve të zgjedhshmërisë për secilin gjyqtar të Kolegjit, pjesë e trupit gjykues të shortuar për gjykimin e çështjes. Trupi gjykues i Kolegjit thekson se procesi i përzgjedhjes së kandidatëve, nëpërmjet vlerësimit të plotësimit të kriterëve formale, ka qenë një detyrë të cilën Kushtetuta ia besoi Presidentit të Republikës e, në pamundësi të tij, u krye nga Avokati i Popullit, një institucion kushtetues i pavarur, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit i udhëhequr nga Komisioni Evropian dhe Kuvendi i Shqipërisë, të cilët nëpërmjet një procesi të monitorueshëm, si nga fakti ndërkombëtar dhe ai vendas, shoqërisë civile dhe mediave, kryen një proces vlerësimi dhe përzgjedhës për të gjithë aplikantët që shprehën interes për të qenë pjesë e institucioneve të rivlerësimit. Pavarësisht sa arsyetuar më sipër, lidhur me korelacionin mes plotësimit të kriterëve me mundësinë për t'u përzgjedhur anëtar i institucioneve të rivlerësimit, pretendimet e subjektit, për mosplotësimin e kushteve të zgjedhjes për gjyqtarët e Kolegjit, që sipas tij krijojnë një gjykatë jo të formuar sipas ligjit, janë të pabazuara. Plotësimi i kriterëve ligjore nga gjyqtarët e tjerë të Kolegjit, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar apo vetëdeklarimit për plotësimin e tyre, u vlerësua, pikërisht, nga institucionet e sipërpërmendura, të cilat nuk kishin asnjë fakt të panjohur gjatë procesit përzgjedhës për kandidatët, si në rastin e gjyqtarit Luan Daci të shqyrtuar nga GjEDNj-ja në vendimin *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, i cili, përpara komisionit *ad hoc* parlamentar, deklaroi që ndaj tij nuk ishte ndërmarrë ndonjë masë disiplinore për shkarkim nga detyra, ndërkohë që më datë 24.12.1997, Këshilli i Lartë i Drejtësisë kishte vendosur shkarkimin e tij nga detyra për shkelje të ligjit dhe për paaftësi në

detyrë, në fuqi në kohën e zgjedhjes gjyqtar i Kolegjit, fakt, i cili, nëse do të ishte deklaruar përpara komisionit *ad hoc*, do të kishte pamundësuar zgjedhjen e tij si gjyqtar pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

10.1.11. Trupi gjykues e gjen të pambështetur pretendimin e subjektit, që Kolegji duhet të verifikojë zgjedhshmërinë e anëtarëve të tij, në kushtet kur nuk është evidentuar asnjë rrethanë e re e panjohur nga institucionet kushtetuese, për të nisur verifikimin e zgjedhshmërisë apo delegjitimitimin e punës së kryer nga institucionet kushtetuese. Duke potencuar natyrën e veçantë të këtij procesi, përkohshmërinë e tij, prevalencën e interesit publik për të cilën u krijua reforma në drejtësi, periudhën prej gjashtë vjetësh gjatë të cilës gjyqtarët e Kolegjit ushtrojnë funksionet e tyre, kanë gjykuar çështje të juridiksionit të rivlerësimit, numrin e çështjeve të gjykuara<sup>6</sup>, mandatin e mbetur prej tre vjetësh, Kolegji e konsideron kërkesën e subjektit për konstatimin e të gjithë anëtarëve të trupit gjykues, si të zgjedhur në shkelje të ligjit procedural dhe material dhe standardit të një gjykate të formuar me ligj, abuzive dhe me tendencë për t'u shmangur nga procesi i rivlerësimit dhe për të penguar funksionalitetin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Këtë konkluzion e përforcon dhe fakti i qëndrimit të mbajtur nga subjekti i rivlerësimit më herët në Komision, i cili parashtroi kërkesa për përjashtimin e trupit gjykues të Komisionit, pasi iu bënë të njohura nëpërmjet rezultateve të hetimit administrativ mangësitë serioze të konstatuara në kriterin e kontrollit të pasurisë së tij. Këto kërkesa do të ishin perceptuar ndryshe nëse do të ngriheshin që në nisjen e procesit të rivlerësimit nga subjekti. Me të njëjtin arsyetim, si më sipër në këtë vendim, trupi gjykues i Kolegjit gjen të pabazuar edhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit *për konstatimin se trupi gjykues i KPK-së i përbërë nga Genta Tafa, Suela Zhegu dhe Lulzim Hamitaj janë zgjedhur në shkelje të ligjit procedural dhe material dhe nuk plotësojnë standardin e një gjykate të formuar me ligj.*

10.2. Kërkesën e subjektit të rivlerësimit të depozituar në Kolegji më datë 20.01.2023, me objekt: *Pezullimi i çështjes (JR) nr. 61/2020, datë 18.12.2020, regjistruar pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit [...] deri në përfundimin e çështjes administrative nr. {\*\*\*}, datë 13.05.2022, regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë*, trupi gjykues e gjen të pabazuar, pasi zhvillimi i një procesi gjyqësor administrativ nuk pezullon procesin kushtetues të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Procesi i rivlerësimit kalimtar zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe autonome nga çdo proces tjetër gjyqësor që gjykohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në vend, pikërisht, për shkak të juridiksionit të posaçëm dhe të jashtëzakonshëm kushtetues që kanë institucionet e rivlerësimit.

10.3. Në përfundim të sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, pas shqyrtimit të kërkesave paraprake të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me objekt gjykimin nga një trup gjykues që plotëson kriteret e nenit 6 të KEDNj-së, lidhur me standardin e një gjykate të formuar me ligj, si dhe pezullimin e gjykimit të çështjes, vendosi rrëzimin e tyre si të pabazuara në ligj e në prova.

*d) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

11. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 297, datë 17.09.2020, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Tritan Hamitaj, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi.

---

<sup>6</sup> Përreth 178 vendime që i përkasin juridiksionit të rivlerësimit, përkatësisht: 12 vendime në vitin 2018, 34 vendime në vitin 2019, 42 vendime në vitin 2020, 38 vendime në vitin ne 2021, 49 vendime në vitin 2022 dhe 3 vendime në vitin 2023, deri në marrjen këtij vendimi.

12. Trupi gjykues i Kolegjit, për të konkluduar mbi formën e gjykimit të çështjes, si dhe për të evidentuar shkeljet procedurale, vlerësoi të trajtojë në fillim shkaqet procedurale të ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit.

12.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se procedura e hetimit dhe e gjykimit, si dhe aktet/vendimet e Komisionit për këtë çështje janë të pavlefshme, pasi nuk janë marrë nga një gjykatë e formuar sipas ligjit, pasi caktimi i trupit gjykues të Komisionit është bërë në kundërshtim me nenin C, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, duke prekur përhershmerinë e trupave gjykuese. Rregullorja e Komisionit “*Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit*” vjen në kundërshtim me këtë dispozitë të Aneksit të Kushtetutës, gjë që cenon procesin e rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së, nenit 42, pika 2 dhe 179/b pika 2 e Kushtetutës, nenit 119 të Kodit të Procedurës Civile dhe vendimit unifikues nr. 2/2011, të Gjykatës së Lartë (paragrafi 10 dhe 11). Qëndrimi i Komisionit se përcaktimi i trupit gjykues të tij është në përputhje me nenin 14 të ligjit nr. 84/2016 është i gabuar, pasi kjo dispozitë nuk specifikon nëse trupat gjykues janë ose jo të përhershëm. Shkelja e rëndë procedurale e kryer hyn në rastet e parashikuara në nenet 53, shkronja “ç” dhe 54, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar<sup>7</sup>, si dhe nenin 467, paragrafi i parë, shkronja “b” të Kodit të Procedurës Civile, pasi përbërja e gjykatës nuk ka qenë e rregullt.

12.1.1. Në analizë të këtij shkakut ankimor, Kolegji me fokus dispozitat kushtetuese dhe ligjore të përmendura nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me përbërjen e trupit gjykues të Komisionit, konstaton se neni C, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, parashikon se *Komisioni i Pavarur të Kualifikimit përbëhet nga katër trupa gjykues të përhershëm me tre anëtarë secili*, ndërsa ligji nr. 84/2016, në nenin 14, pikat 1 dhe 2 të tij parashikon: “1. Komisioni organizohet në 4 trupa gjykuese të përbërë nga 3 anëtarë, të cilët caktohen me short. Anëtarët zëvendësohen me short. 2. Shpërndarja e çështjeve në trupat gjykuese bëhet me short, ku përcaktohet edhe anëtari relator”.

Në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të saj, si dhe të neneve 13, germa “d”, 14, pikat 1, 2 dhe 3 dhe 69, pika 4 të ligjit nr. 84/2016, mbledhja e anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me vendimin nr. 50, datë 18.10.2019<sup>8</sup>, miratoi rregulloren “*Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit*”. Miratimi i kësaj rregulloreje urdhërohet nga neni 69, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, që përcakton se: “*Procedura për zhvillimin e shortit të përcaktuar në nenet 14 dhe 15, të këtij ligji, miratohet, sipas rastit, me vendim të mbledhjes së anëtarëve të Komisionit ose të gjyqtarëve të Kolegjit të Apelit*”.

Në nenin 4 të rregullores, përcaktohet se: “1. Komisioni organizohet në katër trupa gjykuese, të përbërë nga tre anëtarë. [...] 3. Kryetari, me cilësinë e drejtuesit të shortit, përzgjedh në mënyrë rastësore tri gogla nga kutia transparente. Pasi i hap goglat një e nga një, lexon me zë të lartë emrat e tre komisionerëve, të cilët përbëjnë trupin e parë gjykues. 4. E njëjta procedurë, me të njëjtën radhë veprimesh, kryhet edhe për përcaktimin e tri trupave të tjera gjykuese. 5. Në përfundim të kësaj faze të hedhjes së shortit, Kryetari lexon edhe një herë me zë të lartë emrat e anëtarëve të çdo trupi gjykues”.

12.1.2. Në vlerësim të trupit gjykues të Kolegjit, rregullorja për zhvillimin e shortit në Komision nuk vjen në kundërshtim me nenin C, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, por është në zbatim të tij dhe të ligjit nr. 84/2016. Fakti që Komisioni në kuadër të procesit të rivlerësimit funksionon me katër trupa gjykues njëkohësisht me tre anëtarë secili bën që ky proces të jetë

<sup>7</sup> Ligji nr. 49/2012 “*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*”, i ndryshuar, (në vijim “*ligji nr. 49/2012, i ndryshuar*”).

<sup>8</sup> Ndryshuar me vendimin nr. 74, datë 14.12.2021 “*Për disa shtesa në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit*”.

në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore. Organizimi i shortit nga Komisioni, në përcaktimin e trupave gjykuese, është i bazuar dhe nuk cenon në asnjë rast procesin e rregullt ligjor. Organizimi i shortit përforcon këtë proces në aspektin e respektimit të procedurave ligjore në rast të heqjes dorë apo të kërkesave për përjashtim të komisionerëve brenda trupit gjykues. Trupi gjykues i Kolegjit gjen të drejtë arsyetimin e Komisionit, në paragrafin 25 të vendimit objekt shqyrtimi, se *as ligji organik dhe as Aneksi i Kushtetutës nuk ka vënë theksin në 4 trupa me anëtarë të përhershëm. Komisioni është i organizuar gjithmonë në 4 trupa gjykues dhe ky numër është i përhershëm [...]*. Nga analizimi i vendimit unifikues nr. 2, datë 24.01.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbi të cilin mbështet pretendimin subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren të jenë arsyetuar kushte të ndryshme nga ato të parashikuara në kuadër të procesit të rivlerësimit në Komision.

**12.1.3.** Ndërsa sa i përket pretendimit se shkelja e rëndë procedurale e kryer hyn në rastet e parashikuara në nenet 53, shkronja “ç” dhe 54, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, si dhe nenin 467, paragrafi i parë, shkronja “b” të Kodit të Procedurës Civile, që kanë të bëjnë me prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, pasi përbërja e gjykatës nuk ka qenë e rregullt, ky pretendim gjendet i pabazuar nga trupi gjykues i Kolegjit dhe bie ndesh me parashikimin e nenit F, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, që parashikon se *Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t’ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim*. Referuar jurisprudencës<sup>9</sup> të tij, Kolegji mund të urdhërojë Komisionin të vazhdojë të kryejë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, për kriteret e tjera për të cilat nuk ka kryer hetim apo nuk ka disponuar me vendim, por jo për kriterin për të cilin Komisioni është shprehur me vendim. Me fjalë të tjera, Kolegji, nëse do të konstatonte se subjekti i rivlerësimit arrin nivelin e besueshmërisë për vlerësimin e pasurisë, mund të urdhëronte Komisionin të kryente hetimin administrativ dhe të dilte me vendimmarrje për dy kriteret e tjera, të kontrollit të pastërtisë së figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

**12.2.** Sipas subjektit të rivlerësimit të gjitha vendimet e ndërmjetme gjatë hetimit administrativ, seancës dëgjimore dhe vendimi përfundimtar i Komisionit janë pasojë e shkeljeve të rënda procedurale, për shkak të pranisë së përkthyesit, në kundërshtim me nenin 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, nenin 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar dhe nenin 306 të Kodit të Procedurës Civile. Prania e përkthyesit nuk është as ligjore dhe as e nevojshme, kur neni 6, germa “gj” e ligjit nr. 84/2016 përcakton se anëtarët e Komisionit zotërojnë shumë mirë anglisht, që është edhe gjuhë zyrtare në Komision. Prania e përkthyesit pengon anëtarët e trupit gjykues të shprehen lirshëm për çdo çështje që diskutohet, nuk shmang mundësinë për të ndikuar në vendimmarrje, prek privatësinë/sekretin e dhomës së këshillimit, vjen në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, shkel procesin e rregullt ligjor dhe, për rrjedhojë, sjell pavlefshmërinë e të gjitha vendimeve të ndërmjetme dhe vendimit përfundimtar të Komisionit.

**12.2.1.** Lidhur me këtë shkak ankimor, dispozitat ligjore të sjella në vëmendje nga subjekti i rivlerësimit parashikojnë se:

Neni 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016: *5. Bisedimet për marrjen e vendimit ndaj subjektit të rivlerësimit zhvillohen me dyer të mbyllura në praninë e vëzhguesit ndërkombëtar. [...]. Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të shkruajë një mendim ndryshe/paralel që i bashkohet vendimit. [...].*

Neni 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012: *2. Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.*

Neni 306 i Kodit të Procedurës Civile: *Në dhomën e këshillimit, kur bisedohet çështja dhe*

---

<sup>9</sup> Shih vendimin nr. 14, datë 15.06.2021 dhe vendimin nr. 35, datë 22.09.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

*përpilohet vendimi, qëndrojnë vetëm gjyqtarët që përbëjnë trupin gjykues. Nuk lejohet që gjatë bisedimit të çështjes të hyjnë e të qëndrojnë aty sekretari i seancës, ekspertë ose persona të tjerë.*

**12.2.2.** Në përgjigje të shkakut ankimor, trupi gjykues i Kolegjit mban në konsideratë natyrën *sui generis* të procesit të rivlerësimit, që dallon jo vetëm nga proceset e zakonshme disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe nga proceset e tjera gjyqësore të karakterit penal, civil apo administrativ. Kushtetuta, aneksi i saj, si dhe ligji i posaçëm nr. 84/2016, janë kujdesur në përcaktimin e procedurave të procesit të rivlerësimit, duke orientuar zbatimin e ligjeve të tjera, vetëm në rast se ligji i posaçëm ka heshtur, duke dhënë mundësinë nëpërmjet nenit 4, pika 6 të tij të zbatimit *edhe të procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.* Në kushtet kur neni B, pikat 1 dhe 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 55 i ligjit nr. 84/2016, për vetë natyrën e këtij procesi, parashikojnë praninë e vëzhguesit ndërkombëtar në gjithë procesin e rivlerësimit, marrja pjesë dhe e përkthyesit për t’i ardhur në ndihmë atij dhe trupit gjykues nuk cenon procesin e rregullt ligjor dhe referimi në dispozita të tjera ligjore përtej këtij procesi mbeten pa efekt në këtë drejtim.

**12.2.3.** Përkthyesi në këtë proces nuk përfaqëson një subjekt procedural dhe roli i tij kufizohet vetëm në përkthimin nga gjuha shqipe në gjuhën angleze për të asistuar vëzhguesin ndërkombëtar në bisedimet e trupit gjykues. Një detyrim dhe garanci për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave me të cilat përkthyesit bien në kontakt gjatë punës së tyre është edhe pajisja e tyre me certifikatën për ruajtjen e informacionit të klasifikuar “Sekret”, nga DSIK-ja. Pavarësisht parashikimit të kriterit ligjor të zotërimit të gjuhës angleze nga anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, prania e përkthyesit duhet konsideruar një ekspertizë në garantimin e një procesi sa më të plotë e transparent. Për vetë natyrën e çështjeve që trajtohen gjatë procesit dhe terminologjinë e tyre të larmishme në shumë fusha specifike, prania e përkthyesve në këtë proces të konsiderohet një garanci e shtuar e, që në asnjë rast, nuk ndërhyjnë në bisedimet që zhvillojnë anëtarët e trupës gjyqësore.

**12.3.** Pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi i ndërmjetëm, për rrëzimin e kërkesës së tij të datës 14.09.2020 për përjashtim të trupit gjykues, me objekt *gjykim nga një trup i formular sipas ligjit*, lidhur me përhershshmërinë e trupit gjykues, është marrë në shkëlqje të rëndë procedurale dhe është absolutisht i pavlefshëm, pasi u mor nga i njëjti trup gjykues që gjykon çështjen, Kolegji e gjen të pabazuar.

**12.3.1.** Për vetë natyrën e saj, kjo nuk ishte një kërkesë e mirëfilltë për përjashtimin e trupit gjykues, në kuptim të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, të nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative apo të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, për më tepër që po gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe një kërkesë tjetër me objekt *gjykim nga një trup i formular sipas ligjit, i pavarur dhe i paanshëm*, sipas parashikimit në nenin 179/b, pika 6 e Kushtetutës dhe përjashtimin e trupit gjykues të Komisionit të përbërë nga komisionerët Suela Zhegu, Genta Bungo dhe Lulzim Hamitaj, që lidhen me procedurat dhe kushtet e zgjedhshmërisë së tyre.

**12.3.2.** Me administrimin e kësaj kërkesë, trupi gjykues i Komisionit vendosi të shtyjë seancën për të nesërmen më datë 15.09.2020, si dhe kaloi kërkesën e subjektit të rivlerësimit në Komision për shqyrtim nga një trup tjetër gjykues i përzgjedhur me short. Trupi gjykues i ngritur në Komision, me vendimin nr. 60, datë 14.09.2020<sup>10</sup>, më datë 15.09.2020, vendosi

<sup>10</sup> Me vendimin nr. 60, datë 14.09.2020, “Për ngritjen e një trupi gjykues që do të marrë në shqyrtim kërkesën e subjektit Tritan Hamitaj për përjashtimin e trupit gjykues që rivlerëson çështjen e tij”, me përbërje

mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit Tritan Hamitaj, si kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova. Sa më sipër, trupi gjykues nuk konstaton shkelje ligjore në trajtimin e këtyre kërkesave nga Komisioni.

12.4. Edhe për komisionerët pjesë të trupit gjykues, që vendosën mospranimin e kërkesës së sipërcituar, subjekti pretendon se vendimi i tyre është në kundërshtim me nenin 136, pika 3, nenin 179/b, pikat 2 dhe 6 të Kushtetutës, nenin C, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe vendimin nr. 11/2013, të Gjykatës Kushtetuese, pasi komisionerët nuk plotësojnë kriteret e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, janë zgjedhur në kundërshtim me kriteret ligjore, nuk janë të pavarur dhe të paanshëm, në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së, si gjykatë e formuar me ligj. Në vijim të arsyetimit, në paragrafët 10.1.1 deri 10.1.10 të këtij vendimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar dhe një përpjekje për të delegitimuar të gjithë procesin e rivlerësimit.

12.5. Në kuadër të respektimit të parimit të pavarësisë, subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje çështjen e GjEDNJ-së *Volkov kundër Ukrainës* lidhur me kriteret që duhet të përmbushë një organ që vendos masa disiplinore ndaj gjyqtarëve për të qenë i pavarur dhe i paanshëm, si: (i) përfaqësimi thelbësor i gjyqtarëve; (ii) mënyra e caktimit të anëtarëve të organit dhe ekzistenca e garancive ndaj presioneve të jashtme; (iii) dublimi i funksioneve [hetimor dhe vendimmarrës] mund të hedhë dyshime objektive mbi paanshmërinë e tyre; si dhe (iv) kohëzgjatja e mandatit. Të gjitha aktet ndërkombëtare, që synojnë të garantojnë pavarësinë e gjyqësorit, përcaktojnë se gjysma e organit që cakton masën disiplinore të shkarkimit të jenë gjyqtarë, që në momentin e emërimit janë në sistemin gjyqësor, si në rastin e KLGj-së dhe KLP-së. Rezultatet e punës së Komisionit, sipas subjektit të rivlerësimit, vlerësohen nga Qeveria, e cila në vitin 2018 i ka shpërblyer për performancën e tyre në vitin 2018. Anëtarëve të Komisionit u mungon profesionalizmi dhe eksperiencia e nevojshme për të trajtuar çështjet komplekse, teknike dhe të ndjeshme lidhur me procesin e rivlerësimit, kanë mandat të limituar, pamundësi riemërimi dhe zgjatje, gjë që i bën vulnerabël nga influencat politike dhe qeveritare. Këto pretendime të subjektit, trupi gjykues i analizon si vijon.

12.5.1. Për shkak të natyrës *sui generis* të procesit të rivlerësimit, referimi në jurisprudencën e GjEDNJ-së, tashmë orientohet nga vendimi i kësaj gjykate në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, që materializon vlerësimin e kësaj gjykate mbi institucionet e procesit të rivlerësimit në Shqipëri, në drejtim të garantimit të një procesi të rregullt ligjor. Konkretisht, në paragrafët 299 dhe 300 të këtij vendimi, GjEDNJ-ja ka theksuar se:

299. [...] gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky proces mori jetë në përgjigje të nevojës urgjente, siç vlerësohet nga legjislatura vendase, për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit që kishte pushtuar sistemin e drejtësisë. [...]. Dhe është pikërisht kjo arsyeja që procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri, është *sui generis* dhe duhet të dallohet nga çdo proces i zakonshëm disiplinor ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve.

300. Sipas këndvështrimit të gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces. Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin (shih paragrafin 123 më lart). Ajo vëren se këto anëtarë u përzgjedhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj [...].

**12.5.2.** Pretendimi për ndikimin e organeve politike mbi përbërjen e Komisionit, duke sjellë në vëmendje se 12 anëtarët e tij janë zgjedhur nga Kuvendi me një procedurë me shumë defekte dhe rezultatet e punës së tyre vlerësohen nga qeveria, gjen përsëri përgjigje në vendimin e sipërcituar të GjEDNj-së, në paragrafët 295 dhe 296, të tij:

*295 [...], megjithëse parimi i ndarjes së pushteteve midis organeve politike të qeverisë dhe gjyqësorit ka pësuar rritje në praktikën e saj gjyqësore, përzgjedhja ose emërimi i gjyqtarëve nga pushteti ekzekutiv ose legjislativ është i lejueshëm sipas Konventës, me kusht që, pasi të përzgjidhen ose emërohen, ata të jenë të lirë nga ndikimi ose presioni dhe të ushtrojnë veprimtarinë e tyre gjyqësore me pavarësi të plotë [...].*

*296. Edhe pse në përgjithësi gjykata nuk ka asnjë arsye të verë në pikëpyetje mënyrën në të cilën u emëruan anëtarët e KPK-së, përsëri i mbetet asaj të vlerësojë nëse, në çështjen në fjalë, KPK kishte “shfaqjen/dukjen e pavarësisë” që kërkohet nga praktika gjyqësore e Gjykatës në lidhje me masat mbrojtëse kundër presionit të jashtëm. Kërkesja nuk arriti të provojë se anëtarët e KPK-së që shqyrtuan çështjen e saj, kishin marrë ndonjë udhëzim ose kishin qenë nën presion nga pushteti ekzekutiv. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e çështjes, nuk rezulton të ketë ndonjë provë të një udhëzimi të tillë ose presioni që i është ushtruar trupit gjykues nga pushteti ekzekutiv. [...].*

**12.5.3.** Lidhur me pretendimin mbi mandatin e limituar, pamundësinë e riemërimit dhe zgjatjes së mandatit, sipas subjektit, i bënë anëtarët e Komisionit vulnerabël nga influencat politike dhe qeveritare, në paragrafin 297 dhe 298 të vendimit të sipërcituar, GjEDNj, shprehet:

*297. Në lidhje me kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve të këtyre organeve, Gjykata vëren se, në përputhje me ligjin e brendshëm, anëtarët e KPK-së kanë një mandat pesë-vjeçar pa të drejtë riemërimi. Sipas Gjykatës, kohëzgjatja e caktuar e mandatit të anëtarëve të organeve të rivlerësimit, nuk përbën asnjë problem. Duke supozuar që periudha kohore e përcaktuar ishte relativisht e shkurtër, kjo është e kuptueshme duke pasur parasysh natyrën specifike të procesit të rivlerësimit, siç vihet në dukje edhe më tej nga vendimi nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafin 164 më lart).*

*298. [...] As pushteti legjislativ dhe as ai ekzekutiv nuk mund të kërkojnë dorëheqjen ose largimin nga detyra të anëtarëve të organeve të vetting-ut. Neni 17 i ligjit nr. 84/2016 përcakton rastet specifike kur ata mund të hiqen nga detyra (shih paragrafin 127 më lart). Fakti që anëtarët e institucioneve të rivlerësimit mund të hiqen nga detyra vetëm në rast të kryerjes së një shkeljeje disiplinore, në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji, nuk vë në dyshim garancitë e nevojshme për mos-heqjen e tyre nga detyra, të cilat janë të pranishme në çështjen në fjalë.*

**12.5.4.** Lidhur me pretendimin e subjektit se kur një organ disiplinor ka luajtur një rol në hetimin paraprak dhe më pas ka marrë pjesë në vendimmarrjen e çështjes mund të hedhë dyshime objektive mbi paanshmërinë e atyre anëtarëve, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit në jurisprudencën e tij se kompetenca e Komisionit, për të kryer hetimin dhe për të dhënë vendimin, është në përputhje me natyrën e procesit të rivlerësimit, si një proces administrativ i nisur kryesisht, në përputhje me kompetencën që i njeh Kushtetuta dhe kreu VII, “Procedura e rivlerësimit”, i ligjit nr. 84/2016, në të cilin detajohen kompetencat hetimore dhe vendimmarrëse të Komisionit. Në paragrafët 307 dhe 308 të vendimit që i përket çështjes *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, GjEDNj-ja, shprehet se:

*307. Në momentin që KPK-ja mori vendimin, në përfundim të procesit, ai vlerësoi nëse provat e marra, përfshirë argumentet dhe dokumentet e parashtruara nga kërkesja si përgjigje, mjaftonin për ta konfirmuar atë në postin e saj ose për të vendosur një sanksion disiplinor në*

*përputhje me ligjin nr. 84/2016 [...] Konstatimet paraprake të bazuara në informacionin e disponueshëm, jo në përfitim të mbrojtjes së kërkujeses, nuk mund të konsiderohet se sjellin në vetvete ndonjë paragjykim për rezultatin përfundimtar që do të merret pas parashtrimeve të argumenteve të kërkujeses në seancë publike. Ajo që është e rëndësishme është që vendimi përfundimtar të merret në bazë të të gjithë elementeve në dispozicion, përfshirë provat e paraqitura dhe argumentet e parashtruara në seancë [...].*

*308. Prandaj, nuk ka asnjë ngatërresë mes detyrimit ligjor të KPK-së për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore të kërkujeses, dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkujeses. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, vetëm fakti i thjeshtë që KPK-ja konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkujeses nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e KPK-së.*

Sa më sipër, pretendimi i subjektit për cenim të parimit të paanshmërisë, pavarësisë, si dhe parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve në një demokraci funksionale, për rrjedhojë, të procesit të rregullt ligjor, për shkak se e njëjta trupë gjykuese heton dhe vendos, është i pabazuar.

**12.6.** Subjekti i rivlerësimit, gjithashtu, ka pretenduar se Komisioni, në kundërshtim me parimin e procesit të rregullt ligjor, nuk ka disponuar me vendim të ndërmjetëm lidhur me kërkesën e tij për përjashtimin e komisioneres Suela Zhegu, të paraqitur në seancën dëgjimore të datës 15.09.2020, kërkesë të cilën nuk e dërgoi për shqyrtim te një trup tjetër gjykues i Komisionit dhe as nuk mori një vendim vetë. Për rrjedhojë, vendimi përfundimtar, në të cilin ka votuar edhe komisionerja Zhegu është i pavlefshëm, për sa kohë nuk ka pasur një vendim bazuar në nenin 75, paragrafi i fundit<sup>11</sup> të Kodit të Procedurës Civile.

**12.6.1.** Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 15.09.2020, konstaton se: (i) subjekti i rivlerësimit është njoftuar për mospranimin e kërkesës së tij të datës 14.09.2020, për përjashtimin e trupit gjykues të përbërë nga Suela Zhegu, Genta Tafa (Bungo) dhe Lulzim Hamitaj; (ii) pasi relatorja e çështjes për rreth 1 (një) orë kishte relatuar të dhënat lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, dhe rreth 1 (një) orë pasi subjekti i rivlerësimit kishte paraqitur parashtrimet e tij, i rikthehet përsëri pretendimit lidhur me mënyrën e përzgjedhjes së anëtarë të Komisionit në kuadër të gjykatës së krijuar me ligj dhe procesit të rregullt ligjor dhe bën me dije faktin që gjatë kohës që relatorja po raportonte, ai ishte vënë në dijeni që me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 03.03.2017, të Avokatit të Popullit dhe znj. Zhegu nuk plotësonte kriterin e vjetërsisë në punë, duke i shtuar kërkesës së datës 14.09.2020 dhe këtë fakt për përjashtim.

**12.6.2.** Qëndrimin e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të kryer në Komision, trupi gjykues nuk e gjen korrekt pasi, përveç paraqitjes së kërkesave procedurale, të drejtë të cilën ia njeh ligji, ai duket se ka tendencën të zvarrisë procesin. Në kushtet kur vetëm një ditë më parë kishte paraqitur një kërkesë për përjashtimin e trupit gjykues, ku sa i përket komisioneres znj. Tafa (Bungo) i referohet të dhënave të nxjerra nga Avokati i Popullit, në shkresën drejtuar Kuvendit, asgjë nuk e pengonte që në këtë kërkesë të paraqiste edhe pretendimin mbi znj. Zhegu, pasi të dhënat për të dyja komisioneret ishin të përfshira në të njëjtin material. Në kushtet kur Komisioni më herët kishte vendosur mospranimin e kërkesës të datës 14.09.2020 për përjashtimin e trupit gjykues në të cilin bënte pjesë dhe znj. Zhegu, me arsyetimin se

---

<sup>11</sup> Neni 75 paragrafi i fundit i Kodit të Procedurës Civile parashikon: “Në këto raste gjykimi nuk pezullohet, por gjyqtari nuk mund të japë ose të marrë pjesë në dhënien e vendimit, derisa të jepet vendimi që e deklaron të papranueshme ose që e rrëzon kërkesën e përjashtimit”.



*legjitimiteti i anëtarëve të KPK-së është vlerësuar nga organet kushtetuese të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e bën të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi përfundimtar është i pavlefshëm.*

12.7. Komisioni nuk është shprehur me vendim të ndërmjetëm për marrjen dhe administrimin e provave si ato të kërkuara prej tij apo të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit. Nuk ka asnjë të dhënë si është nxjerrë analiza financiare dorëzuar me rezultatet e hetimit administrativ më 30.06.2020, mungojnë si provë aktet e Njësisë së Shërbimit Ligjor, që marrin vlerën e aktit të ekspertimit *de facto*, si dhe vendimi për marrje si provë të saj. Mosmarrja e provave me vendim të ndërmjetëm sjell shkelje të rëndë procedurale, cenon vendimin përfundimtar, i cili duhet të jetë i bazuar në prova, sipas nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

12.7.1. Lidhur me këto pretendime të subjektit, trupi gjykues sjell në vëmendje se procesi i rivlerësimit është një proces administrativ i iniciuar kryesisht. Referuar nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit hetojnë dhe vlerësojnë faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Gjatë hetimit administrativ ato kërkojnë informacion, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, duke bazuar vendimin vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Procedura për marrjen dhe administrimin me vendim të ndërmjetëm të provave gjatë hetimit administrativ, jo vetëm nuk është kërkuar nga ligji i posaçëm, por do të ishte e panevojshme, pasi të gjitha aktet shpresore, deri në seancën dëgjimore përfshirë dhe këtë të fundit, administrohen në dosjen gjyqësore dhe trajtohen në harmoni me provat e tjera. Për këtë arsye, analiza financiare kryhet mbi bazën e të dhënave të ekstraktuara nga aktet e administruara.

12.7.2. Komisioni, në paragrafin 37 të vendimit, është shprehur se [...] *kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar vetting; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar vetting të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shpresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shpresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; dhe (dh) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe shpjegimet gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.* Nga analizimi i vendimit rezulton se Komisioni i referohet si provave të administruara kryesisht, ashtu edhe atyre të dorëzuara nga subjekti në mbështetje të përgjigjeve dhe shpjegimeve të dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ. Ligji nr. 84/2016 nuk parashikon që gjatë hetimit në Komision administrimi i provave të bëhet me vendim të ndërmjetëm të trupit gjykues.

12.7.3. Referuar praktikës së konsoliduar tashmë, Komisioni shprehet me vendim të arsyetuar në vendimin përfundimtar apo me vendim të ndërmjetëm, në kuptim të nenit 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016, vetëm për refuzimin e kërkesave për marrje prove të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pas kalimit barrës së provës, në zbatim të nenit 52, pika 2 të këtij ligji. Është vetë Komisioni që i njofton subjektit të drejtën për të paraqitur kërkesë për marrje prove, ashtu siç ka ndodhur edhe në rastin objekt shqyrtimi, ku Komisioni është shprehur me vendimin nr. 3, datë 28.07.2020, lidhur me kërkesën e datës 27.07.2020 të subjektit të rivlerësimit. Analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, metodologjia e ndjekur nga Komisioni lidhur me të, gjen pasqyrim në rezultatet e hetimit administrativ paraprak, akt i cili rezulton që i është përcjellë subjektit të rivlerësimit dhe për të cilin ai ka paraqitur shpjegimet dhe provat në mbështetje të tyre.

**12.8.** Subjekti pretendon se Komisioni, për mënyrën e llogaritjes së shpenzimeve të jetesës, nuk ka respektuar ligjin, parimin e sigurisë juridike, të diskrecionit, proporcionalitetit dhe objektivitetit. Komisioni ka shkelur parimin e sigurisë juridike, pasi ka marrë vendime të ndryshme, mbi rrethana të ngjashme dhe metodologji të ndryshme, duke çuar në vendimmarrje subjektive dhe në mungesë të ligjit. Komisioni duhej t'i referohej minimumit jetik apo nivelit të varfërisë, si e dhënë e vetme objektive për të kryer këto llogaritje. Sipas tij, të dhënat e INSTAT nxirren mbi bazë anketash me të dhëna të pasakta dhe nivelet mesatare të shpenzimeve janë subjektive, nuk ka asnjë të dhënë se shpenzimet e subjektit, personave të lidhur e të tjerë të lidhur, të jetë shpenzuar në mënyrë mesatare, të njëtrajtshme dhe jo në kushtet e mbijetesës. Ligji nuk i ka dhënë Komisionit të drejtë të ushtrojë diskrecion në llogaritjen e shpenzimeve të jetesës. Komisioni nuk ka marrë parasysh, rast pas rasti e vit pas viti, strukturën e buxhetit të familjes, që sipas INSTAT-it përfshin një sërë zërash: (i) ushqim, pije jo-alkoolike duhan, veshje, këpucë, shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike, qira e paguar, mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës, shëndet, transport, komunikim, argëtim, kulturë, arsim, restorante dhe hotele, të tjera mallra dhe shërbime; (ii) nuk është bërë diferencim në moshë, në gjini, vendbanimin, si dhe nevojat e personit; (iii) referuar shpenzimeve të jetesës, sipas ILDKPKI-së, në shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 29.01.2019, shpenzimet për vitet 2000 e 2001 janë më të larta se ato të vitit 2002, ndërkohë që në vendin tonë ka pasur inflacion, së paku shpenzimet e vitit 2000 e 2001 të llogariteshin sa viti 2002; (iv) llogaritja e shpenzimeve të jetesës për vitet 1994-1999 është bërë pa vendim, ndërkohë që sipas shkresës së ILDKPKI-së rezulton një metodologji vetëm për shpenzimet e jetesës për vitet 2000-2016, pa pasur asnjë të dhënë dhe as metodologji për vitet më parë. Komisioni ka disa qëndrime në mënyrën e llogaritjes së shpenzimeve të jetesës, deri në vitin 1999 i ka llogaritur shpenzimet jetike të subjekti me 5.000 lekë në muaj, ndërsa prindërve 50% të pagës, ndërsa për familjen e bashkëshortes nuk ka asnjë të dhënë si janë llogaritur, mosarsyetime i tyre sjell një proces të parregullt ligjor. Kolegji dhe Komisioni, herë i referohen shpenzimeve në nivelin e varfërisë, herë shpenzimeve mesatare, herë sipas llogaritjes së ILDKPKI-së, po edhe këtu me dy metoda sipas ABF-së ose AMNj-së, herë me 30% e herë me 66%. Subjekti sjell në vëmendje qëndrime në jurisprudencën e Kolegjit, ku shpenzimet janë përlllogaritur referuar nivelit të varfërisë sipas EUROSTAT për shpenzimet e jetesës jashtë vendit<sup>12</sup>, për periudhën shtator-dhjetor 1999 janë konsideruar 66% e të ardhurave nga pagat dhe 30% të këtyre të ardhurave në raste të tjera<sup>13</sup>, dhe sipas shkresës së ILDKPKI-së<sup>14</sup> për periudhën 2000-2002. Subjekti i rivlerësimit i kërkon Kolegjit të rillogariten shpenzimet e jetesës bazuar në të dhëna ligjore, objektive dhe të sakta zyrtare, të korrigojë gabimet procedurale të Komisionit, t'i vendosë në dispozicion metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve dhe t'i japë kohë ta kundërshtoj atë. Trupi gjykues, për këto pretendime, konstaton:

**12.8.1.** Sa i përket shpenzimeve të jetesës, Kolegji ka orientuar Komisionin, nëpërmjet vendimeve të tij, për metodologjinë për përlllogaritjen e tyre, të cilës i nënshtrohen të gjitha çështjet e regjistruara për shqyrtim në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit. Në këtë këndvështrim, nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit për aplikimin e metodologjive të ndryshme në përlllogaritjen e tyre. Në rastet e konstatuara nga ana e subjektit, aplikimi i një metodologjie të ndryshme nga ajo e aprovuar në Kolegji është për shkak të rrethanave specifike në të cilat është mbajtur, gjithashtu, i njëjti qëndrim. Për hartimin e metodologjisë për përlllogaritjen e shpenzimeve jetike, Kolegji iu referua të dhënave të publikuara nga i vetmi burim zyrtar statistikor në vend për këtë qëllim<sup>15</sup>, INSTAT. Trupi gjykues e gjen qëndrimin e subjektit të rivlerësimit kontradiktor, pasi edhe pse kundërshton referimin te të dhënat e

<sup>12</sup> Vendimi nr. 28/2022 (JR), vendimi nr. 20/2019 (JR) .

<sup>13</sup> Vendimi (JR) nr. 14/2021, vendimi (JR) nr. 36/2020, vendimi (JR) nr. 5/2022

<sup>14</sup> Vendimi (JR) nr. 19/2019, vendimi (JR) nr. 14/2021.

<sup>15</sup> Të dhënat i janë përcjellë Kolegjit, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2019, nga ILDKPKI-ja.

INSTAT-it, përsëri kërkon që llogaritjet të mbështeten po në të dhënat e INSTAT, por në nivelin e varfërisë. Trupi gjykues sjell në vëmendje që ky institucion nuk referon të dhëna zyrtare për shpenzime jetese në nivel varfërie. Njëkohësisht, trupi gjykues e gjen të papranueshme kërkesën e subjektit të rivlerësimit për t'u trajtuar në këtë nivel, në kushtet e të ardhurave, pasurive të paluajtshme apartamente, njësi shërbimi e garazhe, nga të cilat gjeneron të ardhura të konsiderueshme nga dhënia e tyre me qira, si dhe shumatat monetare të dhëna hua prej tij me qëllim fitimin.

**12.9.** Mbyllja e hetimit dhe marrja e vendimit vetëm për kriterin e pasurisë, sipas subjektit të rivlerësimit, vjen në kundërshtim me përcaktimet kushtetuese, nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 6 të KEDNj-së. Subjekti i kërkon Kolegjit kryerjen e hetimit dhe për kriterin e kontrollit të figurës dhe aftësive profesionale. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson si vijon.

**12.9.1.** Neni Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës parashikon se *rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij Aneksi dhe ligjit*. Kjo dispozitë kushtetuese referon në ligjin e posaçëm, i cili lejon që organet e rivlerësimit vendimet t'i marrin mbi një, dy ose tri kriteret e rivlerësimit, ashtu siç përcakton qartësisht neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, që vendimi përfundimtar nga institucionet e rivlerësimit [...] *merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve ose në vlerësimin tërësor të procedurave*.

**12.9.2.** Ky qëndrim i Komisionit është konsoliduar tashmë dhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>16</sup>. Në zbatim të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për konfirmimin në detyrë të subjektit, kërkohet plotësimi së bashku i besueshmërisë dhe kualifikimit respektivisht për të tria kriteret e rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e pastërtisë së figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, edhe nëse vlerësimi për dy kriteret e tjera do të ishte pozitiv, institucionet e rivlerësimit japin masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në interpretim të këtyre dy dispozitave ligjore, nëse pas kalimit të barrës së provës subjekti i rivlerësimit arrin të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ për kriterin e vlerësuar, duke arritur nivel të besueshëm, Komisioni zhvillon hetim administrativ dhe i nënshton rivlerësimit edhe dy kriteret e tjera. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

**12.10.** Komisioni nuk ka bërë me dije emrat e personave që punojnë në Njësinë e Shërbimit Ligjor dhe aktet e tyre, që sipas nenit 22 të ligjit nr. 84/2016 bazohen në njohuri të posaçme dhe cilësitë e tyre barazohen me atë të ekspertit. Në këto kushte, subjekti do të kishte mundësi të verifikonte kushtet e paanshmërisë dhe njohurive të posaçme dhe në varësi të tyre të paraqiste kërkesa procedurale. Nuk ka asnjë të dhënë se cilët janë personat që kanë kryer analizën financiare të Komisionit, ndihmësi ekonomik është pjesë e Njesisë së Shërbimit Ligjor, të cilët zgjidhen dhe kanë varësi nga Komisioni. Njësia nuk mund të kryejë vlerësime për fakte dhe rrethana që kërkojnë njohuri të posaçme duke qenë në varësi të Komisionit. Ekspertimi në fushën e analizës financiare duhet të kryhet nga ekonomist të pavarur dhe të paanshëm, status të cilin nuk e ka Njësia. Analiza financiare duhet të ishte kryer në përputhje me nenin 224/a të Kodit të Procedurës Civile, nenin 49 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 80 të Kodit të Procedurave Administrative. Mosmarrja sipas procedurës ligjore sjell papërdorshmërinë e analizës së nxjerrë nga Komisioni, cenon vendimin e themelit dhe procesin e rregullt ligjor, i cili duhet të jetë i bazuar në prova, sipas nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>16</sup> *Shih, ndër të tjera, vendimet nr. 1, datë 31.01.2019, nr. 29, datë 08.11.2019; nr. 17, datë 15.07.2020, nr. 22, datë 22.07.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.*

**12.10.1.** Në kuptim të nenit 22, pika 1 dhe nenit 23 të ligjit nr. 84/2016, këshilltarët ligjorë dhe ekonomikë përbëjnë Njësinë e Shërbimit Ligjor që funksionon pranë Komisionit dhe Kolegjit, që ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse, nëpërmjet studimit të dosjes gjyqësore, përgatitjes së relacionit përkatës me karakter kërkimor dhe analizues, si dhe asiston procesin e vendimmarrjes në institucionet e rivlerësimit. Këshilltari ligjor apo ekonomik nuk është një figurë procedurale e këtij procesi dhe mosnjohja e identitetit të tij nuk përbën shkak për cenimin e një procesi të rregullt ligjor. Referuar nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni dhe Kolegji ushtrojnë funksionet e tyre si institucione rivlerësimi, të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Në kuptim të këtyre normave ligjore, Njësia e Shërbimit Ligjor ushtron detyrat e parashikuara në nenin 23 të këtij ligji, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, në respektim të legjislacionit në fuqi. Relacionet e këshilltarëve të Njësisë së Shërbimit Ligjor kanë natyrë këshilluese nga pikëpamja ligjore dhe ekonomiko-financiare, për trupin gjykues, por nuk janë detyruese për të. Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegji përgatit relacionin në përgjigje të shkaqeve të ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të kontrollit të vendimit të Komisionit, përfshirë këtu edhe kontrollin e analizës financiare të kryer prej tij. Në Kolegji, kur nuk vendoset çelja e hetimit gjyqësor, si në rastin objekt shqyrtimi, relacioni përgatitet mbi të njëjtat akte shkresore të administruara nga Komisioni e, në këto kushte, relacioni ekonomik i përgatitur në Kolegji nuk konsiderohet një relacion i ri, por verifikim i atij me të cilin subjekti i rivlerësimit është njohur në Komision, në drejtim të analizimit të shkaqeve ankimore të paraqitura.

**12.10.2.** Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson të pabazuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit drejtuar Kolegjit për marrjen si provë aktekspertimin financiar të kryer nga ekspertë të jashtëm, në përputhje me dispozitat e sipërcituara dhe qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 12/2003, si dhe një kopje formale dhe jo formale të analizës financiare. Ndërsa sa i përket mosvënies në dispozicion nga Komisioni të analizës financiare pas prapësimeve të subjektit, që sipas tij kanë vështirësuar realizimin e një mbrojtjeje efektive, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi kjo metodologji e Komisionit përdoret për të gjithë subjektet dhe nuk është aplikuar që pas dërgimit të shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjektit t'i përcillet një analizë e rishikuar financiar. Ky fakt reflektohet në vendimin përfundimtar, i cili merret pasi subjekti të ketë dorëzuar dhe prova të tjera deri në seancën dëgjimore, si dhe të jetë dëgjuar lidhur me parashtrimet e tij. Mosdakordësinë ndaj analizës financiare të pasqyruar në vendimin, subjekti mund ta kundërshtojë nëpërmjet ankimit në Kolegji.

**12.11.** Subjekti i rivlerësimit pretendon që Komisioni nuk i ka vënë në dispozicion aktet e mënyrës së organizimit të ONM-së, mandatin e vëzhguesve ndërkombëtar, zëvendësimin e tyre, arsyet e zëvendësimit të vëzhguesit etj., në kuadër të transparencës. Ky refuzim i bërë në seancë dëgjimore është në kundërshtim me parimin e transparencës, parashikuar nga neni C, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe të drejtën për të vlerësuar se procesi është i rregullt dhe ligjor në lidhje me subjektet proceduralë. Pavarësisht se nga parashikimet kushtetuese, ONM-ja nuk ka kompetencë vendimmarrëse, duke marrë parasysh angazhimet e shtetit shqiptar për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, gjetjet, rekomandimet apo kërkesat e ONM-së në këtë proces janë vendimmarrëse. Për një proces të rregullt ligjor, subjekti ka të drejtë të informohet mbi ONM-në, në kushtet kur nuk ka të dhëna në faqen e zyrtare dhe transparenca nuk është në nivelin e organeve shqiptare të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji korrigjimin e parregullsisë, duke e informuar për organizimin e brendshëm dhe vendimmarrjet e Komisionit Evropian për ONM-në, arsyet e zëvendësimit të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot dhe t'i jepet kohë e nevojshme për të bërë kundërshtimet e tij.

**12.11.1.** Nga analizimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 14.09.2020, duke marrë shkas nga zëvendësimi i vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, me z. Theo Jacobs, subjekti i rivlerësimit kërkoi të informohet lidhur me organizimin e ONM-së, rregulloren, funksionimin, emërimin dhe mandatin e tyre. Në kushtet kur kjo kërkesë nuk lidhej me aktivitetin e trupit gjykues të Komisionit, subjektit të rivlerësimit iu përgjigj vëzhguesi ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, si vijon: [...] *jemi thjesht vëzhgues, nuk kemi fuqi vendimmarrëse në proces, në fakt ne nuk mund të ankimojmë, ne thjesht rekomandojmë dhe kërkojmë që të apelohej, kështu që mos e mbivlerësoni kontributin tonë, kjo e para dhe e dyta ka të bëjë që vëzhguesit ndërkombëtar mund të vendosin midis tyre se kush do të bëjë secilën nga çështjet. Dhe për arsye të bazuara ne mund të shkëmbejmë çështjet në organizatën tonë, që do të thotë mund të fillohet me një vëzhgues dhe të përfundohet me një tjetër. Është absolutisht e mundur sepse jemi absolutisht të zëvendësueshëm. Vëzhguesit ndërkombëtar nuk jetojnë në mënyrë të përhershme në Shqipëri [...] që të mos pengojmë procesin e KPK-së dhe KPA-së, ne thjesht ndërrohem dhe vazhdojmë me çështjet. Kjo është e vetmja gjë që duhet të dini për ONM-në, nuk ka arsye të veçanta pse sot jam unë këtu dhe jo kolegu im. Herën tjetër do të zëvendësohem nga një kolegj tjetër kur të mos jem i disponueshëm, sepse jemi thjesht vëzhgues. Ata mund të punojnë përsosmërisht pa ne, por kanë gjithsesi nevojën që dikush ta vëzhgojë procesin dhe prandaj ndodhi edhe në këtë çështje.*

**12.11.2.** Është Kushtetuta, konkretisht neni B, pika 1 e Aneksit të saj, që parashikon prezencën e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, i cili *do të mbështesë procesin e rivlerësimit nëpërmjet monitorimit dhe mbikëqyrjes së gjithë procesit. Ky Operacion përfshin partnerët në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe bashkëpunimit euro-atlantik dhe udhëhiqet nga Komisioni Evropian.* Trupi gjykues vlerëson se shpjegimi i vëzhguesit ndërkombëtar është ezaurues. Për më tepër, informacion mbi Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit mund të gjendet edhe nga burime të hapura, si faqja zyrtare e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri<sup>17</sup>. Zëvendësimi i vëzhguesit ndërkombëtar nuk mund të perceptohet si një element që mund të cenojë transparencën e procesit të rivlerësimit, por garantist në zhvillimin e procesit të rregullt ligjor.

**12.12.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se koha që ka pasur në dispozicion për mbledhjen e provave të nevojshme ka qenë e kufizuar për shkak të prekjes nga Covid-19, situatës postraumatike dhe shëndetësore që shkakton ky virus, si dhe situatës së vështirë për të marrë dokumentet në një periudhë që institucionet ishin mbyllur. Kërkesa u rrëzua pa të drejtë duke vlerësuar se ishte me qëllim për zvarritje të procesit, ndërkohë që ishte e kundërta.

**12.12.1.** Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i akteve të fashikullit të Komisionit, konstaton se: (i) më datë 03.04.2020, Komisioni i përcjell subjektit të rivlerësimit pyetësin nr. 1, duke i lënë në dispozicion një afat 20-ditor, duke e njoftuar që ky afat për shkak të situatës së pandemisë me kërkesë mund të shtyhej; (ii) më datë 21.04.2020, subjekti paraqet kërkesë për shtyrje afati, e cila i pranohet nga Komisioni; (iii) më datë 28.05.2020, Komisioni i sjell në vëmendje subjektit që është në pritje të përgjigjeve të pyetësit; (iv) në të njëjtën datë, subjekti shprehet se disa nga institucionet ku ka drejtuar kërkesa nuk kanë kthyer ende përgjigje. Situata e krijuar, sipas tij, i ka pamundësuar kontaktet me të afërm të bashkëshortes, prej të cilëve duhet të merrte informacion mbi të ardhura të krijuara para vitit 2003. Subjekti shprehet se nuk ka neglizhuar apo tentuar të vonojë procesin, por derisa nuk ka mundur të sigurojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, nuk ka kthyer përgjigjet e pyetësit; (v) në përgjigje të këtij e-

<sup>17</sup>Shih: [https://www.eeas.europa.eu/delegations/albania/most-frequently-asked-questions-international-monitoring-operation-imo\\_en?s=214](https://www.eeas.europa.eu/delegations/albania/most-frequently-asked-questions-international-monitoring-operation-imo_en?s=214); [https://www.eeas.europa.eu/delegations/albania/international-observer-international-monitoring-operation-imo\\_en?s=223](https://www.eeas.europa.eu/delegations/albania/international-observer-international-monitoring-operation-imo_en?s=223), [https://www.eeas.europa.eu/node/23549\\_en](https://www.eeas.europa.eu/node/23549_en)

*mail*-i, Komisioni, më datë 29.05.2020, duke shprehur mirëkuptim, njofton subjektin për kthimin e përgjigjeve, ndërkohë në lidhje me dokumentacionin që mungon sqaron se duhet të provojë pamundësinë momentale për disponimin e tij me anë të provave shkresore. Përgjigjet e pyetësorit të datës 03.04.2020, përcillen nga subjekti i rivlerësimit më datë 01.06.2020.

**12.12.2.** Me *e-mail* të datës 04.06.2020, në lidhje me përgjigjet e pyetësorit të datës 03.04.2020, subjekti i rivlerësimit përcjell nxjerrjen e llogarisë bankare pranë “Raiffeisen Bank” ShA, për Rr. H.. Më 07.06.2020, subjekti i rivlerësimit informon Komisionin mbi situatën psikologjike të tij dhe të bashkëshortes. Procesi i rivlerësimit, sipas tij, ka qenë i vështirë, stresues dhe jo i zakonshëm, i cili kërkon kohë, qetësi dhe vëmendje maksimale në marrjen e provave dhe kthimin e përgjigjeve. Subjekti sjell në vëmendje të Komisionit dhe gjendjen shëndetësore të të birit, fakt që ka shkaktuar rëndesë psikologjike për prindërit. Subjekti i kërkon Komisionit të marrë në konsideratë këto situata specifike në vlerësimin e përgjigjeve të tij, në drejtim të ndonjë pasaktësie apo harrrese, që përbëjnë gabime njerëzore dhe jo tendencë për të fshehur të vërtetën.

**12.12.3.** Më datë 30.06.2020, Komisioni i përcjell subjektit rezultatet e hetimit administrativ të kryer, e fton të njihet me aktet e dosjes dhe të marrë kopje të tyre, duke i lënë një afat deri më 15.07.2020, për të paraqitur prapësimet. Më datë 09.07.2020, subjekti i rivlerësimit njofton se ka rezultuar pozitiv me Covid-19 dhe kërkon shtyrje të afatit për provat dhe prapësimet. Më datë 15.07.2020, subjekti i rivlerësimit vendos në dispozicion të Komisionit: (i) raport mjekësor lëshuar nga mjekja e familjes më datë 03.07.2020; dhe (2) përgjigjen e Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Durrës nr. {\*\*\*}, datë 10.07.2020, duke kërkuar shtyrjen e afatit për të kërkuar provat e paraqitur prapësimet minimalisht deri në fund të muajit korrik. Kjo kërkesë i pranohet nga Komisioni, duke shtyrë afatin për në datën 31.07.2020. Në këtë datë, subjekti përcjell prapësimet mbi rezultatet e hetimit, analizën financiare dhe kërkesën për marrje provash. Subjekti i rivlerësimit ka vijuar të dërgojë prova edhe në datat 02.08.2020, 20.08.2020, 03.09.2020 dhe 06.09.2020.

**12.12.4.** Pasi i është njoftuar data e seancës dëgjimore, e cila ishte caktuar më 10.09.2020, subjekti më datë 08.09.2020 paraqet kërkesë për të shtyrë seancën, pasi bashkëshortja dhe i biri i ishin nënshtruar testimit për Covid-19 dhe ishin rekomanduar të karantinoheshin si familje. Komisioni i drejtohet, nëpërmjet *e-mail* të datës 09.09.2020, Shefes së Epidemiologjisë dhe Shëndetit Mjedisor Durrës, znj. M. O., me kërkesë për informacion zyrtarisht, lidhur me faktin nëse ka planifikim për tampon znj. R. H. dhe faktin nëse z. Tritan Hamitaj, që ka kaluar Covid-19 gjatë muajit korrik, përbente rrezik për infektimin e personave tjerë në ambiente publike. Në përgjigje të kësaj kërkesë, znj. O. shprehet se znj. R. H. nuk i është marrë tampon, ndërsa Tritan Hamitaj ka rezultuar pozitiv më datë 07.07.2020 dhe në bazë të protokollit të negativizimit (në ritestimin që bëhet pas 14 ditëve nga konfirmimi), personi konsiderohet i shëruar.

Ndërsa, pas kërkesës së Komisionit, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 09.09.2020, Instituti i Shëndetit Publik informon se Tritan Hamitaj ka rezultuar pozitiv me Covid-19, më datë 09.07.2020, riestimi më datë 21.07.2020 ka rezultuar negativ dhe si çdo person tjetër kur del negativ është i aftë të kthehet në detyrë, si dhe paraqet nivel mbrojtje kundër ri-infeksionit për të paktën 3 muaj.

**12.12.5.** Komisioni, më datë 09.09.2020 e njoftoi subjektin për refuzimin e kërkesës, pasi ishte e pashoqëruar me provë shkresore, si dhe referuar informacionit të marrë nga Instituti i Shëndetit Publik, nëpërmjet shkresës së sipërcituar, subjekti rezulton negativ pas testimit të datës 21.07.2020 dhe në gjendje të kthehet në detyrë. Rastet që kanë kaluar Covid-19 paraqesin nivel mbrojtje kundër ri-infeksionit të paktën 3 muaj. Po në datën 09.09.2020, subjekti i

rivlerësimin njofton se e ka të pamundur të paraqitet në seancë dëgjimore të nesërmen, për shkak të probleme shëndetësore, duke kërkuar shtyrjen e seancës dhe përcjell raportin për paaftësi të përkohshme në punë për 3 ditë deri më datë 12.09.2020. Më datë 10.09.2020, subjekti i rivlerësimin njoftohet se seanca dëgjimore do të zhvillohet më datë 14.09.2020, ora 14:30. Për sa më sipër, trupi gjykues konstaton se pretendimi i subjektit të rivlerësimin për kohë të pamjaftueshme është i pabazuar.

**12.12.6.** Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i procesverbalit të seancës dëgjimore, konstaton se që në fillim të saj subjekti i rivlerësimin ka kërkuar që seanca dëgjimore të shtyhet, në mënyrë që ai të paraqesë të gjithë provat e nevojshme, në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, duke kërkuar 3 muaj kohë. Subjekti kërkesën e mbështet në vështirësinë në mbledhjen e provave, për shkak të dinamikës së lëvizjeve të tij nga viti 2003 e në vijim, numrin e personave të tjerë të lidhur (më shumë se 6), shtrirja në një kohë tejet të largët të këtyre provave, barrën e provës mbi më shumë se 46 çështje, pasojat shëndetësore të krijuara nga situata e infektimit nga Covid-19, si dhe angazhimin profesional e familjar. Trupi gjykues i Komisionit, pasi u tërhoq për të shqyrtuar kërkesën, vendosi refuzimin e saj, si një kërkesë e përsëritur dhe e pabazuar.

**12.13.** Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimin, ka shkelur parimin e të drejtës për t'u dëgjuar plotësisht në seancë dëgjimore, duke mos i dhënë të drejtën të bëjë prapësimet, por është urdhëruar të flasë vetëm për gjëra të reja të patrajuara në prapësime, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 20 të Kodit të Procedurës Civile.

**12.13.1.** Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i procesverbaleve të seancave dëgjimore në datat 14.09.2020 dhe 15.09.2020, konstaton se këto seanca kanë zgjatur 32 minuta dhe 2 orë e 40 minuta, respektivisht. Gjatë seancës së datës 15.09.2020, pas përfundimit të relatimit mbi rezultatet e hetimit nga relatorja e çështjes, subjekti i rivlerësimin ka kërkuar edhe pasqyrimin e prapësimeve të tij, duke mos u mjaftuar vetëm me përmendjen e faktit që ka paraqitur prapësime dhe prova, të cilat do të merren parasysh në vendimin përfundimtar.

**12.13.2.** Këtij pretendimi i është përgjigjur gjatë seancës relatorja e çështjes në Komision duke e sqaruar se ky është një proces tashmë i konsoliduar prej tre vjetësh, ku gjatë seancës relatori paraqet rezultatet e hetimit dhe subjekti i rivlerësimin ka të drejtë të paraqesë provat dhe shpjegimet e tij, të drejtë që subjekti e ka shfrytëzuar. Seanca dëgjimore nuk është për të përsëritur atë që tashmë është thënë, por ideja e seancës është mbrojtja efektive, që në pjesën më të madhe është bërë. Seanca dëgjimore është për ato gjëra që subjekti do të shtojë, si dhe për t'i dhënë mundësi trupës gjyqësore dhe vëzhguesit ndërkombëtar për të bërë pyetje mbi materialin e studiuar.

**12.13.3.** Kryesuesja e trupit gjykues në Komision i ka sugjeruar subjektit të rivlerësimin që *do të doja që të ishit sa më konciz në fjalën tuaj*. Për sa më sipër, pretendimin e subjektit të rivlerësimin, trupi gjykues e konsideron të pabazuar, pasi kërkesa për të ekonomizuar kohën gjyqësore dhe orientimi i kryesueses për të qenë më konciz është diçka që ndodh në praktikën gjyqësore dhe nuk mund të konsiderohet cenim i parimit të kontradiktoritetit.

**12.14.** Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni, si organ për të hetuar dhe njëkohësisht për të gjykuar, kishte detyrimin t'i vinte në dukje gjetjet e tij, të cilat do ta çonin drejt shkarkimit nga detyra, me qëllim që të realizonte mbrojtje efektive, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim nuk është i mbështetur në ligj, për arsye se qëllimi i hetimit administrativ nuk është të njoftojë apo t'i bëjë të ditur subjektit të rivlerësimin se provat e grumbulluara mund të çojnë drejt prezumimit të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sikurse pretendon subjekti në çështjen konkrete, por se provat e grumbulluara kishin mjaftueshëm nivelin e provueshmërisë për të mbështetur konstatimet e Komisionit në përfundim të fazës së hetimit administrativ. E kundërta, pra, nëse Komisioni do të kishte përcaktuar që me rezultatet e

hetimit, referencën apo pasojën ligjore, ky fakt do të përbënte paragjykim të vendimit nga ana e Komisionit, që bazuar në nenin 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 i zhvillon bisedimet për marrjen e vendimit pas zhvillimit të seancës dëgjimore.

**12.15.** Pretendimin e subjektit se barra e provës mund të vendoset vetëm në dy raste të parashikuara nga neni D, pikat 4 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në rastin objekt shqyrtimi nuk rezulton të jetë konkluduar as se pasuria e subjektit të rivlerësimit ka qenë më e madhe se dyfishi i asaj të ligjshme dhe as nuk është konkluduar se pasaktësitë në deklarimin e pasurisë kanë qenë me qëllim fshehje, trupi gjykues e çmon të pabazuar. Fillimisht parashikimet kushtetuese të sjella në vëmendje nga subjekti i rivlerësimit nuk pengojnë kalimin e barrës së provës në kuptim të nenit 52 e ligjit nr. 84/2016, në rastet kur nga hetimi administrativ Komisioni arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë lidhur me mungesën e burimeve financiare të ligjshme apo me paqartësitë e konstatuara gjatë hetimit e, në këto kushte, subjektit i kalohet barra për të paraqitur prova dhe dhënë shpjegime për të provuar të kundërtën. Në rastin objekt shqyrtimi, përveç mungesës së burimeve financiare të ligjshme dhe pasaktësive të konstatuara, Komisioni ka ngritur disa herë dyshime për pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, sa i përket: (i) pjesës takuese në tokën bujqësore të përfutur nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar; (ii) apartamentit me sipërfaqe 103,82 m<sup>2</sup> në Tiranë; dhe (iii) apartamentit në përdorim të tij me sipërfaqe 146 m<sup>2</sup>.

**12.16.** Sipas subjektit, Kushtetuta në nenin D të Aneksit nuk ka deleguar nxjerrjen e një ligji për të përcaktuar detaje të mëtejshme procedurale. Në këto kushte, ky nen nuk ka vendosur një afat kalendarik se kur duhet të deklarohet burimi dhe e ardhura, por ka vendosur detyrimin që të jetë deklaruar. Kjo do të thotë që pasaktësitë në deklarimin e burimit dhe të të ardhurave janë të riparueshme gjatë hetimit administrativ deri sa nga organi i rivlerësimit nuk është dhënë një vendim përfundimtar. Kjo ka qenë një praktikë e krijuar nga ILDKPKI-ja, që nuk vjen në kundërshtim me nenin D, paragrafi 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe duhet zbaruar si praktikë e mirë nga organi i rivlerësimit, për shkak të parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërisë të subjektit të rivlerësimit në zbatimin e ligjit [shih vendimin nr. 36, datë 15.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese].

**12.16.1.** Në analizë të këtij pretendimi, në kuadër të procesit të rivlerësimit, neni D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës parashikon se *subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin dhe ky deklarim, në kuptim të pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë një deklarim saktësisht dhe plotësisht i pasurive*. Format i deklaratës së pasurisë *vetting*, sipas shtojcës 2, është miratuar me ligjin nr. 84/2016, parashikuar në nenin 31, pika 1 të tij dhe plotësohet brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Në kushtet kur vlerësimi i kriterit të pasurisë është konkluzion mbi deklaratën e pasurisë *vetting*, dispozitat ligjore nuk legjitimojnë pretendimin e subjektit që mjafton të deklarosh dhe burimin mund ta plotësosh gjatë hetimit administrativ, pasi subjekti duhet të deklarojnë në mënyrë shteruese pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre, të shoqëruara me dokumentacion provues. Për të udhëzuar subjektet e rivlerësimit në plotësimin e deklaratës, ILDKPKI-ja miratoi udhëzimin nr. 4095, datë 10.10.2016 “*Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016*”.

**12.16.2.** Pavarësisht sa më sipër, institucionet e rivlerësimit nuk kanë ngritur në shkak shkarkimi nga detyra pasaktësitë në plotësimin e deklaratës së pasurisë *vetting*, të sqaruara gjatë hetimit administrativ me dokumentacion provues, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka provuar që ka qenë me mirëbesim, si dhe kur nuk ka rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme.



**12.17.** Lidhur me pretendimin se mosdeklarimi i të ardhurave në deklaratën e pasurisë *vetting* sjell mospërfshirjen e tyre në analizë financiare është në kundërshtim me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, ligjin nr. 84/2016 dhe parimin e sigurisë juridike, në vijim të paragrafit pararendës, trupi gjykues vlerëson se:

**12.17.1.** Subjektet e rivlerësimit kanë pasur detyrimin, që në zbatim të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, të deklarojnë saktë pasuritë, të ardhurat, detyrimet e shpenzimet e tyre në deklaratat periodike të interesave privatë. Në kuadër të procesit të rivlerësimit, subjektet duhet të deklaronin saktësisht dhe plotësisht pasuritë, të ardhurat dhe detyrimet ndaj të tretëve në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në këtë kuptim, një e ardhur që subjekti i rivlerësimit nuk e deklaron do të thotë që nuk e ka pasur dhe nuk i ka shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie apo shpenzimi të kryer. Megjithatë, kur subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ provon bindshëm me dokumentacion justifikues ligjor ekzistencën e kësaj të ardhure dhe mosdeklarimi i saj nuk është i qëllimshëm, kjo rrethanë është konsideruar pasaktësi, e cila, pasi është arsyetuar, nuk është ngritur në nivelin e dhënies së një mase disiplinore. Kolegji në jurisprudencën e tij ka trajtuar gjerësisht çështjen e deklarimit të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke e vlerësuar nën dritën e rrethanave konkrete dhe provave të administruara rast pas rasti.

**12.18.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se shkaqet e shkarkimit të parashikuara nga neni D nuk kanë lidhje me arsyet e shkarkimit të tij nga detyra. Ky nen nuk delegon nxjerrjen e ligjit për raste të tjera shkarkimi. Neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 është shtuar në ligj i paparashikuar apo deleguar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës. Termi deklarim i pamjaftueshëm është antikushtetues, evaziv, krijon mundësi të ndryshme interpretimi, krijon pabarazi në zbatimin e ligjit dhe shkel parimet kushtetuese të parashikuara në nenet 4 dhe 18 të Kushtetutës. Ky term nuk mund të interpretohet se rrjedh nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, që është një dispozitë procedurale dhe jo materiale. Subjekti pretendon që Kolegji, bazuar në nenin 145 të Kushtetutës, të vendos pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatë Kushtetuese për shfuqizimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në kushtet kur vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese nuk ka një kërkim për papajtueshmëri me Kushtetutën të kësaj dispozite, nuk përbën *gjë të gjykuar*. Në lidhje me evazivitetin e fjalëve “deklarim i pamjaftueshëm” Gjykata Kushtetuese nuk është shprehur, megjithëse ka pasur një kërkim. Në këto kushte, Kolegji duhet t’i kërkonte Gjykatës Kushtetuese plotësimin apo interpretimin e vendimit për këtë pjesë.

**12.18.1.** Në lidhje me këtë shkak ankimor, trupi gjykues vlerëson se parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 nuk vijnë në kundërshtim me nenin D e Aneksit të Kushtetutës, por plotësojnë dhe detajojnë parashikimet kushtetuese dhe vullnetin e ligjvënësit në kuadër të procesit të rivlerësimit. Në kushtet kur ky proces është pjesë e paketës ligjore që materializuan Reformën në Drejtësi, si me ndryshimet kushtetuese me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, me të cilin është shtuar edhe Aneksi i Kushtetutës, ashtu edhe me ligjin nr. 84/2016, datë 30.08.2016, parashikimet e këtij të fundit, me konsideratë dhe natyrën *sui generis* të këtij procesi, nuk vijnë në kundërshtim me parashikimet e Kushtetutës.

**12.18.2.** Për më tepër, kur ligji nr. 84/2016 iu nënshtroi kontrollit të kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese, e cila në çështjen me objekt shfuqizimi si të papajtueshëm me Kushtetutën të këtij ligji dhe pezullimin e zbatimit të tij, me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017, vendosi rrëzimin e kërkesës. Në këto kushte, edhe pse Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nuk ka vlerësuar shprehimisht kushtetutshmërinë e kësaj dispozite, ky nen si pjesë e ligjit nuk është vlerësuar në kundërshtim me Kushtetutën. Vlen të theksohet se zbatimi i nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është trajtuar gjerësisht dhe zbatuar në jurisprudencën e institucioneve të

rivlerësimit dhe kërkesa e subjektit për pezullimin e procesit është e pabazuar.

**12.19.** Sipas subjektit, deklarimi i pamjaftueshëm, që të çojë në kushtet e shkarkimit nga detyra, duhet të konkludohet edhe për kriterin e kontrollit të figurës, për sa kohë dispozita ligjore përdor dy herë lidhëzën “dhe”. Në të kundërt, ligji nuk kishte përse të parashikonte pikën 1 të nenit 61 si shkak shkarkimi në lidhje me pasurinë, por do të mjaftohej me deklarin e pamjaftueshëm nëse subjekti nuk mbulon pasurinë me burime të ligjshme. E njëjta logjikë dhe për kriterin e kontrollit të figurës, në raport me nenin 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Për këtë arsye, neni 61, pika 3 kërkon që të ekzistojnë njëkohësisht e në mënyrë kumulative dy pamjaftueshmëritë për të përbërë shkak shkarkimi nga detyra.

**12.19.1.** Për këtë pretendim, Kolegji ka një qëndrim të konsoliduar në jurisprudencën<sup>18</sup> e tij, në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit vlerësimi i kriterit të pasurisë dhe pastërtisë së figurës, respektivisht, mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nëse deklarimi i subjektit, për kriterin objekt shqyrtimi, vlerësohet i pamjaftueshëm.

**12.20.** Sipas subjektit të rivlerësimit, neni 48 i ligjit nr. 84/2016 është një dispozitë procedurale që ndikon në mënyrën e vlerësimit të deklarin, por nuk mund të sjellë masë disiplinore, pasi subjekti ka të drejtën të heshtë dhe heshtja nuk penalizon. Qëndrim ky i mbajtur edhe nga GjEDNj-ja<sup>19</sup>. Përgjigjet e sakta dhe mosparaqitja e dokumenteve kanë qenë për shkaqe objektive dhe jo subjektive, duke mos pasur asnjë provë që mbështet konkluzionet e Komisionit për këtë fakt. Konkluzioni i Komisionit se subjekti me sjelljen e tij ka humbur besimin e publikut është i pabazuar në ligj e prova, pasi sjellja e subjektit ka qenë ligjore dhe në përputhje me mundësitë objektive për të ruajtur në kujtesë e për të disponuar dokumente. Termi “*besim i publikut*” është evaziv dhe, si i tillë, antikushtetues, pasi nuk ka një përkufizim në ligj dhe hapësira interpretative e tij sjell vendime të ndryshme për çështje të njëjta, çka bie ndesh me parimin e sigurisë juridike, që nënkupton qartësinë e normës juridike, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti dhe institucionet e tij, si dhe aktet që ato nxjerrin. Për më tepër ky term nuk lidhet me asnjë nga tri kriteret e këtij procesi. Ky shkak shkarkimi vjen në mospërputhje me vetë ligjin. Vendimi i Komisionit mbi raportin e subjektit me publikun është i paarsyetuar, pasi besimi është një çështje mes tyre apo kur veprimet janë të hapura dhe publiku ka mundësi t’i shohë. Nuk është kryer një hetim sa është graviteti i sjelljes së subjektit që të çojë në humbje besimi, nëse janë dhënë vendime të padrejta apo nëse subjekti ka shkelur ligjin gjatë punës së tij. Zbatimi i ligjit nr. 84/2016 duhet bërë në funksion të qëllimit të daljes së tij, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, pra, të një interpretimi teleologjik, pastaj sistematik e në fund të ngushtë e literal sipas dispozitës.

**12.20.1.** Në analizë të këtij pretendimi, neni 179/b, pika 1 parashikon se rivlerësimi ka për qëllim të garantojë funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut te drejtësia. Sa i përket termi “*besim i publikut*”, vërtet ligji nuk i ka dhënë një përkufizim, megjithatë ai gjen vend në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, që përcakton qëllimin e këtij procesi dhe nenin 61, pika 5 të tij, i cili parashikon shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit në rastin kur nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit, rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit. Ky nen të orienton në përcaktimet e nenit 4, pika 2 e këtij ligji, sipas së cilit vendimi në kuadër të këtij procesi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve ose në *vlerësimin tërësor të procedurave*. Në këto kushte, parashikimi në nenin 48 të ligjit se

<sup>18</sup> *Shih vendimin nr. 33, datë 29.07.2022, paragrafi 19 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.*

<sup>19</sup> *O’Halloran dhe Francis kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikimi nr. 15809/02 dhe 25624/02), Shannon kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikimi nr. 6563/03.*

në marrjen e vendimit Komisioni dhe Kolegji mbajnë parasysh gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit nuk mund të përjashtohet nga analizimi në kuadër të cenimit të besimit të publikut. Bashkëpunimi me Komisionin, në kuptim të këtij neni, bën pjesë në vlerësimin tërësor të procedurave dhe sjellja e subjektit gjatë këtij procesi vlerësohet në vendimmarrje.

**12.21.** Nga analizimi i shkaqeve procedurale të ankimit, trupi gjykues nuk konstatoi shkelje procedurale që të kërkojnë shqyrtimin gjyqësor publik të çështjes, në kuptim të nenit 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012.

13. Subjekti i rivlerësimit e ka shoqëruar ankimin e tij me një sërë aktesh shkresore<sup>20</sup>, të cilat kërkon të administrohen në cilësinë e provës, si dhe i drejton Kolegjit kërkesën për: (i) këqyrjen në vend të parcelave tokë arë, vreshtit dhe ullinjve, me qëllim që të provohet gjendja e faktit se ekzistojnë vreshti dhe ullinjte dhe që nxjerrin të ardhura; (ii) kryerjen e aktekspertimit agronomik ose marrjen si provë të aktit të bërë prej ekspertes agronome R. M.; (iii) marrjen e vendimeve gjyqësore<sup>21</sup> pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, që përfshijnë praktika gjyqësore për të llogaritur të ardhurat nga toka bujqësore, të përgatitura nga eksperte R. M.; (iv) marrjen e të dhënave për hyrje-daljet në pikën kufitare Kakavijë, për shtetasin grek H. K., në periudhën 10.01.1992-25.01.1992; (v) marrjen e të dhënave pranë organeve tatimore dhe nga shoqëritë “{\*\*\*}” dhe “{\*\*\*}”, në lidhje me zbatimin e kontratave në datat 14.04.2015 dhe 16.04.2015, si dhe dinamikën e marrëdhënieve të tyre deri në datën 17.11.2015; (vi) këqyrjen e apartamentit me nr. pasurie {\*\*\*}, ZK nr. {\*\*\*}, në Durrës, me qëllim evidentimin e orendive dhe kryerjen e aktekspertimit për vlerësimin e tyre; (vii) këqyrjen e apartamentit 1+1, me sipërfaqe 78,24 m<sup>2</sup> dhe të apartamentit me sipërfaqe 146,3 m<sup>2</sup>, me qëllim evidentimin se të dy apartamentet nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin; (viii) marrjen e të dhënave nga Instituti i Kulturës Italiane, lidhur me punësimin e bashkëshortes, në kushtet kur mungon bashkëpunimi i këtij institucioni për të vënë në dispozicion dokumentet e nevojshme; (ix) marrjen e të dhënave nga noter, AShK, dogana, tatime, etj., për të provuar qëllimin e marrjes së huas, aftësinë paguese, pagesën e detyrimeve tatimore të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Subjekti pretendon se ka ezauruar kërkesat e tij ndaj shoqërisë dhe institucioneve për marrjen e provave.

**13.1.** Përmbushjen e kërkesave të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012<sup>22</sup> dhe përligjjen e mungesës së fajit, si element që do të kënaqte këtë nen, subjekti i rivlerësimit e referon te fakti se hetimi u mbyll duke i mohuar të drejtën për të paraqitur prova shtesë. Legjitimi i marrjes së këtyre provave, sipas subjektit, bazohet në rrethanat objektive, shëndetësore, vështirësi në mbledhjen e tyre, volumin dhe shtrirjen kohore të pretenduara në seancën dëgjimore. Nisur nga sa parashtruar më sipër në trajtimin e shkaqeve me natyrë procedurale, trupi gjykues konstaton se

<sup>20</sup> i. Vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2020 i Bashkisë Mallakastër; ii. vërtetim datë 27.10.2020 i kryetarit të fshatit {\*\*\*}, Bashkia Mallakastër; iii. kontratë sipërmarrje e nënshkruar mes “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” Group, datë 14.04.2015; iv. procesverbal zbatimi kontrate “{\*\*\*}” dhe “{\*\*\*}” Group”, datë 24.10.2018, së bashku me akt sqarimin drejtuar znj. R. H.; v. kontratë sipërmarrje e nënshkruar mes “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” Group, datë 16.04.2015; vi. e-mail i nisur më 22.05.2020, në adresën {\*\*\*}; vii. përgjigje e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, datë 04.11.2020, shoqëruar nga libri i arkës për muajin gusht 2009 dhe pasqyrën financiare të këtij viti; viii. përgjigje e Spitalit Rajonal Durrës nr. {\*\*\*} prot., datë 3.11.2020;

<sup>21</sup> i. Vendimi nr. {\*\*\*} sistemi, datë 07.12.2016, me palë paditës A. K., i paditur Q. K.; ii. vendimi nr. {\*\*\*} sistemi, datë 09.07.2012, me palë paditës A. Sh., i paditur Bashkia Patos; iii. vendimi nr. {\*\*\*} sistemi, datë 15.12.2017, me palë paditës A. N., i paditur “{\*\*\*}” dhe Bashkia Patos; iv. vendimi nr. {\*\*\*} sistemi, datë 18.07.2018, me palë paditës “{\*\*\*}” ShPK, i paditur S. Dh.; v. vendimi nr. {\*\*\*} sistemi, datë 27.02.2019, me palë paditës D. S., i paditur OShEE; vi. vendimit nr. {\*\*\*} sistemi, datë 07.07.2019, me palë paditës V. D., i paditur {\*\*\*} Fier.

<sup>22</sup> Neni 47 i ligjit nr. 49/2012, parashikon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkojnë prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

subjekti i rivlerësimit ka pasur gjithë kohën e nevojshme për vënien në dispozicion të këtyre akteve shkresore gjatë hetimit administrativ në Komision.

13.2. Përcaktimet e kësaj dispozite në harmoni dhe me parashikimet e nenit 49, pika 6, geramat “a” dhe “b” e ligjit nr. 84/2016, në të cilat parashikohet se: *Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: (a) marrja e provës duket se është e panevojshme; (b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjyqimit*, bëjnë që aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012, për t’u pranuar si provave të reja dhe, për më tepër, kur nga analiza e këtyre akteve në raport me faktet që subjekti synon të provojë, trupi gjykues i gjen ato të parëndësishme për zgjidhjen e çështjes. Ndërsa sa i përket veprimeve procedurale, që subjekti i rivlerësimit kërkon t’i kryejë Kolegji, trupi gjykues sjell në vëmendje se barra e provës në këtë proces i përket subjektit të rivlerësimit. Informacioni që përfitohet nga veprimet procedurale (këqyrje/marrje informacioni), në vlerësim të trupit gjykues, nuk ndikon në vendimmarrjen e tij, pasi nga aktet e administruara në dosje arrihet në një konkluzion për zgjidhjen e çështjes.

14. Subjekti sjell në vëmendje se në datën 13.09.2020, ora 22:30, ka qenë i shtruar në urgjencën e spitalit dhe nga mjeku është rekomanduar shtrimi në spital, megjithatë ai vendosi të marrë pjesë në seancë dëgjimore të nesërmen. Gjendjen shëndetësore nuk e bëri të ditur në seancë dëgjimore, pasi pretendon se nuk do të gjente mirëkuptim nga trupa gjykuese e Komisionit. Subjekti i kërkon Kolegjit të merret si provë përgjigja e Spitalit Rajonal Durrës nr. {\*\*\*} prot., datë 03.11.2020. Sa i përket kësaj shkrese, vetë fakti që subjekti nuk ia ka bërë më dije Komisionit gjendjen e tij shëndetësore dhe me vullnetin e tij ka marrë pjesë dhe ka ushtruar të drejtën për t’u dëgjuar në seancat dëgjimore në datat 14.09.2020 dhe 15.09.2020, trupi gjykues vlerëson se paraqitja e kësaj shkrese në Kolegj nuk provon ndonjë shkelje procedurale të Komisionit dhe as një të drejtë të mohuar subjektit të rivlerësimit, për të bërë të nevojshëm zhvillimin e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike.
15. Bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit depozitoi në Kolegj parashtrime me shkrim regjistruar me nr. {\*\*\*} prot., datë 10.01.2023 dhe akte shkresore<sup>23</sup>,

<sup>23</sup> i. *Relacionin mbi prodhimin e ullirit në tokën arë dhe ullishte në pronësi të Rr. H., e ndodhur në fshatin {\*\*\*}, Mallakastër, përgatitur nga eksperte arkitekte L. B., administratore e “{\*\*\*}” ShPK, licence: {\*\*\*}, licence {\*\*\*} licence {\*\*\*}; ii. vërtetimin nr. {\*\*\*} prot., datë 25.01.2021, lëshuar nga Bashkia Mallakastër, të ardhura nga shpërblime, paga 13, viti 2001, në vlerën 4.067 lekë, për Gj. H.; iii. vërtetimin nr. {\*\*\*} prot., datë 23.01.2021, lëshuar nga Bashkia Mallakastër, për të ardhurat nga shpërblime, kompensime për Rr. H.; iv. shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.03.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për të ardhurat nga shpërblimet në shumën 17.550 lekë për vitin 1999; v. shkresën nr. {\*\*\*} prot, datë 12.6.2020, e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Gjirokastrë, në të cilën përcillet dosja nr. {\*\*\*} e subjektit tatimor me NIP {\*\*\*}, për personin fizik “{\*\*\*}”, për ushtrimin e aktivitetit tregtar hotel “{\*\*\*}”, së bashku me kërkesën e H. H. e protokolluar në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Gjirokastrë nr. {\*\*\*} prot, datë 27.2.2019 dhe nr. {\*\*\*} datë 8.4.2019; vi. shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 6.10.2022, e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Gjirokastrë; vii. vërtetimin nr. {\*\*\*} prot., datë 04.01.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, që tregon se nga data 02.07.2020 është në gjykim çështja civile me objekt njohje pronar, kur si ndërhyrës kryesor janë edhe R. H. dhe M. G.. Bashkëngjitur vërtetimit gjendet të administruar: (a) kërkesëpadija e datës 30.06.2020, me paditës A. H. etj., me objekt, detyrimin e të paditurve për të njohur bashkëpronar të pasurisë me sipërfaqe 535 m<sup>2</sup> + objekt 5-katësh hotel “{\*\*\*}”, Gjirokastrë, ndodhur në lagjen “{\*\*\*}” (si trashëgimtar të H. H., F. H., H. H. dhe M. H.) dhe regjistrimin e vendimit në AshK-në, Drejtoria Vendore Gjirokastrë; (b) kërkesë me objekt, “Ndryshimi i objektit të padisë datë”, datë 23.2.2020; (c) ndërhyrje kryesore, datë 02.09.2020, e R. H., M. G. etj.; (ç) prapësime të të paditurve I. T. dhe E. H., datë 01.04.2021 dhe 02.04.2021; (d) prokurë e posaçme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.11.2015, lëshuar nga A. H. etj., të cilat emërojnë përfaqësuese znj. E. S. dhe z. L. Gj.; (dh) lëshim i dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësen {\*\*\*}, vendimi nr. {\*\*\*}, datë 20.10.2006; (e) dëshmi e trashëgimisë, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.10.1992, e trashëgimlënësit E. K. H.; (ë) vendim për lëshim të dëshmisë së trashëgimisë ligjore, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 05.04.2019, e trashëgimlënëses L. H.; (f) lëshim i dëshmisë së trashëgimisë e*

me kërkesën për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, në bazë të nenit 51/1, pikat “a” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012, për marrjen e provave të reja dhe riçeljen e pjeshme të hetimit gjyqësor. Trupi gjykues vlerëson se dispozita e përmendur nga subjekti i rivlerësimit, neni 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, nuk legjitimon subjektin, në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes, në paraqitjen e provave të reja. Në vështrim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit nuk provon se, jo për fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto akte në Komision. Gjithashtu, në fokusin e përcaktimeve të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, këto akte shkresore konsiderohen të panevojshme, pasi fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit.

16. Për sa sipër arsyetuar, në analizë të pretendimeve të subjektit, Kolegji e gjeti të pambështetur në fakte e në parashikimet e nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 kërkesën për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike e për marrjen e provave të reja. Në rastin objekt shqyrtimi nuk ndodhemi përpara situatës së parashikuar nga neni F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, që do të legjitimonin Kolegjin të kërkonte mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjonte ndonjë gabim procedural të kryer nga ana e Komisioni. Në konkluzion të këtij arsyetimi, trupi gjykues vendosi të shqyrtojë çështjen në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

---

*trashëgimlënësit N. Gj. (H.), me vendimin gjyqësor nr. {\*\*\*}, datë 13.02.2004; (g) vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 09.11.2015, e trashëgimlënësit D. H.; (g) lëshim i dëshmisë së trashëgimisë ligjore e trashëgimlënësit F. H. me vendim gjyqësor nr. {\*\*\*}, datë 24.07.2008; (gj) vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore e trashëgimlënësit T. H., nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.11.2016; (h) vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore i trashëgimlënësit H.H. nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 07.10.2019; (i) lëshim i dëshmisë së trashëgimisë për e trashëgimlënësit H. H. dhe F. H., me vendim gjyqësor nr. {\*\*\*}, datë 21.12.1998; (j) vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. {\*\*\*}, datë 15.05.2018, lëshuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Gjirokastër; (k) procesverbale të seancave gjyqësore, duke filluar nga data 29.10.2020 deri në datën 11.10.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër; viii. aktmarrëveshje, kontratë qiraje e kullotave, datë 15.2.2002; xix. prokurë e posaçme, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.3.1998; xx. kontratë qiraje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 07.12.1999, e dyqaneve me nr. {\*\*\*} dhe {\*\*\*}; xxi. kontratë qiraje, datë 16.12.2000, e dyqaneve me nr. {\*\*\*} dhe {\*\*\*}; xxii. kontratë qiraje për 11 muaj që përfshin periudhën 01.02.1994-31.12.1994 e dyqanit me nr. {\*\*\*}; xxiii. kontratë qiraje, datë 09.01.1994, e depos poshtë hotelit; xxiv. kontratë qiraje e dyqanit nr. {\*\*\*} datë 13.03.1998; xxv. kontratë qiraje e dyqanit nr. {\*\*\*}, datë 13.02.1998; xxvi. procesverbal datë 15.01.1999, i panëshkruar; xxvii. vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 04.01.2023, i noterit G. K., se në arkivën e kësaj zyre nuk ndodhen akte noteriale “kontrata qiraje” para vitit 2004, për faktin se janë asgjësuar në përputhje me ligjin “Për arkivën”; xxviii. vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 18.07.2022, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, për regjistrimin e çështjes administrative me paditës Tritan Hamitaj dhe të paditur, Kuvendi, Avokati i Popullit, gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe Komisionerët Genta Tafa, Suela Zhegu dhe Lulzim Hamitaj, bashkangjitur: (a) kërkesëpadia; (b) prapësimet e Kuvendit, nr. {\*\*\*} prot., datë 21.6.2022 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 21.6.2022; (c) prapësimet e Avokatit të Popullit nr. {\*\*\*} prot., datë 21.6.2022; (ç) prapësimet e Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Tiranë; (d) prapësimet e Komisionerëve të Komisionit Genta Tafa, Lulzim Hamitaj dhe Suela Zhegu; (dh) procesverbal i kryerjes së veprimeve përgatitore, në dhomë këshillimi, datë 21.10.2022; (e) vendim nr. {\*\*\*}, datë 21.10.2022, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për mospranimin e kërkesëpadisë; xxix. raporte për paaftësi të përkohshme në punë i Institutit Shëndetësor datë 5.11.2020 dhe 10.11.2020; xxx. vërtetim i Bashkisë Durrës nr. {\*\*\*} prot., datë 21.9.2022; xxxi. vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 20.10.2022, i Institutit të Sigurimeve Shoqërore; xxxii. komunikime elektronike (e-mail) mes subjektit të rivlerësimit dhe Qendrës së Botimeve Zyrtare, Këshilli i Ministrave, Ministria e Punëve të Jashtme, Komisionerit për të Drejtën e Informimit; xxxiii. kërkesë, datë 04.09.2022, drejtuar ILDKPKI-së; xxxiiii. kërkesë drejtuar Komisionit nr. {\*\*\*} prot., datë 03.11.2022, shoqëruar me përgjigjen nr. {\*\*\*} prot., datë 17.11.2022; xxxiv. pasqyrë e analizës financiare; xxxv. pamje fotografuar nga Google, <https://geoport.al>.*

## B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë

*Për pasurinë, tokë arë ndodhur në fshatin {\*\*\*}, Mallakastër*

17. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklarimit të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, pasi: (i) nuk provoi me dokumentacion provues të ardhurat e përfituara nga toka bujqësore në shumën 2.140.000 lekë; (ii) nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, por edhe gjatë hetimit administrativ vlerën e saktë të shpenzimeve/investimit të kryer për mbjelljen e 150 rrënjëve ullinj dhe për transformimin e një sipërfaqeje prej 1500 m<sup>2</sup> të pasurisë së tij të paluajtshme tokë arë, në vresht; (iii) nuk ka deklaruar saktë në deklaratën *vetting* përfitimin e tokës bujqësore në pronësi të tij, si dhe nuk ka depozituar dokumentin e saktë të përfitimit të kësaj pasurie së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting* (AMTP-në lëshuar në emër të gjyshit të tij).
18. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet ankimit, ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit për deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting* të përfitimit të tokës bujqësore, të faktit se nuk ka depozituar AMTP-në lëshuar në emër të gjyshit të tij së bashku me këtë deklaratë, duke e konsideruar të pavërtetë dhe në kundërshtim me provat e administruara. Dyshimet e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka fshehur këtë AMTP, me qëllim justifikimin e pronësisë së kësaj pasurie në emër të familjarëve të tij, duke përjashtuar trashëgimtarët e tjerë të H. dhe L. H., subjekti i vlerëson të pabazuara dhe kontradiktore. Regjistrimi i bashkëpronarëve të tokës bujqësore në 1/6 pjesë takuese secili dhe jo në 1/8 është përgjegjësi e AShK-së Mallakastër dhe nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, i cili nuk ka kryer asnjë ndikim formal apo jo formal dhe as nuk ka pretenduar se ka 1/6 pjesë të kësaj pasurie. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton.

18.1. Pasuria tokë bujqësore është përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, i ndryshuar dhe është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si vijon.

18.1.1. Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie, dorëzuar më datë 17.03.2004, deklaruar *tokë bujqësore në {\*\*\*}, Mallakastër, 3 dynym, e paregjistruar, burimi: ligji nr. 7501. Të ardhura vjetore: 200.000 lekë.*

18.1.2. Në deklaratën e pasurisë *vetting* deklaruar *tokë arë në bashkëpronësi të Tritan Hamitaj, Rr. H. etj., pasuria me nr. {\*\*\*}, sip. 597 m<sup>2</sup>, nr. {\*\*\*} sip. 395 m<sup>2</sup>, nr. {\*\*\*} me sip. 1057 m<sup>2</sup>, nr. {\*\*\*} me sip. 2546 m<sup>2</sup>, nr. {\*\*\*} me sip. 5024 m<sup>2</sup>, nr. {\*\*\*} me sip. 4305 m<sup>2</sup>, nr. {\*\*\*} me sip. 2188 m<sup>2</sup>, nr. {\*\*\*} me sip. 2909 m<sup>2</sup>, nr. {\*\*\*} me sip. 4636 m<sup>2</sup>, nr. {\*\*\*} me sip. 2268 m<sup>2</sup>, nr. {\*\*\*} me sip. 189 m<sup>2</sup>, nr. {\*\*\*} me sip. 60 m<sup>2</sup>, të ndodhur në {\*\*\*} nr. {\*\*\*}, si dhe 35 rrënjë ullinj. Vlera falas nga shteti. Brenda kësaj sipërfaqe janë mbjellë edhe 150 rrënjë ullinj dhe kthyer një sipërfaqe prej 1,500 m<sup>2</sup> vresht. Kjo ka ndodhur në vazhdimësi të viteve. Tritan Hamitaj ka 1/8 e kësaj prone (3 dynym për frymë). Burimi: ligji nr. 7501 “Për tokën”.*

18.2. Referuar akteve në dosjen gjyqësore për këtë pasuri, rezulton të jenë depozituar disa AMTP, të cilat përmbajnë të dhëna të ndryshme sa i përket identitetit të kryefamiljarit dhe, në një rast, sipërfaqes së përfituar, konkretisht:

- AMTP-ja nr. {\*\*\*}, datë 06.04.1994, në emër të H. Q. H., depozituar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në vitin 2015, për sipërfaqen 25760 m<sup>2</sup>;
- AMTP-ja nr. {\*\*\*}, datë 25.07.2005, në emër të Rr. H. H., depozituar nga subjekti me deklaratën e pasurisë *vetting*, për sipërfaqen 25760 m<sup>2</sup>;
- AMTP-ja nr. {\*\*\*}, vënë në dispozicion nga Bashkia Mallakastër, datë 06.04.1996, në emër të Rr. H. H., për sipërfaqen 25760 m<sup>2</sup>;
- AMTP-ja dërguar me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 10.03.2020, e AShK-së Mallakastër, ka

datë 20.06.2008, për sipërfaqen 27760 m<sup>2</sup>, me kryefamiljar Rr. H. H.. Nëpërmjet kësaj shkresë të AShK-së Mallakastër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar toka bujqësore të përfituar nga ligji nr. 7501/1991, në bashkëpronësi 1/6 pjesë takuese për pasuritë e ndodhura në zonën kadastrale 1945.

**18.3.** Nga analizimi i AMTP-ve, rezulton se personat që kanë përfaqësuar Komisionin e Tokës kanë qenë të ndryshëm. Komisioni i kërkon informacion Këshillit të Qarkut Fier dhe Bashkisë Mallakastër, për të konfirmuar cili prej AMTP-ve është lëshuar nga Komisioni i Tokës, si dhe akte në lidhje me këtë çështje duke përcaktuar se cili nga dy shtetasit H. Q. H. apo Rr. H. H. ka qenë përfitues i tokës bujqësore. Nga informacioni i përcjellë nga institucionet shtetërore, lidhur me këtë pasuri, rezulton:

**18.3.1.** Bashkia Mallakastër, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 19.03.2020, informon Komisionin se detyrimin ligjor për vlerësimin e AMTP-ve e ka Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë ngritur pranë Prefekturës Fier. Këto AMTP nuk janë lëshuar nga Bashkia dhe pranë saj nuk administrohen AMTP në origjinal, po i dorëzohen Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës [DAMT], Qarku Fier, që më pas e depoziton në ZVRPP, sot AShK Mallakastër. Më tej, në këtë shkresë, sqarohet se dy personat (babë e bir) kanë qenë subjekte të ligjit nr. 7501/1991, pavarësisht se AMTP-ja nënshkruhet nga kryefamiljari të gjithë personat e certifikatës familjare, datë 01.08.1991, kanë pjesë të barabartë toke në të. Nisur nga certifikata familjare, datë 01.08.1991, rezulton se familja e H. Q. H. përbëhet prej tij dhe bashkëshortes (2 frymë) dhe familja e Rr. H. H. (6 frymë). Komisioni i Tokës së fshatit {\*\*\*} ka bërë bashkimin e dy familjeve në një AMTP të vetme me 8 (tetë) frymë. Kështu që përveç emrit nuk ndryshon asgjë në dy AMTP-të, sipas shkresës së bashkisë.

**18.3.2.** Këshilli i Qarkut Fier, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 22.05.2020, informon se pranë këtij institucioni ndodhet formulari nr. {\*\*\*} dhe lista e gjendjes civile, të cilat janë të panënshkruara nga Komisioni i Tokës së fshatit {\*\*\*}. Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë këtij qarku informon se nuk ka asnjë kompetencë të konfirmojë vlefshmërinë e AMTP-së.

**18.4.** Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 25.02.2020, ILDKPKI-ja përcjell procesverbalet e mbajtura nga inspektorët e këtij institucioni në datat 15.09.2005 dhe 22.04.2015, si dhe aktet në mbështetje të përgjigjeve të dhëna. Në procesverbalin e vitit 2015, subjekti shprehet se toka e përfituar me ligjin nr. 7501/1991 është regjistruar në emrin e gjyshit H. H., si kryefamiljar i tokës bujqësore. Pjesa takuese e subjektit është 3 dynym, duke vënë në dispozicion AMTP nr. {\*\*\*}, datë 06.04.1994, si dhe certifikatën e trungut familjar. Me deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit depoziton dy certifikatat familjare të cilat tregojnë përbërjen e familjes së H. H. dhe Rr. H., më 31.08.1991.

**18.5.** Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit të datës 03.04.2020, lidhur me konstatimet e Komisionit dhe faktit se cila prej AMTP-ve ishte origjinale, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, sqaron se në fshatin {\*\*\*}, Mallakastër, toka bujqësore është ndarë nga 3 dynym për frymë dhe 5 rrënjë ullinj. AMTP-ja ishte përfituar për të dy familjet së bashku për 8 (tetë) frymë dhe nga Komisioni i Tokës është përcaktuar si kryefamiljar, H. H.. Pas vdekjes së gjyshit H. H., babai i subjektit i është drejtuar Komunës {\*\*\*} për të marrë një kopje të AMTP-së. Nga komuna i është dhënë një AMTP e cilësuar “dublikatë”, por që në fakt rezulton një dokument i ri. AMTP-ja e lëshuar duhet të kishte të dhënat e dokumentit të lëshuar në datën 06.04.1994, jo vetëm në përmbajtjen e tokës, por edhe të ekstremiteteve të saj, nënshkrimet dhe vula. AMTP-ja nuk ka ndryshim në sipërfaqe dhe parcela, por është plotësuar në emër të Rr. H., pasi H. H. nuk jetonte më. Ndërsa në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, datë 31.07.2020, subjekti sqaron se ka qenë transparent, nuk ka kryer veprime për të fshehur

dokumente apo bashkëpronarë dhe Komisioni e gjykon me akte të dorëzuara nga vetë subjekti. Subjekti pretendon se nuk ka asnjë arsye të fsheh AMTP origjinale, pasi deklarimi përputhet me gjendjen e tokës bujqësore në formularin nr. {\*\*\*}, pranë Këshillit të Qarkut Fier.

18.6. Për sa sipër, trupi gjykues konstaton se në kuadër të procesit të rivlerësimit janë administruar 4 (katër) AMTP, 2 (dy) prej të cilave nga vetë subjekti i rivlerësimit, një në ILDKPKI në vitin 2015 dhe një me deklaratën e pasurisë *vetting*. Edhe pse është e provuar tashmë që AMTP-të kanë përmbajtje të ndryshme, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pjesën e tij prej 3 (tre) dynym, të përfituar si anëtar i familjes bujqësore nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar, si në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim e vitit 2003, ashtu edhe në atë *vetting*. Deklarimi është kryer referuar AMTP-ve të lëshuara nga institucionet shtetërore. Për sa i përket pjesës takuese të tij prej 1/8 në këtë pasuri, referuar dhe përgjigjes të detajuar të dhënë nga Bashkia Mallakastër, nuk rezulton që subjekti të ketë bërë përpjekje për deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se kjo pasuri nuk paraqet problematikë sa i përket deklarimit mbi përfitimin e tokës bujqësore dhe pjesës takuese, pasi ai ka depozituar si AMTP-në në emër të babait Rr. H. me deklaratën e pasurisë *vetting*, ashtu edhe atë në emër të gjyshit të tij H. H., para ILDKPKI-së, në vitin 2015.

19. *Lidhur me shpenzimet për transformimin e tokës arë në vresht dhe mbjelljen e 150 rrënjëve ullinj*, subjekti pretendon se: (i) konkluzioni i Komisionit vjen në kundërshtim me nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parimin e objektivitetit, sigurisë juridike dhe fuqisë prapavepruese të ligjit. Subjekti i rivlerësimit nuk disponon dokumentacion mbi shpenzimet e kryera e, për pasojë, nuk mund t’i deklarojë me saktësi ato. Shpenzimet janë kryer kohë përpara se subjekti të ushtronte detyrën e gjyqtarit dhe përpara se t’i lindte detyrimi për deklarimin e pasurisë, rrethana që kanë ndikuar në mos mbajtjen e dokumentacionit provues për një pjesë të tyre; (ii) në kundërshtim me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, subjektit nuk i ka munguar gatishmëria për të paraqitur dokumente e as nuk ka pasur qëllim për të vënë në vështirësi Komisionin në kryerjen e detyrës, por ndodhej në kushtet e pamundësisë objektive për t’i dokumentuar ato; (iii) Komisioni, në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, duhet të kishte kryer aktekspertimin agronomik, kërkesë që iu refuzua me arsyetimin, sipas nenit 49, pika 6, germat “a” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016. Një pjesë e shpenzimeve janë bërë nga familja, si punime me krahë, mbjellje, ujitje, krasitje, në pamundësi të dokumentohen. Edhe nëse do të ishte operuar si tregtar apo shoqëri tregtare, në bazë të nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008, detyrimi për të ruajtur dokumentacionin tatimor është maksimumi 5 (pesë) vjet, afat që ka kaluar. Në pamundësi të përcaktimit të shpenzimeve, Komisioni mund t’i referohej aktekspertimit agronomik të depozituar nga subjekti i rivlerësimit; (iv) barra e provës dhe konkluzioni i Komisionit, për të deklaruar shpenzimet e mbjelljes së vreshtit dhe ullinjve, vjen në kundërshtim me nenin A dhe nenin D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, me ligjin dhe është jo proporcional e objektiv. Kushtetuta dhe ligjet e dala në zbatim të saj e kanë ngarkuar subjektin me detyrimin për të deklaruar pasurinë dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe jo të shpenzimeve.

19.1. Nga analizimi i deklaratës së personit që mbart detyrimin për deklarim, datë 17.03.2004, rezulton se në formularin A-1 të kësaj deklarate me emërtim “Pasuri të paluajtshme dhe e drejta reale mbi to”, parashikohet si detyrim për t’u deklaruar: *Toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesat [...] ndërtime të tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën*. Referuar këtij shpjegimi, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për të deklaruar dhe investimet që janë kryer mbi këtë pasuri, të cilat konsiderohen të trupëzuara në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën, siç janë ullinj të vreshti, si dhe burimin e krijimit të tyre.



19.2. Gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigjet e pyetësorit të datës 03.04.2020, subjekti i rivlerësimit sqaron se rreth 80 rrënjë ullinj janë mbjellë në fillim të vitit 1995, pjesa tjetër në vazhdimësi, deri në vitin 2010. Subjekti sqaron se nuk disponon dokumentacion mbi shpenzimet për mbjelljen e ullinjve dhe ky pohim bazohet në kujtesën e prindërve. Sa i përket vreshtit, sqaron se është mbjellë rreth vitit 2000 dhe nuk kujton e nuk disponon dokumentacion mbi shpenzimet e kryera. Si burim për këto shpenzime, subjekti sqaron se kanë shërbyer pagat e prindërve nga viti 1991 e në vazhdim, të ardhurat nga toka bujqësore e tyre dhe e gjyshes, si dhe të ardhurat e subjektit nga emigracioni. Për pjesën tjetër të tokës, subjekti i rivlerësimit deklaron se përdoret për kultivimin e bimëve të arave që rriten në këtë zonë, si grurë, misër, fasule, perime, foragjere etj., për të cilat, gjithashtu, nuk disponon dokumentacion. Shuma e përfituar nga të ardhurat e tokës, vreshtit dhe ullinjve, sipas tij, nuk është e dokumentuar e, për to, nuk ka dokumentacion tatimor, pasi veprimtaria është ushtruar si fermer.

19.3. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit pretendon se Kushtetuta, në nenin D, pika 3 të Aneksit, e ka ngarkuar me detyrimin të deklarojë pasurinë dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave, por jo të shpenzimeve. Evidentimi i tyre kryhet nga Komisioni nëpërmjet hetimit administrativ, po jo t'i ngarkohet subjektit me barrë prove, pasi barra e provës për të deklaruar shpenzimet e mbjelljes së vreshtit dhe ullinjve, vjen në kundërshtim me nenin D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjeve në zbatim të këtij neni. Për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe mosruajtjes në memorie të vlerës së shpenzimeve, e vënë subjektin e rivlerësimit në pamundësi për dhënien e përgjigjes lidhur me këto shpenzime, të cilat, sipas tij, mund të llogariten vetëm me kryerjen e një aktekspertimi agronomik. Veprimtaria e shfrytëzimit të tokës bujqësore, ullinjve dhe vreshtit është drejtuar nga babai dhe nuk ka pasur asnjëherë natyrë si veprimtari ekonomike për të nxjerrë fitim. Prindërit kanë qenë të punësuar në shtet e, më pas, me daljen në pension pleqërie nuk kanë pasur detyrim të vetësigurohen si fermer dhe kanë vazhduar të nxjerrin të ardhura duke shfrytëzuar tokën, mosshfrytëzimi i të cilës sjell penalitet humbjen e së drejtës së posedimit në bazë të ligjit nr. 10263, datë 08.04.2010 “Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara”.

19.4. Në mbështetje të argumenteve të tij, me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit paraqet dhe *“Vlerësim i të ardhurave nga pasuritë tokë arë dhe ulla në pronësi të z. Rr. H., me vendndodhje në fshatin {\*\*\*}, Bashkia Mallakastër, Rrethi Mallakastër, Qarku Fier”*, prill 2020, të përgatitur nga eksperte agronome R. M.<sup>24</sup>, pasi është kontaktuar nga babai i subjektit, shtetasi Rr. H.. Ekspertja, sipas subjektit, ka kryer shumë aktekspertime të ngjashme për gjykime me palë të ndryshme për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Për këtë aktekspertimi, Komisioni në vendim është shprehur se *të dhënat e prezantuara në këtë akt nuk provojnë vlerën e shpenzimeve të kryera, në funksion të detyrimit që ka subjekti i rivlerësimit në këtë proces, për të provuar me dokumentacion vlerën e krijimit të pasurisë së tij*.

19.5. Trupi gjykues, nga analizimi i aktekspertimit, konstaton se detyrat e ekspertës kanë qenë: (i) inspektimi në terren dhe vlerësimi i të ardhurave vjetore nga pasuritë tokë arë dhe ulla për periudhën 1993-2019, pas zbritjes së shpenzimeve të vreshtit në kohën e krijimit, mbjelljes së ullinjve dhe llogaritjen e të ardhurave të mundshme që mund të përfitohen nga shfrytëzimi i këtyre pasurive. Në këtë aktekspertim, përcaktohet se pasuritë nr. {\*\*\*} dhe {\*\*\*} janë mbjellë me ulla dhe vreshta. Në këtë sipërfaqe, ekspertja konstaton 165 rrënjë ullinj [115 të grupmohës 25-30 vjeçare, 20 të grupmohës 20-25 vjeçare, 20 të moshës 15-20 vjeçare dhe

<sup>24</sup> “{\*\*\*}”, me NIPT {\*\*\*}. Certifikuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës “Për vlerësimin e pasurive të paluajtshme për tokën bujqësore, tokë pyjore, kullotë dhe të pafrytshme”. Certifikatë nr. {\*\*\*}. Certifikuar nga Ministria e Mjedisit për “Hartimin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për problemet mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi mjedisor”. Certifikatë {\*\*\*}.

10 të moshës 0-5 vjeçare (janë të mbjellë midis rreshtave të vreshtit)]. Brenda kufijve të këtyre pasurive, ekspertja konstaton 1000 m<sup>2</sup> vresht dhe 135 rrënjë ullinj të cilat në aktvlerësim konsiderohen 25-vjeçare. Ekspertja i bën përlllogaritjet në bazë të sipërfaqes të tokës, jo sipas rrënjëve të ullirit apo llojit të vreshtit. Ashtu siç citohet në vlerësimin e saj, *për përlllogaritjet në këtë akt ka përdorur të dhëna mesatare, sipas tipologjisë së zonës, tokës, distancës, prodhimit mesatar, sipas regjimit agroteknik të kultivimit të tokës. Janë përdorur çmime dhe rendimente mesatare dhe nën mesataren. Shpenzimet janë përlllogaritur, sikur shërbimet do të bëheshin me ditë pune, në fakt punimet janë bërë nga vetë anëtarët e familjes bujqësore. [...] të gjitha pasuritë e marra në studim në këtë akt janë të mirëmbajtura dhe me rentabilitet të lartë. Pothuajse të gjithë pasuritë të karakterit bujqësor të zonës janë të mirëmbajtura dhe me rentabilitet të lartë, në këtë zonë tregu i shitblerjes së pasurive bujqësore është minimal.*

Ky ekspertim në rastin konkret ka të pasqyruar pjesën konstatuese nga dokumentet e pronësisë, AMTP-së, certifikatat e pronësisë në emër të Rr. H., si dhe fotot e bëra gjatë inspektimit në vend, ndërsa sa i përket analizës profesionale konstatohet se është i pabazuar në të dhëna konkrete apo që derivojnë nga burime zyrtare, nga studim i mirëfilltë shkencor që të bindin këtë Kolegj për sa pretenduar. Gjithashtu, nuk ka asnjë dokument provues mbi shpenzimet e kryera apo të ardhurat e përfituara nga toka bujqësore, arë, ullishte apo vresht. Në këto kushte, në linjë me Komisionin, trupi gjykues vlerëson se të dhënat në këtë akt nuk provojnë vlerën e shpenzimeve të kryera, në funksion të detyrimit që ka pasur subjekti i rivlerësimit në këtë proces, për të provuar me dokumentacion vlerën e krijimit të pasurisë së tij.

**19.6.** Pretendimin e subjektit të rivlerësimit se duhet të deklarojë saktë pasuritë dhe të ardhurat por jo shpenzimet, trupi gjykues e vlerëson të gabuar, pasi ullinj të vreshti janë të trupëzuara në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën, janë investime në pasuri dhe, në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për deklarimin e burimit të tyre, si në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim të vitit 2003, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ashtu edhe gjatë hetimit administrativ. Pavarësisht se në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, neni 31, pika 1, shtojca 2, subjekti nuk ka pasur detyrimin për të deklaruar shpenzimet, por ka pasur detyrim të deklarojë shpenzimet/investimet e kryera që kanë rritur vlerën e pasurisë, të tilla si mbjellja e ullinjve dhe vreshti. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit, në kuadër të këtij procesi, duhet të deklaronte burimin e ligjshëm të investimeve të kryera. Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi lidhur me vlerën e shpenzimeve/investimit të kryer për mbjelljen e 150 rrënjëve ullinj dhe të një sipërfaqeje prej 1500 m<sup>2</sup> vresht, jo në përputhje me nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

20. *Lidhur me të ardhurat nga toka bujqësore*, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka qenë i saktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, në lidhje me deklarimin e burimit të shumës 2.140.000 lekë, si shumë e përfutur nga toka bujqësore, pasi, siç deklaroi edhe subjekti, shfrytëzimi i tokës bujqësore nuk ka pasur asnjëherë natyrë si veprimtari ekonomike për të nxjerrë fitim. Nga subjekti nuk është provuar që toka bujqësore të ketë prodhuar produkte, që më pas të jenë shitur, duke krijuar të ardhura monetare, për t’u përdorur si burim për pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme, për rrjedhojë këto të ardhura nuk do të përfshihen në analizën financiare. Komisioni vlerëson se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, kontradiktor, të paplotë dhe të pamjaftueshëm, në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “a”, të nenit 33, pika 5 të ligjit nr. 84/2016.

21. Subjekti i rivlerësimit, në ankim: (i) ka konsideruar konkluzionin e Komisionit, si të gabuar e në kundërshtim me ligjin, parimin e proporcionalitetit, objektivitetit, pa arsyetuar provat dhe shpjegimet e subjektit. Arsyetimi i Komisionit se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe kanë karakter deklarativ të pashoqëruar me dokumentacion provues është i paplotë, pasi duhej

arsyetuar se cilat janë dokumentet ligjore që krijohen nga veprimtaria e fermerit me të cilat dokumentohet shitja e produkteve bujqësore, sasia, mënyra e shitjes, si dhe shuma e përfituar. Veprimtaria e fermerit nuk është e rregulluar me asnjë akt ligjor ose nënligjor, lidhur me ruajtjen e dokumentacionit të kësaj veprimtarie, punuar çdo vit, shpenzimet për punimin e mbjelljen, deri në shitjen e produktit, nëse fermeri shet; (ii) Komisioni duhet të kishte vlerësuar pamundësinë objektive të subjektit për të disponuar dokument mbi të ardhurat nga toka bujqësore dhe në përputhje me nenin 49 të ligjit nr. 84/2016, duhet të kryente aktekspertimin e jo të refuzonte kërkesën e subjektit. Familja e subjektit nuk ka ushtruar veprimtari tregtare që të detyrohej të ruante dokumentacion; (iii) Komisioni nuk mori në konsideratë deklaratat periodike 2005-2016, në të cilat pasqyrohet e ardhura nga toka bujqësore, dokumente me vlerë provuese, sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në harmoni me të gjitha provat e tjera të administruara. Këto të ardhura mund të ishin vlerësuar për të përballuar shpenzimet e jetesës, pasi do të ishte absurditet të vlerësohen zero; (iv) dokumente indirekte që tregojnë se toka është punuar, janë pagesat e taksës së tokës çdo vit. Nëse toka do të ishte lënë *djerrë*, nuk kishte arsye të paguhej taksa e tokës dhe nga Bashkia do të ishin marrë masa për dhënien me qira të saj. Fakt tjetër provues është që prindërit e subjektit kanë jetuar në fshat, vërtetuar me përgjigjen e ISSh-së se kanë punuar në fshatin {\*\*\*} deri me daljen në pension dhe me certifikatën e gjendjes civile. Të dhëna të mjaftueshme këto për të qenë objektiv dhe të bindur se toka bujqësore ka krijuar të ardhura; (v) ullahtë dhe vreshti gjenerojnë të ardhura, fotot e tyre të marra si provë nga Komisioni tregojnë ekzistencën e tyre dhe aktekspertimi agronomik pasqyron gjendjen, sipërfaqen, moshën. Nëse Komisioni nuk bindej, mund të këqyrte në vend ekzistencën e tyre, e cila është e pamohueshme; (vi) është keqinterpretuar qëndrimi i subjektit se kjo veprimtari, drejtuar nga babai *nuk ka pasur asnjëherë natyrë si veprimtari ekonomike për të nxjerrë fitim*, ndërkohë që është thënë me qëllim për të diferencuar statusin e fermerit nga ai i tregtarit për efekt të procedurave tatimore në lidhje me mbajtjen e dokumentacionit; (vii) aktekspertimi agronomik duhet të ishte marrë si provë dhe, prej Komisionit, të arrihej në konkluzion në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat nga toka bujqësore, ullahtë dhe vreshti. Të ardhura të tilla janë një praktikë gjyqësore në gjykatat në vend për të llogaritur dëmin e shkaktuar nga prishja e tokës bujqësore shkaktuar nga ndotja e naftës në zonën e qarkut të Fierit. Praktika gjyqësore tashmë është kthyer në pritshmëri normale për të ardhmen për çdo fermer, për të nxjerrë vlerën e dëmshpërblimit nëse toka i dëmtohet dhe të arrihet përfundimi sesa janë të ardhurat që mund të nxirren prej saj po të punohej nga fermeri; (viii) ekspertja R. M. ka kryer shumë akte për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe nga informacioni rezulton se ajo ka bërë ekspertime të ngjashme në disa gjykime<sup>25</sup>, për të cilat i ka kërkuar Komisionit të marrë si provë disa prej vendimeve gjyqësore<sup>26</sup>; (ix) të ardhurat nga toka bujqësore, ullahtë dhe vreshti nga viti 1991 e në vazhdim, Komisioni duhet t'i përfshinte sipas aktekspertimit agronomik dhe për vitet që të ardhurat janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore të llogariten sipas deklarimit, në të kundërt, Komisioni nuk duhet të kishte llogaritur shpenzimet e jetesës së subjektit dhe të prindërve të tij nga viti 1991 e në vazhdim ose t'i kishte llogaritur ato sipas praktikës<sup>27</sup> së tij. Nga analizimi i këtyre pretendimeve, trupi gjykues konstaton si vijon.

**21.1.** Në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratat e interesave privatë periodikë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat nga toka bujqësore si vijon.

<sup>25</sup> Në proceset gjyqësore me: (i) paditës A. Sh., i paditur Bashkia Patos; (ii) paditës A. K., i paditur Q. K.; (iii) paditës V. D., i paditur Bordi {\*\*\*} Fier, janar 2017; (iv) paditës V. N., i paditur "{\*\*\*}" ShA, janar 2019; (v) paditës M. A., Xh. Ç. dhe A. A., i paditur B. K. dhe S. K.; (vi) i paditës A. N., i paditur Komuna {\*\*\*}, Fier, shoqëria "{\*\*\*}", "{\*\*\*}" ShPK, etj.

<sup>26</sup> Vendimet nr. {\*\*\*}, datë 07.12.2016, nr. {\*\*\*}, datë 09.07.2012, nr. {\*\*\*}, datë 15.12.2017, nr. {\*\*\*}, datë 18.07.2018, nr. {\*\*\*} datë 27.02.2019 dhe nr. {\*\*\*}, datë 07.07.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>27</sup> Shih vendimet nr. 234, datë 20.02.2020, nr. 191, datë 26.07.2019 dhe nr. 241, datë 26.02.2020, të Komisionit.

21.1.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit në rubrikën e të ardhurave, deklaroi: *Të ardhura nga toka bujqësore (\*\*\*} Mallakastër), për Tritan Hamitaj. Për vitet 2005 e më herët nuk i di saktë të ardhurat nga toka. Nga viti 2005 e deri në vitin 2015 janë 1.990.000 lekë. Për vitin 2016 janë 150.000 lekë. Në total 2.140.000 lekë.*

21.1.2. Në deklaratat e interesave privatë periodikë (në vijim “DIPPV”) të depozituara në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit deklaroi:

- në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim më 17.03.2003: *Toka bujqësore në {\*\*\*}, Mallakastër, 3 dynym, të ardhurat vjetore 200.000 lekë;*
- në DIPPV/2006: *të ardhura nga shfrytëzimi i tokës bujqësore të ndodhur në {\*\*\*}, Mallakastër, për Tritan Hamitaj, 250.000 lekë;*
- në DIPPV/2007: *të ardhura nga toka bujqësore, 300.000 lekë;*
- në DIPPV/2008: *të ardhura nga toka bujqësore për Tritan Hamitaj, 150.000 lekë;*
- në DIPPV/2009: *të ardhura nga toka bujqësore për Tritan Hamitaj, 250.000 lekë;*
- në DIPPV/2010: *të ardhura nga toka bujqësore për Tritan Hamitaj, 200.000 lekë;*
- në DIPPV/2011: *të ardhura nga toka bujqësore për Tritan Hamitaj, 200.000 lekë;*
- në DIPPV/2012: *të ardhura nga toka bujqësore për Tritan Hamitaj, 150.000 lekë;*
- në DIPPV/2013: *të ardhura nga toka bujqësore për Tritan Hamitaj, 200.000 lekë;*
- në DIPPV/2014: *të ardhura nga toka bujqësore për Tritan Hamitaj, 150.000 lekë;*
- në DIPPV/2015: *të ardhura nga toka bujqësore për Tritan Hamitaj, 140.000 lekë;*
- në DIPPV/2016: *të ardhura nga toka bujqësore për Tritan Hamitaj, 150.000 lekë.*

21.2. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti sqaron se babai dhe nëna e tij kanë qenë të punësuar në Komunën {\*\*\*} dhe, për rrjedhojë, kanë qenë të siguruar në punë tjetër dhe nuk mund të vetësiguroheshin, pasi i ndalonte vendimi nr. 1114, datë 30.07.2008, i Këshillit të Ministrave “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”, pika 1, germa “dh”, që parashikon: “Të vetëpunësuarit në bujqësi, të aftë për punë, që kanë mbushur moshën 16 vjeç, deri në moshën për pension, sipas nenit 92 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 [...] kur: (i) nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, banojnë në të njëjtin nënqark, ku kanë tokën, në pronësi ose në përdorim, dhe zhvillojnë veprimtari bujqësore e blegtorale, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, për barrë lindje, për pensione dhe për sigurim shëndetësor; (ii) nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, banojnë në fshat dhe zhvillojnë veprimtari, bujqësore e blegtorale, edhe nëse kanë tokë, në pronësi ose në përdorim, me vendndodhje në nënqarkun fqinj, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, për barrë lindje, për pensione dhe për sigurim shëndetësor”, si dhe aktet e tjera nënligjore. Subjekti sqaron se të ardhurat e nxjerra nga toka bujqësore nuk janë të sakta, pasi ashtu është vetë natyra e nxjerrjes së tyre, një pjesë e prodhimit përdoret për nevoja të familjes, pjesa tjetër mund të shkëmbehet apo shitet te subjekte që nuk janë të regjistruar.

21.3. Në disa shpjegime me shkrim të përcjella Komisionit, pas dërgimit të prapësimeve mbi rezultatet e hetimit, subjekti sqaron se nga produktet bujqësore, perimet dhe frutat e mbjella rreth shtëpisë, vreshti dhe ullinj të ka përfituar drejtpërdrejtë të ardhura nëpërmjet prindërve, ku ka marrë grurin, me të cilin ka bërë bukën vetë për gjithë vitin, një produkt *bio* dhe pa rrezatim, vajin e ullirit, ullinj, fasule, perime, fruta, verë dhe raki. Produkte këto që zënë një peshë të madhe në shpenzimet e jetesës të llogaritura edhe nga INSTAT dhe i ulin ndjeshëm ato.

21.4. Subjekti, në kërkesën drejtuar Komisionit, më datë 27.07.2022, shprehet se *jam në pamundësi të deklarimit të saktë se sa janë të ardhurat nga toka bujqësore dhe, për këtë shkak, i jam drejtuar një eksperti agronom, i cili po përgatit aktin. Akti do të ketë një përfundim teorik duke u bazuar në sipërfaqen e tokës, vendin e ndodhjes, kulturat e mbjella. Të ardhura të tilla të nxjerra në këtë mënyrë janë një praktikë gjyqësore në gjykatat për të përlllogaritur dëmin e shkaktuar nga prishja e tokës bujqësore shkaktuar nga ndotja e naftës në zonë e qarkut të Fierit[...].* Subjekti pretendon se veprimtaria e shfrytëzimit të tokës bujqësore, ullinjve dhe vreshtit është drejtuar nga i ati Rr. H. dhe nuk ka pasur asnjëherë natyrë si veprimtari ekonomike për të nxjerrë fitim. Në vijim, subjekti pretendon se prindërit nuk kanë qenë të siguruar si fermer, pasi kanë qenë në punë shtetërore e, më pas, në pension. Mosshfrytëzimi i tokës, sipas subjektit, sjell si penalitet humbjen e së drejtës së posedimit në bazë të ligjit nr. 10263, datë 08.04.2010 “Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara”.

21.5. Siç është përmendur më sipër në këtë vendim, vlerësimi i ekspertes agronome R. M., nuk mund të merret në konsideratë për efekt të këtij procesi, pasi të dhënat dhe rezultatet e vlerësimit të saj nuk janë mbështetur në asnjë dokument ligjor përveç aktit të pronësisë së tokës bujqësore, të dhënat në të janë hipotetike dhe të ardhurat nuk mbështeten në asnjë dokumentacion justifikues që provon gjenerim të ardhurash nga bujqësia, toka arë, ullinjte apo vreshti. Nga ana tjetër, vërtet subjekti ka sjellë në vëmendje praktikën gjyqësore në përcaktimin e dëmshpërblimit mbi bazë të aktekspertimit agronomik, por procesi i rivlerësimit është i një natyre krejt tjetër, duke pasur një shtrirje të gjatë në kohë, që kërkon që akti të jetë i bazuar në dokumente që provojnë ekzistencën e kësaj të ardhure.

21.6. Me parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit depoziton dokumentin “*Relacion mbi prodhimin e ullirit në tokën arë dhe ullishte në pronësi të Rr. H., e ndodhur në fshatin {\*\*\*}, Mallakastër*” përgatitur nga ekspertja L. B., për të provuar të ardhurat e përfituara nga prodhimi i ullishteve të familjes H.. Trupi gjykues, edhe pse nuk e administroi në cilësinë e provës këtë raport vlerësimi, pasi kur nuk kënaqte kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, në kushtet kur subjekti në parashtrime referon jurisprudencën e Kolegjit, konkretisht vendimin nr. 20, datë 14.06.2022, paragrafi 13.8, duke iu drejtuar të njëjtës eksperte, gjen me vend të theksojë se këto çështje nuk janë të ngjashme mes tyre. Në ndryshim nga rasti objekt shqyrtimi, në çështjen që i përket vendimit nr. 20/2022 të Kolegjit, përveç raportit të vlerësimit të ekspertes u depozituan edhe dokumente të tjera të kohës, si fletëhyrje dhe mandatpagesa, përfshirë dhe deklaratat noteriale të subjekteve tregtare që ushtronin veprimtarinë e mbledhjes dhe përpunimit të ullirit, të regjistruar në organet respektive, të cilët përcaktonin sasi të grumbulluara nga babai i subjektit dhe çmimin e vajit ndër vite, të cilat, pasi u vlerësuan në harmoni me të dhënat e raportit të ekspertimit, të krijonin bindjen se shfrytëzimi i ullishteve prodhonte të ardhura në vazhdimësi. Në rastin objekt shqyrtimi, depozitimi vetëm i raportit të vlerësimit të eksperte L. B., i pashoqëruar me asnjë dokument të kohës, që të çon në fakte apo rrethana konkrete të përfitimit nga shfrytëzimi i ullishteve, është i pamjaftueshëm për t’u marrë në konsideratë nga trupi gjykues. Për më tepër, në rastin e trajtuar në vendimin nr. 20/2022, të Kolegjit, subjekti i rivlerësimit rezultonte të ishte anëtare e familjes bujqësore, kur pretendoi përfitimin e këtyre të ardhurave, ndërsa në rastin konkret subjekti i rivlerësimit është shkëputur nga familja bujqësore, sipas certifikatës familjare që në vitin 2002, e ndërkohë që deklaroi të ardhura nga toka bujqësore ndër vite ka pasur detyrimin t’i provojë ato me dokumentacion provues në kohën e përfitimit të tyre.

21.7. Në kuptim të nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Sa i përket të ardhurave nga toka bujqësore, rezulton se subjekti ka deklaruar këtë të ardhur në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratat e interesave privatë periodikë 2003 dhe 2006-2016, në kushtet kur për këtë të ardhur mungon parashikimi i detyrimit tatimor, sipas

ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe legjislacioni parashikon si detyrim të vetëm taksën vendore<sup>28</sup> të parashikuara nga neni 9, pika 2 e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, duket sikur të ardhurat nga toka bujqësore plotësojnë parashikimet e nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës. Megjithatë, nga subjekti i rivlerësimit nuk është depozituar asnjë akt i vetëm i kohës që të provojë përfitimin e kësaj të ardhure dhe vlerën e saj, asnjë dokument për shitjen apo përpunimin e tyre e, në këto kushte, të ardhurat e pretenduara nga toka bujqësore nuk janë përfshirë në analizën financiare të kryer në Kolegj. Megjithatë, trupi gjykues konstatoi se edhe nëse në analizën financiare të periudhës 2003-2016 do të përfshiheshin këto të ardhura, si deklaruar në deklaratat e interesave privatë periodikë, përsëri subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, të cilat nuk shërojnë pamjaftueshmërinë financiare, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

*Për pasurinë, apartamenti me sipërfaqe 86,18 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Durrës*

22. Për këtë pasuri, Komisioni vlerësoi se: (i) subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e apartamentit, krijimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve në shumën 2.273.231 lekë; (ii) subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 2.977.421 lekë për krijimin e depozitave në vitet 2000-2001, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit; (iii) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* në mënyrë të plotë dhe të saktë burimet në lidhje me këtë pasuri. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.
23. Për të kundërshtuar konkluzionet e Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka ngritur këto shkaqe ankimore: (i) mospërfshirja e të ardhurave të prindërve si burim është në kundërshtim me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe parimin e sigurisë juridike. Në të ardhura të tjera familjare të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, përfshihen dhe të ardhurat e prindërve. Pasaktësia e mosdeklarimit të të ardhurave të tyre në deklaratën e pasurisë *vetting* është rregulluar gjatë hetimit administrativ, në përputhje me paragrafin e tretë, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës; (ii) burimet në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim të vitit 2003 nuk janë shteruese, pasi në të mungojnë të ardhurat e pakontestueshme, si ato nga punësimi i subjektit të rivlerësimit të provuara me dokumentacion justifikues ligjor, depozitat në “ProCredit Bank” ShA, si dhe të ardhurat nga toka bujqësore; (iii) fakti që nga muaji maj 1998 nuk ka jetuar me prindërit, nuk bie në kundërshtim me deklarinimet e qëndrimet e subjektit dhe nuk sjell ndryshim për të vlerësuar prindërit si persona të lidhur para datës 06.05.2002. Largimi nga vendbanimi, për arsye pune apo studimi, nuk ndryshon ekzistencën e të qenit një familje, në një ekonomi të përbashkët me prindërit, traditë kjo e vendit tonë; (iv) depozitat në “ProCredit Bank” ShA kanë qenë nga të ardhurat e të gjithë familjes dhe me tërheqjen e shumave monetare ka filluar ndarja nga ekonomia e përbashkët, *de facto*, në janar dhe ka përfunduar në maj të vitit 2002. Shumat e depozituara në “ProCredit Bank”, përbëjnë gati dyfishin e çmimit të blerjes së apartamentit; (v) në përlllogaritje duhet të përfshihen shpërblimet e fundvitit të subjektit të rivlerësimit deri në vitin 2004, të cilat kanë qenë të konsiderueshme madje deri në masën e një page, të cilat nuk evidentohen, pasi paga deri në vitin 2005 jepej *cash* dhe nuk janë përfshirë në analizën e Komisionit, si dhe shpërblimet nga marrëdhëniet e punës së prindërve deri më 06.05.2002; (vi) mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting* i shumës së të ardhurave nga firmat piramidale dhe trashëgimisë nuk sjell përjashtimin e tyre. Të ardhurat nga firmat piramidale dhe trashëgimia janë deklaruar në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim të vitit 2003. Për këto të ardhura, subjekti, jo për faj të tij, nuk

<sup>28</sup> Referuar shkresës nr. {\*\*\*} regi., datë 13.07.2020, të Bashkisë Mallakastër, rezulton se Rr. H. ka paguar taksën e tokës bujqësore dhe nuk ka asnjë detyrim pranë këtij institucioni.

disponon dokumente. Këto të ardhura janë krijuar në një kohë të largët kur nuk kishte statusin e subjektit deklarues, rrethana që kanë ndikuar në mosmbajtjen e dokumenteve e që Komisioni duhet t'i vlerësonte në bazë të parimit të proporcionalitetit; (vii) të ardhurat nga emigracioni janë deklaruar në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim 2003 dhe kanë qenë të depozituara në sistemin bankar që në vitin 2001-2002, duke shuar çdo dyshim për abuzim nga subjekti me burimin e të ardhurave vetëm në funksion të deklarimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, çka i bën ato të besueshme e të provueshme. Prova të pa analizuar dhe të pa arsyetuara nga Komisioni. Saktësimi i shumës së të ardhurave nga emigracioni në vlerën 1.400.000 lekë është bërë gjatë hetimit administrativ, gjë që nuk përbën arsye ligjore për mospërfshirjen e tyre në analizën financiare derisa nuk është dhënë vendimi; (viii) në vlerësim të subjektit duhet të mbahen në konsideratë disa rrethana që bëjnë këto të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, informaliteti i ekonomisë shqiptare, remitancat të pashoqëruara me burime ligjore nga punëdhënësit dhe të pataknuara në Shqipëri, licencimi i bankave të nivelit të dytë në vitin 1999, pagesa nëpërmjet sistemit bankar pas vitit 2002 etj. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton, si vijon.

**23.1.** Kjo pasuri është përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes (apartament banimi) nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.01.2002, me shitës T. K. dhe blerës Tritan Hamitaj, me objekt apartament me sipërfaqe 86,18 m<sup>2</sup>, Durrës, kundrejt çmimit 1.500.000 lekë. Pasuria nuk konfirmohet e regjistruar, sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 29.05.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës. Subjekti e ka deklaruar, këtë pasuri si vijon.

**23.1.1.** Në deklaratë e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie<sup>29</sup>, datë 17.03.2004: *Apartament 2+1 [para vitit 1990], sipërfaqe 86,6 m<sup>2</sup>, lagjja nr. {\*\*\*}, rr. "{\*\*\*}", Durrës, vlera 3.500.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Kontratë shitblerje nga T. K.. Burimi: të ardhura nga puna si refugjat + trashëgimi + firmat piramidale.*

**23.1.2.** Në deklaratë e pasurisë *vetting*, ku deklarohet: *Apartament në pronësi të Tritan Hamitaj 2+1, sipërfaqe 86,18 m<sup>2</sup>, lagjja nr. {\*\*\*}, rr. "{\*\*\*}", pallati nr. {\*\*\*}, kati {\*\*\*}, Durrës, nr. pasurie {\*\*\*}, ZK nr. {\*\*\*}. Vlera e blerjes: 1.500.000 lekë. Koha e përfitimit në datën 27.01.2002. Burimi: të ardhura të ndodhura në "ProCredit Bank"(FEFAD), nga paga si gjyqtar më 19.11.1999, puna si emigrant në Greqi, të ardhura nga toka bujqësore, të ardhura të tjera familjare të asaj kohe.*

**23.2.** Për sa i përket mospërputhjes së vlerës së apartamentit të deklaruar më 17.03.2004, me atë të përcaktuar në kontratën e shitjes dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, ILDKPKI-ja në raportin<sup>30</sup> e kontrollit ka ngritur dyshime lidhur me çmimin 1.500.000 lekë të blerjes së apartamentit, me sipërfaqe 86,18 m<sup>2</sup>, në Durrës, në vitin 2002. Lidhur me ndryshimin e vlerës, subjekti e ka sqaruar në procesverbalin "Mbi pyetjen e subjektit Tritan Hamitaj" më datë 15.09.2005, në kuadër të kontrollit të ILDKPKI-së, se vlera 3.500.000 lekë, që është vendosur në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, është vlera e çmimit të shitjes në tregun e lirë në momentin e plotësimit të formularit të deklaratës. Edhe në përgjigje të pyetësorit të datës 03.04.2020, subjekti sqaron se prej tij ishte kuptuar gabim dhe ka plotësuar deklaratën duke menduar se kjo banesë kishte këtë vlerë tregu në atë moment. Si nga ILDKPKI-ja, ashtu edhe në Komision, për efekt të këtij procesi, në analizë u përllogarit vlera e blerjes 1.500.000 lekë, sipas kontratës së shitjes.

<sup>29</sup> Në këtë deklaratë, për depozitat bankare në "Tirana Bank" [lekë, USD] dhe cash në banesë prej 500.000 lekësh, subjekti deklaroi si burim paga + si refugjat + trashëgimi.

<sup>30</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 18.06.2018, "Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit Tritan Hamitaj, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës".

**23.3.** Lidhur me burimin e krijimit të këtij apartamenti, në kushtet kur në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar burime të ndryshme në raport me ato të deklaruara në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim 2003, konstatimit të Komisionit subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit të datës 03.04.2020, i përgjigjet se në vitin 2003 ka deklaruar vetëm ato burime të ardhurash, të cilat kanë qenë të një natyre të veçantë dhe për të cilat nuk kishte një dokumentacion zyrtar, duke nënkuptuar të tjerat me dokumentacion zyrtar si p.sh. pagat. Ndërsa, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar të gjitha burimet e mundshme që kanë krijuar të ardhura deri në momentin e blerjes së apartamentit, aq sa ka mbajtur në kujtesë, pasi lista nuk mund të jetë shteruese për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar. Edhe në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i qëndron burimeve të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në vijim, trupi gjykues analizoi të ardhurat e pretenduara si burim krijimi në këtë deklaratë.

**23.4.** *Lidhur me të ardhurat nga prindërit*, në kuadër të ekonomisë së përbashkët familjare, subjekti ka sqaruar se ka jetuar së bashku me prindërit deri më 06.05.2002 dhe ka qenë në një certifikatë me ta, deri në këtë datë. Çdo e ardhur, sqaron subjekti, deri në këtë datë, duhet të llogaritet si burim i pasurisë së krijuar prej subjektit. Konkluzionit të Komisionit se subjekti nuk ka përcaktuar sa ka qenë shuma e dhënë nga prindërit, subjekti i përgjigjet se nuk i është dhënë një shumë e caktuar, pasi pjesa e të ardhurave të familjes ishin depozituar në emër të tij në “ProCredit Bank” ShA dhe tërheqja është përdorur për blerjen e apartamentit. Me ndarjen nga ekonomia e përbashkët, subjekti ngre pretendimin se ka përfitur autoveturën, apartamentin, gjendjen në llogaritë bankare të datës 06.05.2002, si dhe gjendjen *cash*, për të cilën nuk kujton vlerë të saktë. Pjesa tjetër e të ardhurave të tërhequra nga subjekti në “ProCredit Bank” ShA, *cash* në familje dhe sende të luajtshme, u kanë kaluar prindërve dhe të vëllait A. H.

**23.4.1.** Nga analizimi i akteve të dosjes rezulton se me përgjigjet e pyetësorit të datës 03.04.2020, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si dokumentacion provues përgjigjet<sup>31</sup> e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Fier, për prindërit Rr. dhe Gj. H.. Ndërsa me prapësimet e rezultateve të hetimit sqaron se nuk ka dorëzuar dokumentacion me deklaratën e pasurisë *vetting* mbi të ardhurat e prindërve, por kjo gjë është plotësuar gjatë hetimit administrativ.

**23.4.2.** Megjithëse subjekti deklaron se nuk ka banuar me prindërit që prej muajit maj të vitit 1998, ai rezulton në një certifikatë familjare me ta deri më datë 06.05.2002, me përbërje Rr., Gj., T. dhe A. H.. Nga aktet në dosje, rezulton që A. H. ka emigruar dhe punon në Itali që prej vitit 1995, ndërkohë që nuk është depozituar dokument tjetër provues i ndryshimit të përbërjes së familjes me kryefamiljar Rr. H., nga përbërja familjare e datës 31.08.1991, (Rr., Gj., G., A., T. dhe A. H.), deri më 06.05.2002. Për të kryer një analizë financiare në kuadër të regjimit të përbashkët familjar, nga subjekti duhet të ishte depozituar dokumentacion, të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet për të gjithë anëtarët e familjes sepse mungesa e tyre e bën të pamundur verifikimin e mundësisë financiare për krijimin e depozitave në “ProCredit Bank” ShA, të cilat rezultojnë vetëm në emër të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, në kushtet kur subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim 2003, si burim krijimi të ardhurat nga pagat e prindërve, si edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, po kështu, nuk ka

---

<sup>31</sup> Vërtetimet nr. {\*\*\*} prot., nr. {\*\*\*} prot., nr. {\*\*\*} prot., datë 26.04.2018, për pension pleqërie për periudhën 01.09.2001-30.04.2018, për Gj. H.; vërtetimet nr. {\*\*\*} prot., nr. {\*\*\*} prot., datë 25.04.2018, për pension pleqërie për periudhën 01.07.2011-30.04.2018, për Rr. H.; shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 10.05.2018, për vjetërsinë në punë për efekt pensioni dhe vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të Gj. H.; shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 10.05.2018, në të cilën përcillet aktverifikim i vjetërsisë në punë para vitit 1994 dhe vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për periudhën 1994 - qershor 2011, për z. Rr. H..



deklaruar saktësisht si burim të ardhurat nga prindërit, por i pretendon ato të përfshira në deklarinimin “*të ardhura të tjera familjare të asaj kohe*”, pa depozituar dokument mbi këto të ardhura, sipas përcaktimit të pikës 7, të Udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, çon në konkluzionin e mos përfshirjes së tyre në analizë financiare. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit pretendon të trajtohet në kushtet e ekonomisë së përbashkët, në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 deklaroi të ketë blerë automjet nga vëllai i tij A. H., i cili, gjatë kryerjes së këtij transaksioni, figuron në një certifikatë familjare me të, por jeton në Itali që prej vitit 1995.

**23.5.** Lidhur me të ardhurat nga firmat piramidale, të cilat Komisioni nuk i përfshiu në analizë financiare me arsyetimin se subjekti nuk i ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe nuk paraqiti dokumentacion provues për to, trupi gjykues nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, konstaton, si vijon:

**23.5.1.** Gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e pyetësorit të datës 03.04.2020, pyetjes së Komisionit sesa janë të ardhurat që janë vendosur apo kthyer nga firmat piramidale, duke vënë në dispozicion dokumentacion provues, subjekti i përgjigjet se nuk i mban mend dhe nuk disponon dokumentacion. Ndërsa në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti sqaron se nuk ka siguruar të dhëna dokumentare për krijimin e këtyre të ardhurave, për shkak të kohës së gjatë dhe nuk është vlerësuar se një dokument i tillë do të duhej pas 23 vjetësh, kur edhe dokumenti arkivor, pas ruajtjes për 10 vjet, do të asgjësohej. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ILDKPKI-ja, në kontrollin e plotë të ushtruar për deklarinimin e parë të vitit 2003, nuk i ka kërkuar një dokument të tillë. Pas këtij kontrolli nuk ka pasur arsye të ruante më tej këtë dokument.

**23.5.2.** Trupi gjykues vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit për të mospërfshirë në analizën financiare të ardhurat e pretenduara nga firmat piramidale, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar vlerë për këto të ardhura as në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim dorëzuar më datë 17.03.2004, as në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe as gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe nuk depozitoi dokument provues, detyrim i parashikuar në pikën 7 të Udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, në të cilin parashikohet se: *Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre.*

**23.6.** Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga trashëgimia nga gjyshja, Komisioni vlerësoi se shpjegimet e subjektit nuk ishin bindëse dhe se nuk rezultoi që këto të ardhura të jenë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe nuk është depozituar dokumentacion provues lidhur me to. Nga subjekti nuk është deklaruar sa ka qenë shuma e përfituar nga L. H. dhe sa nga kjo shumë i është dhënë subjektit, për ta përdorur për blerjen e këtij apartamenti. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve të dosjes, konstaton si vijon.

**23.6.1.** Gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e pyetësorit të datës 03.04.2020, subjekti sqaron se të ardhurat nga trashëgimia konsistojnë në pasuri të luajtshme, kursime dhe sende me vlerë që gjyshja ka lënë pas vdekjes në vitin 1992. L. H. ka pasur vëllain me vendbanim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i arratisur pas vitit 1945 dhe gjatë viteve të diktaturës i ka dërguar motrës së tij dollarë amerikanë nëpërmjet rrugëve zyrtare, që në momentin e mbërritjes në Shqipëri janë këmbyer në lekë. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka sqaruar se në deklaratën e pasurisë *vetting* është shprehur *të ardhura të tjera familjare të asaj kohe*, ku përfshihen dhe të ardhurat e lëna nga gjyshja pas vdekjes. Në lidhje me mungesën

e dokumentacionit për këto të ardhura, sipas subjektit, dokumenti i dërgimit të dollarëve nga R. V. për L. H. është para vitit 1990 e një dokumentacioni i tillë nuk gjendet në arkivat shtetërore për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, prej më shumë se 30 vjetësh. Po kështu, edhe të ardhurat nga sendet me vlerë dhe të luajtshme të lëna nga gjyshja rezultojnë se nuk janë të dokumentuara, pasi nuk kanë qenë sende të cilat regjistroheshin në regjistra publikë dhe nuk mund të sigurojë dokumente.

**23.6.2.** Në kushtet e mungesës së dokumentacionit provues ligjor, që të provonte ekzistencën e të ardhurave të trashëguara apo masën e tyre, në linjë me Komisionin, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbeten në nivel deklarativ dhe kjo e ardhur nuk përfshihet në analizë financiare.

**23.7.** *Për të ardhurat nga emigracioni*, Komisioni në vendim shprehet se subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion provues në kuptim të ligjit nr. 84/2016, si dhe praktikën e konsoliduar të Kolegjit për të provuar këto të ardhura dhe në deklaratën e pasurisë *vetting* nuk rezultojnë të jetë deklaruar se sa ka qenë shuma konkrete e të ardhurave të përfituara prej tij në emigracion. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve të dosjes, konstaton si vijon.

**23.7.1.** Këtë të ardhur, subjekti i rivlerësimit e ka pretenduar si burim në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim, viti 2003 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, përkatësisht *puna si refugjat/puna si emigrant në Greqi*. Së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka depozituar deklaratën personale të shtetasit H. K., mbajtur në Rajonin e Policisë {\*\*\*}, më datë 21.01.2017, sipas së cilit, *gjatë kohës së verës 1991, 1992 dhe 1995, z. Tritan Hamitaj, punoi në {\*\*\*} në arat e mia, ngarkim-shkarkim dhe pagesa ishte 5.000-6.000 DRH në dorë pa marrëveshje kryesore pune. [...] banonte në shtëpinë e prindërve të mi të cilët kishin vdekur, së bashku me vëllezërit e tij. Kështu krijuam miqësi të madhe dhe na pritën në shtëpinë e tyre në Shqipëri. Bëj këtë deklaratë se nuk ishte nënshkruar asnjë marrëveshje pune.*

Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, për të provuar se ka punuar në Greqi te shtetasi H. K., ka depozituar: (1) përgjigjen e Konsullatës së Përgjithshme të Greqisë në Gjirokastrë, e-mail datë 23.06.2020, sipas së cilës subjekti është pajisur me vizë greke më datë 13.06.1995; (2) fotografinë e bërë në shtëpinë e prindërve të subjektit më datë 19.01.1992, ku ndodhet dhe shtetasi H. K.; (3) fotografinë e subjektit me H. K. në shtëpinë e tij në {\*\*\*}, {\*\*\*}, Greqi, më 21.01.2017. Prova në të cilat, sipas subjektit, ka indicie të rëndësishme, të sakta e në përputhje me njëra-tjetrën, me anë të të cilave arrihet në përfundimin se burimi i të ardhurave nga emigracioni ekziston dhe shuma e pretenduar prej tyre është bindëse. Emigracionin ekonomik në {\*\*\*}, {\*\*\*}, Greqi, për periudhën qershor-tetor 1991, korrik-shtator 1992 dhe korrik-shtator 1996, subjekti e ka deklaruar edhe në formularin e vetëdeklarimit për dekriminalizimin<sup>32</sup>, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

**23.7.2.** Subjekti, gjithashtu, ka sqaruar se nuk i janë mundur nga Drejtoria e Kufirit dhe Emigracionit hyrje-daljet në vitin 1995. Punësimi në emigracioni i padokumentuar, sipas tij, nuk mund të rëndojë mbi punëmarrësin ndaj dhe mbetet përgjegjësi e punëdhënësit dhe autoriteteve shtetërore përkatëse që kontrollojnë këtë veprimtari. Të ardhurat nga emigracioni, sipas subjektit, kanë qenë 1.950.000 drahmi minimumi dhe 2.340.000 drahmi maksimumi, konvertuar në qershor të vitit 1997, në 1.267.500 lekë deri 1.521.000 lekë, përkatësisht, të cilat duhet të përfshihen si të ardhura të ligjshme në krijimin e depozitave në “ProCredit Bank” ShA dhe në blerjen e shtëpisë në datën 17.01.2002, mesatarja e tyre në shumën 1.400.000 lekë.

---

<sup>32</sup> Në zbatimin të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

23.7.3. Me konsideratë jurisprudencën e Kolegjit<sup>33</sup>, në analizën financiare të kryer në Kolegj, në kuptim të nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues konsideroi vetëm të ardhurat që provohen me dokumentacion justifikues ligjor dhe për të cilat janë përmbushur detyrimet tatimore në vendin e origjinës së krijimit të tyre. Në këto kushte, të ardhurat e pretenduara nga emigracioni, të paprovuara me dokumentacion, në një vlerë të përcaktuar në formë deklarative, në linjë me arsyetimin e Komisionit, nuk mund të përfshihet në analizën financiare.

23.8. Lidhur me depozitat dhe llogaritë bankare në “ProCredit Bank” ShA (ish-FEFAD Bank) në lekë, dollarë amerikanë dhe euro, konfirmuar nga banka, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 30.09.2019, të hapura dhe të mbyllura në vitet 2000-2002, tërheqja e të cilave është përdorur për blerjen e apartamentit, trupi gjykues, në vijim të arsyetimit më sipër, si dhe referuar të ardhurave të provuara me dokumentacion ligjor të administruar në dosjen gjyqësore, në linjë me Komisionin, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare nga burime të ligjshme të krijojë këto depozita dhe konfirmon diferencën negative që ka rezultuar nga analiza e kryer në Komision në vlerën (-) 2.977.421 lekë, për krijimin e depozitave në vitet 2000-2001 dhe në vlerën (-) 2.273.231 lekë, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 86,18 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Durrës.

23.9. Në përfundim të arsyetimit më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj, sipas nenit 33, pika 5, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

*Për pasurinë, apartament me sipërfaqe 78,24 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Durrës*

24. Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 6.646.963 lekë për blerjen e apartamentit. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.
25. Konkluzionin e Komisionit e ka kundërshtuar subjekti i rivlerësimit me pretendimin se është i gabuar, vjen në kundërshtim me ligjin, parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe mosdhënien vlerë një prove. Komisioni nuk ka përfshirë të ardhurat e përfituara nga zgjidhja e kontratës së sipërmarrjes me “{\*\*\*}” ShPK, në shumën 51.000 euro. Trupi gjykues, nga aktet në dosje, konstaton si vijon.

25.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi *apartamenti 1+1, kati i dytë banim me nr. {\*\*\*} në projekt, sipërfaqe 78,24 m<sup>2</sup>, rr. “{\*\*\*}”, ndërtuar nga firma “{\*\*\*}”, kulla perëndimore, Durrës, pa hipotekë. Vlera e blerjes: 48.000 euro. Koha e përfitimit në datën 05.03.2014. Bashkëpronësi me R. H. në ½ pjesë. Burimi: zgjidhja e kontratës me “{\*\*\*}”, duke përfituar një shumë cash prej 51.000 eurosh. Në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, të kësaj deklarate, subjekti i rivlerësimit deklaroi të ardhura nga zgjidhja e kontratës së sipërmarrjes në datën 10.01.2014, me “{\*\*\*}” ShPK, për apartamentin 1+1, me sipërfaqe 51,1 m<sup>2</sup>. Përfituar nga Tritan Hamitaj 51.000 euro (41.000 euro kthim i shumës së apartamentit të porositur dhe 10.000 euro penalitet për mospërmbushje kontrate).*

25.2. Nga aktet në dosje gjyqësore rezulton se në datën 05.03.2014 nënshkruhet kontratë paraprake shitje apartamenti, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., me palë shitëse të ardhshme S. P.

<sup>33</sup> Shih vendimin nr. 4, datë 12.02.2019, paragrafi 37.2.2., vendimin nr. 6, datë 28.02.2019, paragrafi 20.12, vendimin nr. 23, datë 25.09.2020, paragrafi 26.3 dhe vendimin nr. 22, datë 22.07.2021, paragrafi 27.4, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

dhe palë blerëse të ardhshme Tritan Hamitaj. Objekt i kësaj kontrate është premtimi për shitje i apartamentit {\*\*\*}, me sipërfaqe 78,24 m<sup>2</sup>, kati i dytë i banimit, ndërtuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, në rrugën “{\*\*\*}”, pranë Muzeut Arkeologjik, Durrës. Çmimi në shumën 48.000 euro është likuiduar ditën e nënshkrimit të kontratës. Në kushtet e kësaj kontrate është përcaktuar se burimi i pagesës së çmimit vjen nga zgjidhja e kontratës së sipërmarrjes, datë 10.01.2011, nënshkruar mes porositesit Tritan Hamitaj dhe palës sipërmarrëse dhe investitore shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

**25.3.** Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave, nga zgjidhja e kontratës së sipërmarrjes në datën 10.01.2011 mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mori në analizë aktet e dosjes gjyqësore, ku konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “{\*\*\*}” ShPK kanë qenë në një marrëdhënie detyrimi dhe kanë nënshkruar mes tyre, akte të tilla si: kontrata huaje, përmbushje detyrimi kontraktor, kontratë sipërmarrje dhe zgjidhjen me mirëkuptim të kontratës së sipërmarrjes, shërbyer kjo e fundit si burim për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi.

**25.4.** Për këtë marrëdhënie huaje, Komisioni duke marrë në konsideratë faktin se: (i) subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të dhënë hua; (ii) shoqëria “{\*\*\*}” ShPK nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për kthimin e huave; (iii) huat nuk janë dhënë dhe marrë nëpërmjet sistemit bankar, detyrim ligjor i parashikuar nga legjislacioni tatimor, por dhe ai i pastrimit të parave, subjekti nuk ka treguar kujdesin e duhur në lidhje me këtë marrëdhënie, pasi ka pranuar që veprimet të kryhen në kundërshtim me legjislacionin e sipërcituar, Komisioni vlerësoi se subjekti është në kushtet e deklarimit të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë marrëdhënie huaje, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**25.5.** Subjekti i rivlerësimit në ankim ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionit dhe lidhur me aftësinë financiare të tij për dhënie hua në periudhën 2006-2010, shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, ka pretenduar se: (i) mungesa e të ardhurave nuk përfaqëson të gjithë shumën e dhënë dhe për çdo vit Komisioni duhet të kishte përcaktuar shumën e munguar, ku në fund të marrëdhënies së huas të deklaronte shumën e parave të subjektit. Vlera që mbulohej me burime të ligjshme duhet të ishte zbritur nga vlera 14.836.427 lekë, fakt i paarsyetuar në vendim; (ii) në kundërshtim me parimin e ligjshmërinë, paanësisë, proporcionalitetit e objektivitetit, Komisioni nuk ka përfshirë si të ardhur të ligjshme ato nga toka bujqësore, për vitet 2006-2010, të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes në Institutin e Kulturës Italiane, për vitet 2004-2008, si dhe të ardhurat nga interesat e kontratave të huas me shoqërinë “{\*\*\*}”, në vitet 2006-2010, të deklaruara në deklaratat e interesave privatë periodikë; (iii) shuma 900.000 lekë nuk është hua dhënë M. G., por detyrim i lindur nga pjesëtimi i dy pasurive, apartamentit dhe gjendjes në llogarinë bankare, mes bashkëshortes, nënës dhe motrës së saj. Subjekti kërkon përfshirjen si të ardhur të ligjshme të shumës 900.000 lekë, në vitin 2007; (iv) konkluzioni i Komisionit se shuma 1.500.000 lekë, e derdhur në llogarinë bankare të nënës së bashkëshortes nga bashkëshortja në vitin 2008, është pasuri e R. H., në kushtet kur subjekti nuk provoi me dokumentacion provues se kjo shumë i përket nënës së bashkëshortes, është i gabuar dhe jo në vlerësim objektiv të provave; (v) konstatimi i Komisionit se garazhi me sipërfaqe 24 m<sup>2</sup> është blerë në vitin 2009, duke konsideruar kështu të pavlefshme zgjidhjen e kontratës së zgjidhjes me kusht në këtë vit, është i gabuar. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, konstaton si vijon.

**25.5.1.** Me deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti depoziton kontrata huaje mes palëve të thjeshta, subjektit të rivlerësimit në cilësinë e huadhënësit dhe huamarrësit “{\*\*\*}” ShPK, të nënshkruara jo para një noteri publik, ku parashikohet interes 10 % mbi bazë vjetore dhe detyrimi tatimor parashikohet të paguhet nga huamarrësi, pa prekur shumën e interesit të

huadhënësit. Në deklaratat e interesave privatë periodikë 2006-2010, janë deklaruar nga subjekti dhënie e huave, sipas kontratave si vijon:

- i. kontratë huaje, datë 22.06.2006, për dhënie hua të shumës 2.800.000 lekë, me afat 6-mujor, interesi në shumën 140.000 lekë;
- ii. kontratë huaje, datë 23.12.2006, për dhënie hua të shumës 3.400.000 lekë, me afat 6-mujor, interesi në shumën 170.000 lekë;
- iii. kontratë huaje, datë 23.06.2007, për dhënie hua të shumës 3.600.000 lekë, me afat 6-mujor, interesi në shumën 180.000 lekë;
- iv. kontratë huaje, datë 25.12.2007, për dhënie hua të shumës 4.200.000 lekë, me afat 6-mujor, interesi në shumën 210.000 lekë;
- v. kontratë huaje, datë 27.06.2008, për dhënie hua të shumës 4.600.000 lekë, me afat 6-mujor, interesi në shumën 230.000 lekë;
- vi. kontratë huaje, datë 05.01.2009, për dhënie hua të shumës 3.000.000 lekë, me afat deri më 25.12.2009, interesi në shumën 290.000 lekë;
- vii. kontratë huaje, datë 05.08.2009, për dhënie hua të shumës 4.800.000 lekë, me afat deri më 25.12.2009, interesi në shumën 171.000 lekë; si dhe
- viii. kontratë huaje, datë 05.01.2010, për dhënie hua të shumës 8.400.000 lekë, me afat deri më 28.12.2010, interesi 820.000 lekë.

**25.5.2.** Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, me përgjigjet e pyetësorit, datë 03.04.2020, depoziton dokumentet “Përbushje detyrimi kontraktor”, si vijon:

- më datë 23.12.2006, kthyer shuma 2.800.000 lekë së bashku me interesin 140.000 lekë;
- më datë 23.06.2007, kthyer shuma 3.400.000 lekë dhe interesi 170.000 lekë;
- më datë 25.12.2007, kthyer shuma 3.600.000 lekë dhe interesi 180.000 lekë;
- më datë 27.06.2008, kthyer shuma 4.200.000 lekë dhe interesi 210.000 lekë;
- më datë 05.01.2009, kthyer shuma 1.830.000 lekë. Shuma prej 3.000.000 lekësh jepet përsëri hua;
- më datë 05.01.2010, kthehet shuma 8.261.000 lekë e u dha hua po këtë datë shuma 8.400.000 lekë.

**25.5.3.** Nëpërmjet aktit “Shlyerje detyrimi kontraktor”, datë 10.01.2011, referuar kontratës së huas, datë 05.01.2010, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK duhet të kthente më datë 28.12.2010, huan e marrë në shumën 8.400.000 lekë dhe interesin 820.000 lekë. Më datë 10.01.2011, shoqëria i kthen huadhënësit Tritan Hamitaj shumën 3.500.000 lekë, ndërsa pjesa tjetër e shumës prej 5.720.000 lekësh do të përdorej për lidhjen e kontratës së sipërmarrjes për apartament me sipërfaqe 51 m<sup>2</sup>, në {\*\*\*}, Durrës.

**25.5.4.** ILDKPKI-ja, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 25.02.2020, përcjell kontratën e sipërmarrjes, datë 10.01.2011, e nënshkruar në selinë e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK Durrës, mes kësaj shoqërie në cilësinë e sipërmarrësit dhe Tritan Hamitaj në cilësinë e porositësit, për apartamentin me sipërfaqe totale 51,1 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Komunën {\*\*\*}, Durrës, në vlerën 41.000 euro, e shlyer totalisht. Ky apartament është parashikuar të dorëzohet brenda muajit korrik 2012. Në rast se sipërmarrësi prish kontratën ose nuk e regjistron në hipotekë deri më 30.04.2012, porositësi ka të drejtë të prishë kontratën dhe të përfitojë veç çmimin e blerjes dhe një dëmshpërblim në masën 50 % të tij. Nga analizimi i deklaratës së interesave privatë 2011, rezulton që subjekti e ka deklaruar këtë kontratë sipërmarrje, duke deklaruar si burim kontratat e huave dhe interesat dhënë në vitin 2010, huan 8.400.000 lekë dhe 840.000 lekë interesi.

**25.5.5.** Të njëjtat palë, më datë 10.01.2014, nënshkruajnë “Zgjidhje kontrate me mirëkuptim”, për arsye se detyrimi i sipërmarrësit nuk u realizua për pajisjen me certifikatë pronësie brenda datës 30.04.2012. Porositësi do të përfitojë shumën 51.000 euro *cash* (likuiduar në këtë datë)

dhe e quan të zgjidhur me mirëkuptim kontratën e sipërmarrjes, si dhe nuk më ka asnjë pretendim për këtë apartament dhe për pjesën tjetër të penaltetit.

**25.5.6.** ILDKPKI-ja, në raportin mbi kontrollin e deklaratës së pasurisë, konstaton se: (i) dokumentet e paraqitura, kontratë sipërmarrje dhe zgjidhja e kësaj kontrate, nuk janë noteriale dhe transaksionet e pagesave për këtë apartament janë kryer jashtë sistemit bankar; (ii) kontratat e huas ndërmjet subjektit Tritan Hamitaj dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK janë, gjithashtu, të thjeshta, në të cilat nuk është deklaruar qëllimi i marrjes/përdorimit të shumave monetare. Po kështu, edhe shlyerja e detyrimeve mes palëve është bërë me dokument të thjeshtë, duke kthyer jo në rrugë bankare shumën 3.500.000 lekë, ndërsa diferenca 5.720.000 lekë u përdor për porosinë e apartamentit në {\*\*\*}, Durrës.

**25.5.7.** Në linjë me Komisionin, Kolegji, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare në përgjigje të pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni në vendimin e tij duhet të kishte përcaktuar për çdo vit shumën e munguar të burimeve financiare për dhënien e huave dhe në fund të deklaronte shumën e ligjshme që dispononte subjekti, në vlerësim të trupit gjykues nuk qëndron, pasi Komisioni ka vepruar në përputhje me nenin 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Në përgjigje ka kryer analizën financiare për të vlerësuar mundësinë e dhënies hua nga subjekti i rivlerësimit të shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, duke përcaktuar qartë mungesën e burimeve financiare të ligjshme për secilën hua të dhënë, në periudhën respektive. Për secilën hua, Komisioni në vendim ka pasqyruar analitikisht mundësinë e subjektit për dhënien e saj.

**25.5.8.** Si burim të ligjshëm të shumave të dhëna hua nga subjekti i rivlerësimit shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK nga huaja e parë më 22.06.2006 e deri në atë të fundit më datë 05.01.2010, subjekti i rivlerësimit pretendon të kenë shërbyer të ardhurat e vitit, përkatës. Në përgjigjet e pyetësorit të datës 3.4.2020 në Komisioni se për çfarë i ka marrë shoqëria këto hua, subjekti shprehet se nuk ka dijeni, por i është thënë nga shoqëria për mungesë likuiditeti. Më pas, nga administratori i shoqërisë A. D.<sup>34</sup>, subjektit të rivlerësimit i është bërë me dije se shoqëria nuk disponon dokumentacion të asaj kohe, si dhe arsyet për kryerjen e këtyre veprimeve.

**25.5.9.** Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të bashkëshortes nga punësimi pranë Institutit të Kulturës Italiane për vitet 2004-2008, siç janë deklaruar në deklaratat e interesave periodikë, me pretendimin se ka depozituar prova të mjaftueshme për të provuar këtë marrëdhënie pune dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive, sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të paraqitur dokument tjetër, trupi gjykues konstaton si vijon.

**25.5.10.** Me prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, pasi ka sqaruar se këto të ardhura janë marrë *cash*, për të provuar ekzistencën e marrëdhënies së punës *part-time* të R. H. pranë këtij instituti, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: (i) shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 11.06.2020, të Institutit të Kulturës Italiane, në të cilën citohet se [...] në vitet 2001-2009 kurset e gjuhës italiane në Durrës i ishin besuar Dr. I. K., së cilës duhet t'i drejtoheni për pagesat tuaja dhe mësimdhënien; (ii) deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.07.2020, të shtetasës I. K., në rolin e përgjegjëses prej fillimit deri në vitin 2018, pranë Instituti Italian i Kulturës, e cila deklaron se ky institut ka filluar aktivitetin në Durrës në vitin 2001. Po në këtë vit, sipas deklarueses, ka filluar mësimdhënien R. H. (H.) pa ndërprerje deri në vitin 2009, duke e rifilluar më pas në vitin 2014. Gjatë viteve 2001-2003, ka pasur angazhim të plotë, pasi ka qenë me status *beqare*, ndërsa në vitin 2004 i ka reduktuar orët e mësimdhënies për shkak se u

<sup>34</sup> Sipas të dhënave të ekstraktit historik të kësaj shoqërie aksesuar në faqen zyrtare të QKB-së, rezulton se z. A. D. është shtuar si ortak në këtë shoqëri me Vendimin e Asamblesë së Ortakëve, datë 21.11.2017.

bë nënë. Të ardhurat e saj për vitet 2001-2003 kanë qenë më të larta se viti 2004 e në vazhdim. Sipas deklaruësës, dokumentacioni është dërguar pranë institutit, ndërsa kopjen e mbajtur prej saj, për shkak të kohës së gjatë, nuk ka mundur ta gjejë. Paguesa deri në mes të vitit 2008 bëhej *cash* e më pas në llogarinë e saj bankare; (iii) komunikimet elektronike mes përgjegjëses I. K. me Institutin e Kulturën Italiane<sup>35</sup> (e-mail të datave 14.10.2005, 07.08.2006, 14.12.2006, 16.06.2009, 24.06.2009 dhe 06.10.2009). Në e-mail të datës 14.12.2006, përmendet si mësuese edhe R. H. për periudhën dhjetor 2006-mars 2007, ku përcaktohet dhe pagesa e saj prej 120.000 lekësh, në e-mail të datës 07.08.2006, citohet pjesëmarrja e saj si mësuese e këtij instituti në aktivitetin nga 28 gusht -1 shtator 2006, në e-mail datë 16.06.2009, për efekt pajisje me vizë pranë Ambasadës Italiane, citohet se R. (H.) H. ka filluar tek ne në vitin 2001.

**25.5.11.** Trupi gjykues, lidhur me këto të ardhura, arsyeton se në kuadër të procesit të rivlerësimit subjekti ka pasur detyrimin që bashkë me deklaratën e pasurisë *vetting* të depozitojë dhe dokumentacionin justifikues ligjor, për të provuar të dhënat e deklaruara në të dhe më pas gjatë hetimit administrativ i takon atij barra e provës, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, nëpërmjet dokumenteve ligjore, detyrim i parashikuar nga neni 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Nga aktet në dosjen gjyqësore, provohen të ardhurat nga punësimi pranë Institutit të Kulturës Italiane për vitet 2008, 2009 dhe 2014-2016. Ndërkohë që të ardhurat nga ky punësim subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar në deklaratat e interesave privatë periodikë, nga viti 2004 e në vijim, konkretisht: në vitin 2004, pagë në vlerën 200.000 lekë; në vitin 2005, pagë në vlerën 300.000 lekë; në vitin 2006, pagë në vlerën 280.000 lekë; në vitin 2007, pagë në vlerën 300.000 lekë; dhe në vitin 2008, pagë në vlerën 210.000 lekë. Edhe pse subjekti i rivlerësimit nga dokumentacioni i depozituar duket se ka provuar punësimin e bashkëshortes pranë këtij instituti, që përfaqëson një institucion të shtetit italian në Shqipëri që nga viti 2001, nuk provon me dokumentacion justifikues shumën e të ardhurave të përfituara, për periudhën 2001-2007. Trupi gjykues konstatoi se edhe nëse në analizë do të përfshiheshin të ardhurat e deklaruara në deklaratat e interesave privatë 2004-2007, përsëri subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me mungesë të burimeve financiare për dhënien e huave, si përcaktuar në paragrafin 25.6 të këtij vendimi.

**25.5.12.** Lidhur me konkluzionin e Komisionit se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të dhënë hua shumën 900.000 lekë në vitin 2007, subjekti i rivlerësimit e gjen të pabazuar në prova dhe të paarsyetuar. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo shumë nuk është hua, por detyrim i lindur nga pjesëtimi i dy pasurive, apartament dhe gjendje në llogarinë bankare, mes bashkëshortes, nënës dhe motrës së saj dhe kërkon përfshirjen si të ardhur të ligjshme të shumës 900.000 lekë, në vitin 2007. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve në dosje, konstaton si vijon.

**25.5.13.** Nga analizimi i deklaratave të pasurisë, rezulton:

- Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar “R. H. jep borxh motrës M. H. 900.000 lekë”.
- Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2014, si burim krijimi për apartamentin me sipërfaqe 103,82 m<sup>2</sup>, në Tiranë, me blerës R. H. dhe M. G., subjekti deklaroi edhe “900.000 lekë kthim borxhi M. G.”.
- Në deklaratën e pasurisë *vetting*, po për apartamentin në Tiranë, subjekti ndër burimet deklaroi “900.000 lekë kthim huaje nga M. G. (dhënë pas mbylljes së llogarive bankare)”.

**25.5.14.** Gjatë hetimit administrativ në Komision, me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti sqaron se kjo shumë nuk është dhënë hua, por është detyrim i krijuar nga M. te R., për

---

<sup>35</sup> Me {\*\*\*}@esteri.it, me znj. M.K., e cila rezultoi ende në të njëjtin pozicion pranë këtij instituti, sipas të dhënave në faqen zyrtare të tij. [https://iictirana.esteri.it/iic\\_tirana/sq/istituto/chi\\_siamo/lo\\_staff](https://iictirana.esteri.it/iic_tirana/sq/istituto/chi_siamo/lo_staff)

shkak të marrëveshjes së pjesëtimit të realizuar mes tyre, për apartamentin me sipërfaqe 78,58 m<sup>2</sup>, në Durrës dhe shumën 6.000.000 lekë të depozituar në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA. Në kushtet kur nga kjo marrëveshje M. përfitoi më shumë pasuri, duhet të kompensonte R. në shumën 900.000 lekë. Subjekti pretendon se këtë shumë gabimisht e ka deklaruar hua, ndërkohë që duhet ta deklaronte detyrim të motrës së bashkëshortes ndaj saj, e që, sipas tij, vjen në harmoni me kontratën e dhurimit dhe me kalimin e shumës prej 6.000.000 lekësh nga R. te M.. Në mbështetje të argumenteve të tij, subjekti depoziton deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.07.2020, të shtetasës M. G., e cila konfirmon pretendimin e subjektit.

**25.5.15.** Nga aktet në dosje, trupit gjykues i rezultojnë se nëpërmjet kontratës së dhurimit (pasurie të paluajtshme) nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 09.11.2007, L. H. dhe M. G. (H.) pjesët e tyre të pandara të bashkëpronësisë prej 2/3 mbi apartamentin<sup>36</sup> me sipërfaqe 78,58 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Durrës, ia dhurojnë vajzës dhe motrës së tyre R. H. (bashkëpronare e pjesës 1/3), e cila bëhet pronare e vetme. Ndërsa referuar lëvizjes së llogarisë bankare të R. H., përcjellë Komisionit, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 23.09.2019, nga “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, rezultojnë të jetë transferuar më datë 02.07.2007, shuma 6.000.000 lekë, në favor të M. G. (H.).

**25.5.16.** Në kushtet kur deklaratat e interesave privatë periodike përdoren si provë në kuptim të nenit 32, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit ka qenë konsistent si në deklaratat e interesave privatë të viteve 2007, 2014 edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke e konsideruar shumën 900.000 lekë të dhënë dhe të kthyer në formë huaje dhe jo si detyrim për efekt pjesëtimi pasurie mes motrave, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për të mos e përfshirë këtë shumë në analizën financiare të vitit 2007 si hua, por si të ardhur, është i pabazuar. Këtë e përforcon fakti se në deklaratën e pasurisë *vetting* subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë shumë si të ardhur, në rubrikën e rezervuar për këtë zë.

**25.5.17.** Me parashtrimet depozituar në Kolegj, subjekti pretendon ndryshimin e zërit *shpenzim tjetër i evidentuar* konsideruar në analizën financiare të Komisionit të vitit 2007, nga vlera 3.910.000 lekë në 2.606.666 lekë (2/3 e 3.910.000 lekë). Komisioni e ka përllogaritur këtë vlerë si shpenzim për arsye se subjekti i rivlerësimit në deklaratë e interesave privatë 2007 ka deklaruar *tërhequr 3.910.000 lekë nga R. H.*, ndërkohë që nuk deklaroi gjendje likuiditetesh në *cash* në fund të këtij viti, si dhe nuk deklaroi dhënien e kësaj shume motrës së bashkëshortes. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarive bankare të R. H., me nr. {\*\*\*}, në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, rezultojnë që shuma 3.910.000 lekë të jetë investuar në bono thesari për periudhën 22.06.2006-21.06.2007 dhe më pas së bashku me shumën 2.111.151 lekë transferuar në këtë llogari më datë 28.06.2007 nga llogaria bankare e nënës L. H., shtuar interesat e akumuluar, në total shuma 6.000.000 lekë, transferohet në llogarinë bankare të M. H. (G.). Në këto kushte, rezultojnë që deklarimi i subjektit në deklaratën periodike 2007 është i pasaktë, gjë që e bën të pabazuar edhe pretendimin e ngritur me parashtrimet.

**25.5.18.** Analiza financiare e kryer në Kolegj mbështetur në dokumentacionin justifikues ligjor të administruar tregoi pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për dhënien e huas në shumën 900.000 lekë në vitin 2007, në vlerën (-) 1.703.463 lekë dhe nëse do të përfshiheshin në analizë të ardhurat nga toka bujqësore dhe të ardhurat e bashkëshortes pranë Institutit të Kulturës Italiane për këtë vit, sipas

---

<sup>36</sup> Apartament i përfutur me kontratë shitblerje, datë 22.02.1994, me shitës Ndërmarrjen Komonale Banesa dhe blierës S., L., M. dhe R. H., në vlerën 19.318 lekë.



deklaratës së interesave privatë të vitit 2007, mungesa e burimeve do të rezultonte në shumën (-) 1.103.463 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

**25.5.19.** Lidhur me shumën 1.500.000 lekë, të derdhur nga bashkëshortja R. H., në llogarinë bankare të nënës L. H., në vitin 2008, subjekti pretendon se: (i) Komisioni ka mbivlerësuar dokumentin bankar të “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, i cili është i paplotë në përshkrimin e arsyes së derdhjes së shumës dhe i krijuar në mënyrë të njëanshme nga punonjësi i bankës dhe nuk provon faktin se i përket R.; (ii) për shkak të pamundësisë që rrjedh nga kalimi i afatit të ruajtjes prej 10 vitesh dokumenti i firmosur nga bashkëshortja nuk është administruar si provë. Bashkëshortja nuk mban mend të ketë bërë një derdhje të tillë dhe, aq më pak, nëse ka bërë përshkrim në të. Dokumenti bankar do të kishte fuqi të plotë provuese vetëm nëse në të do të ishte përshkrimi se bashkëshortja ia kishte hua nënës së saj, shlyerje detyrimi etj.; (iii) Komisioni nuk ka vlerësuar faktin se nëna e bashkëshortes ka qenë invalide e plotë dhe mund të lëvizte nga shtëpia vetëm për arsye të forta, dhe R., si e bija, thjesht ka derdhur shumën për llogari të L. H.; (iv) konstatimi i Komisionit se nëna e bashkëshortes nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e shumës është i pabazuar, pasi totali i të ardhurave të saj nga shitje e qira dyqanesh, kullotash, shtëpish, fitim nga hoteleria në Gjirokastër, dëmshpërblim si ish të përndjekur politikë, pjesëtim pasurie në Lushnjë, pa llogaritur të ardhurat pas vitit 2004, provon të kundërtën. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues, konstaton si vijon.

**25.5.20.** Nga lëvizja e llogarisë bankare nr. {\*\*\*}, në lekë, në emër të shtetasës L. H., përcjellë nga “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.03.2020, rezulton se kjo llogari është kredituar më datë 26.05.2008, në shumën 1.000.000 lekë, me përshkrimin *cash deposit R. H.* dhe më datë 16.06.2008 në shumën 500.000 lekë, me përshkrimin *cash deposit R. H.* Më datë 24.07.2008, nga L. H. është tërhequr nga kjo llogari shuma 2.000.000 lekë, me përshkrimin *cash withdrawal L. H.*

**25.5.21.** Trupi gjykues, nisur nga shumat e depozituara e konsideron të papranueshëm pretendimin e subjektit se veprimet bankare të kryera nga bashkëshortja në vitin 2008 nuk mbahen mend prej saj. Nga ana tjetër, për të analizuar mundësinë e nënës së bashkëshortes në krijimin e shumës 1.500.000 lekë, trupi gjykues mori në analizë të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, si, qira dyqanesh, kullotash, shtëpish, fitim nga veprimtaria tregtare në fushën e hotelerisë në Gjirokastër, dëmshpërblimin si ish të përndjekur politikë, pjesëtim trualli në Lushnjë, të pretenduara, gjithashtu, nga subjekti i rivlerësimit edhe si burim për krijimin e shumës 6.000.000 lekë në vitin 2004 dhe depozitave të bashkëshortes në vitin 2003 e 2004, para martesës me subjektin (shkurt 2004).

*Lidhur me të ardhurat nga pasuritë në Gjirokastër*

**25.5.22.** Nga aktet e administruara në dosje rezulton se me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 08.11.1992, të Këshillit të Rrethit Gjirokastër “Për kthimin e pasurive të paluajtshme të ish të dënuarve e përndjekurve politikë”, shtetasit M. H. i kthehen pasuritë e paluajtshme të konfiskuara me vendim gjykate nr. {\*\*\*}, datë 25.07.1945, konkretisht dy shtëpi, hotel “{\*\*\*}”, dyqane, depot dhe mulliri. Këto prona rezultojnë të regjistruara në pronësi të tij, sipas vërtetimit pronësie nr. {\*\*\*} prot., datë 18.06.1998, të Hipotekës Gjirokastër.

**25.5.23.** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se përfitues të këtyre pasurive kanë qenë edhe L., M. e R. H.. Në përgjigjet e pyetësorit të datës 03.04.2020, ka sqaruar se hoteli dhe dyqanet janë kthyer me vendim të Kryesisë së Këshillit të Rrethit Gjirokastër nr. {\*\*\*}, datë 08.11.1992, në emër të njërit prej bashkëpronarëve, M. H.. Në këtë vendim është pasqyruar se M. H. është pronar i vetëm, ndërkohë që e vërteta nuk ka qenë kështu. Bashkëpronarët e vërtetë, ndër to edhe S. H., ranë dakord që në momentin e parë të arrinin ta merrnin pronën e tyre nga shteti

*dhe më vonë rregullonin të drejtat e tyre të bashkëpronësisë. Pas marrjes së hotelit dhe dyqaneve ato janë shfrytëzuar me të drejta të plota si pronar. Hoteli ka qenë në administrim nga z. H. H., për të cilën është regjistruar edhe në organet tatimore dhe dyqanet janë dhënë me qira. Z. H. H., megjithëse nuk ka qenë de jure bashkëpronar në hotel, ka nxjerrë licencën dhe ka punuar hotelin në veprimtarinë e hotelerisë në të njëjtën fushë të cilën ai ishte para konfiskimit. Të ardhurat nga hoteli dhe dyqanet janë ndarë rregullisht midis bashkëpronarëve të vërtetë çdo muaj, duke mbajtur mandate dore për dhënien e këtyre shumave dhe evidenca vjetore për të bërë krahasimin ndër vite.*

Për këto të ardhura, subjekti sqaron në vijim se nuk ka të dhëna të sakta për shumën e përfutur, pasi Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastër nuk disponon dokumentacion në lidhje me hotelin, xhiron dhe fitimin e realizuar për vitet 1992-2001 dhe bashkëpronarët kanë mungesë dokumentacioni. Personat që kanë mbajtur dokumentacion financiar kanë vdekur dhe arkivi nga trashëgimtarët e tyre është hedhur për shkak të kohës së gjatë. Për të ardhurat nga dhëna me qira e kullotave, nuk ka arritur të sigurojë dokumentacion lidhur me to.

**25.5.24.** Me prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti depoziton disa akte shkresore për të provuar këto të ardhura: (i) regjistrimin e personit fizik “{\*\*\*}” për aktivitetin “Shërbim hotel”, sipas vendimit nr. {\*\*\*}, datë 07.02.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjirokastër; (ii) vendimet gjyqësore<sup>37</sup> të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me objekt, lirim dorëzim sendi, si dhe detyrim për pagimin e qirasë së dyqaneve, kullotave, shtëpive, në të cilat nuk përmenden emrat e familjarëve të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, S. apo L. H.; (iii) kontratë shitje dyqanesh më datë 21.09.1999<sup>38</sup>. Në lidhje me qiratë e dyqaneve, kullotave dhe shtëpive me prapësimet, subjekti depoziton dhe letra të thjeshta dore, mandatpagesa, urdhërpagesë<sup>39</sup>, të cilat nuk plotësojnë kushtet ligjore për t’u konsideruar provë. Disa prej këtyre akteve, përmbajnë emrin M. H. si përfituese, konkretisht: urdhër nr. {\*\*\*}, datë 23.11.1997, pagesë qiraje dyqani në shumën 24.500 lekë, për muajin janar 1997; dhe mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 22.10.1997, të ardhura nga hoteli në shumën 57.750 lekë, për muajin shtator 1997.

Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, duke u nisur nga të dhënat e këtyre mandatpagesave e urdhërpagesa, subjekti i rivlerësimit konkludon në vlera hipotetike, duke shumëzuar të ardhurat e ekstraktuar prej tyre me numrin e muajve të vitit apo duke përlllogaritur pjesë takuese prej 7.14 % të të ardhurave nga këto pasuri (qira dyqanesh, veprimtari hoteli, shitje dyqanesh) në pronësi të familjes H., si trashëguese e S. H., gjyshi i bashkëshortes dhe më pas babait të saj.

**25.5.25.** Me parashtrimet e depozituara nga subjekti në Kolegj, trupi gjykues konstaton se R. H. dhe motra e saj M. G. janë në proces gjyqësor për t’u njohur si bashkëpronare mbi këto

---

<sup>37</sup> Vendimet nr. {\*\*\*}, datë 01.03.2002; nr. {\*\*\*}, datë 17.04.2002; nr. {\*\*\*}, datë 16.06.2004; nr. {\*\*\*}, datë 15.10.1998; nr. {\*\*\*}, datë 19.10.1998; nr. {\*\*\*}, datë 23.12.2003; nr. {\*\*\*}, datë 15.07.1996 dhe nr. {\*\*\*}, datë 13.12.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

<sup>38</sup> Kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.09.1999, transaksion i kryer nga fëmijët e M. H. (H., H., D. dhe S. H.) te blerësi Q. Dh., në vlerën 3.000.000 lekë. Dokument i përcjellë nga subjekti i rivlerësimit në datën 12.06.2020. Nga aktet në dosje, nuk rezulton që kjo shumë të jetë ndarë në bashkëpronarë të tjerë.

<sup>39</sup> Urdhërpagesë, datë 20.09.1995, të ardhura nga hoteli në shumën 75.000 lekë, për muajin shtator 1995; mandatpagesë, datë 28.01.1996, pagesë qiraje dyqani në shumën 75.827, për muajin dhjetor 1995; mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 30.10.1996, të ardhura nga hoteli, në shumën 100.000 lekë për muajin tetor 1996; mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 24.06.1996, të ardhura nga hoteli për muajin prill 1996, [përfitues për këto kanë qenë vëllazëria e K.]; urdhër nr. {\*\*\*}, datë 23.11.1997, pagesë qiraje dyqani në shumën 24.500 lekë për muajin janar 1997, përfitues M. H.; mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 22.10.1997, të ardhura nga hoteli në shumën 57.750 lekë, për muajin shtator 1997, marrë nga M. H.; letër e thjeshtë, datë 07.05.1999, të ardhura nga qira dyqanesh në shumën 85.500 lekë, për muajin prill 1999, përfitues S. H.; pasqyrë e të ardhurave nga qira kullotash në vlerën 47.290 lekë, për 6 muaj të vitit 1999, përfitues S. H., në shumën 236.628, për 6 muaj të vitit 2000 dhe në shumën 76.599 lekë, për 6 muaj të vitit 2002, për vëllazërit H..

pasuri, duke qenë palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor civil, në cilësinë e ndërhyrësit kryesor në padinë me objekt njohje bashkëpronësie, që po zhvillohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Kjo çështje, sipas subjektit, është regjistruar në gjykatë më 02.07.2020, me qëllimin formalizimin e pronësisë së bashkëshortes në këto pasuri të paluajtshme.

25.5.26. Nga aktet e depozituara në Kolegj nuk evidentohet masa e të ardhurave të përfituara nga L., R. dhe M. H., pasi nuk është depozituar dokumentacion justifikues ligjor që përcakton krijimin e këtyre të ardhurave në emër të tyre. Në këto kushte, në linjë me Komisionin, të ardhurat e pretenduara nga pasuritë në Gjirokastrë nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare të kryer për të verifikuar mundësinë e L., R. dhe M. H., deri në vitin 2004.

#### *Lidhur me të ardhurat nga pjesëtimi i truallit në Lushnjë*

25.5.27. Nga aktet e dosjes gjyqësore, rezulton se me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.01.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, i fazës së parë të pjesëtimin të pasurisë së paluajtshme të llojit “truall dhe ndërtesë” me sipërfaqe 2945 m<sup>2</sup>, nga e cila 626 m<sup>2</sup> banesë e ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Lushnjë, L. H. T. ka përfituar pjesën takuese 1/12 të këtyre pasurive. Nga vendimi, nr. {\*\*\*}, datë 09.04.2003, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, i fazës së dytë të pjesëtimin, L. H. përfitoi ¼ e sipërfaqes 890 m<sup>2</sup> (truall dhe ndërtesë furrë buke), ndërsa me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 06.05.2005, po të kësaj gjykate, me objekt korrigjim gabimi në vendimin gjyqësor, nr. {\*\*\*}, datë 09.04.2003, L. T. H. ka përfituar 245 m<sup>2</sup> truall nga pjesëtimi i sendit dhe jo sipërfaqe ndërtimore.

25.5.28. Subjekti, si gjatë hetimit administrativ në Komision, në ankim dhe parashtrimet në Kolegj, nisur nga sa shkruhet shprehimisht në vendimin gjyqësor nr. {\*\*\*}, datë 09.04.2003, se *pabarazia në natyrë e sendeve midis pjesëve është kompensuar në para, në marrëveshje të palëve*, fakt që rezulton dhe nga procesverbali i seancës gjyqësore, ngre pretendimin se L. H. ka përfituar shumën 3.500.000 lekë, në vitin 2003. Nga aktet në dosjen gjyqësore, subjektit nuk i rezulton të jetë bërë një *aktekspertim* ku të pasqyrohej vlera e kompensimit për bashkëpronarët, të cilët kanë marrë pjesë fizike më të vogël. Nga përgjigjja e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor nr. {\*\*\*} prot., datë 14.07.2020, nuk rezulton të ketë *aktekspertim* apo konkluzione të palëve, prej të cilave të mund të përcaktohet vlera në lekë që ka përfituar L. H., për shkak se në pjesën fizike përfituar prej saj nuk përfshihet sipërfaqe ndërtese. Sipas subjektit, të gjithë bashkëpronarët ranë dakord që të përcaktonin çmim për ndërtesat, konkretisht për banesën dykatëshe, shtëpinë me bodrum, garazhin dhe furrin, duke përfshirë edhe përdorimin e tyre që nga momenti i marrjes nga shteti, në vitin 1993. Për këtë fakt, subjekti ka dorëzuar disa deklarata noteriale<sup>40</sup> të bashkëpronarëve të tjerë, të cilët pohojnë vlerën e objekteve të përcaktuar prej tyre dhe vlerën prej 3.500.000 lekësh që ka përfituar L. H. nga pjesëtimi, në vitin 2003. Sipas tyre, marrëveshja ka qenë e shkruar, por nuk disponohet për shkak të kohës së gjatë të kaluar.

25.5.29. Nisur nga sa parashtruar më sipër, trupi gjykues konstaton se në dispozitivin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 06.05.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me objekt korrigjim gabimi në vendimin gjyqësor nr. {\*\*\*}, datë 09.04.2003, është përcaktuar qartë se L. T. (H.) nga pjesëtimi i sendit ka përfituar vetëm 245 m<sup>2</sup> truall, ndërsa pretendimi se në vitin 2003 ka përfituar shumën prej 3.500.000 lekësh nga pjesëtimi i pasurisë mbetet në nivel deklarativ dhe i pambështetur në ndonjë dokumentacion ligjor apo/dhe financiar të kohës, që të provojë se nëna e bashkëshortes së subjektit ka përfituar realisht shumën monetare të sipërcituar. Për këto

---

<sup>40</sup> Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.07.2020, e shtetasit A. T.; deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.07.2020, e shtetasit J. T.; deklarata noteriale, datë 14.07.2020, e shtetasve Gj. T., E. (T.) S. dhe E. (T.) I., përpara noterit në ShBA.

arsye, në linjë me Komisionin, kjo shumë nuk u përfshi në analizën financiare të kryer në Kolegj.

#### *Lidhur me të ardhurat e pretenduara si dëmshpërblimi si ish të përndjekur politikë*

**25.5.30.** Trupi gjykues, për këto të ardhura, konstaton se nga subjekti i rivlerësimit janë depozituar aktet: (i) shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 21.04.2020, e Institutit të Integritit të ish të Përndjekurve Politikë dhe vërtetimeve për dhënie statusi, sipas së cilave S. K. H. ka statusin e të ekzekutuarit politik Gr. A, S. S. H. ka statusin e të internuarit politik Gr. C., Nj. S. H. ka statusin e të internuarit politik Gr.C, N. T. H. ka statusin e të internuarës politike GR.C, S. I. T., ka statusin e të ekzekutuarit politik Gr. A dhe E. I. T. ka statusin e të burgosurit politik Gr.B. Sipas kësaj shkrese, kompensimet e përfituara nga ish të dënuarit apo ish të përndjekurit politik u tërhoqën nga vetë personat apo familjarët e tyre pranë Bankës së Kursimeve. Instituti nuk disponon ndonjë dokument specifik për tërheqjen e lekëve dhe letrave me vlerë; (ii) shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 19.05.2020, të “Raiffeisen Bank” ShA, referuar së cilës, për periudhën 1995-1997, rezultoi të jenë tërhequr në Bankën e Kursimeve: S. K. H.<sup>41</sup> shumën 200.000 lekë në dorë dhe 720.000 lekë privatizimi; S. I. T. shumën 200.000 lekë në dorë dhe 720.000 lekë privatizimi; S. S. H. shumën 746.630 lekë privatizimi; N. T. H. shumën 746.630 lekë privatizimi; si dhe E. I. T. shumën 915.287 lekë privatizimi. Këto shuma, sipas shkresës, janë përfituar nga statusi si ish të përndjekur politik.

**25.5.31.** Në kushtet kur S. H. dhe bashkëshortja N. H. (gjyshërit e bashkëshortes) kanë ndërruar jetë në vitin 1943 dhe 1974, përkatësisht, duke lënë trashëgimtarë S. H. (babain e bashkëshortes) ndërruar jetë më 11.07.1994 dhe motrën e tij, K. H., subjekti pretendon se L., R. dhe M. H. kanë përfituar këto të ardhura në cilësinë e trashëgimtareve të tyre. Për më tepër, L. H. ka përfituar 1/6 shumës së dhënë E. T. (si trashëgimtare e tij). Lekët e privatizimit, sipas subjektit, janë shkëmbyer nga familjarët e R. H. në para dhe me to janë krijuar kursime, pasi nuk janë përdorur për investime. Shuma e përfituar në total nga L., M. dhe R. H. (H.) është 1.732.492 lekë dhe lekë privatizimi. Subjekti sqaron se nuk është në dijeni kujt i janë shitur, pasi shitja e tyre nuk bëhej me kontratë noteriale, por shkëmbeheshin njësoj si monedhat.

**25.5.32.** Në kushtet kur subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues, për të provuar të ardhurat konkrete të përfituara nga shkëmbimi lekë privatizimi në shuma monetare, ato nuk janë përfshirë në analizën financiare të kryer në Kolegj. Në linjë me Komisionin, në kushtet kur subjekti nuk provoi me dokumentacion që shuma 1.500.000 lekë i përket nënës së bashkëshortes, e cila për periudhën ka realizuar të ardhura vetëm nga pensioni, me të drejtë kjo shumë është përfshirë si pasuri e bashkëshortes së subjektit R. H., në vitin 2008.

**25.6.** Në mbështetje të arsyetimit më sipër, Kolegji, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit për dhënien hua shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për periudhën 2006-2010. Rezultatet e analizës treguan mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën: (-) 347.013 lekë, për huan 2.800.000 lekë dhënë më 01.01.2006; (-) 141.279 lekë, për huan 3.400.000 lekë dhënë më 22.06.2006; (-) 1.226.313 lekë, për huan 4.200.000 lekë dhënë më 23.06.2007; (-) 1.450.498 lekë, për huan 4.600.000 lekë dhënë më 01.01.2008; (-) 42.540 lekë dhënë më 27.06.2008; (-) 546.992 lekë, për huan 4.800.000 lekë dhënë më 05.01.2009; (-) 940.189 lekë, për periudhën 05.08.2009 - 25.12.2009; si dhe (-) 480.631 lekë, për huan 8.400.000 lekë dhënë më 05.01.2010. Totali i diferencave negative për dhënien e huave është (-) 5.175.455 lekë. Edhe nëse në analizën financiare do të përfshiheshin të ardhurat nga tokat bujqësore dhe të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes pranë Institutit të

<sup>41</sup> Sipas dëshmisë së trashëgimisë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.10.1992, për trashëgimlënësit S. H., N. H. dhe N. H., trashëgimtar ligjor i tyre është S. S. H. dhe K. S. H.

Kulturës Italiane, të deklaruara në deklaratat periodike të kësaj periudhe, përsëri do të rezultonte mungesë burimesh financiare në vlerën (-) 3.445.455 lekë.

Nëse do të konsiderohej e zgjidhur më datë 26.12.2009 kontrata e shitjes me kusht, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.08.2009, trajtuar në paragrafin 31.6 të këtij vendimi, do të shërohej pamjaftueshmëria e vitit 2009 me pasojë rritjen e diferencës negative për vitin 2011, në vlerën (-) 3.182.038 lekë.

26. Për të kundërshtuar konkluzionin e Komisionit se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për kthimin e huave, subjekti i rivlerësimit ka ngritur këto shkaqe ankimore: (i) barra e provës, lidhur me personin tjetër të lidhur, duhet të jetë proporcionale vetëm për provat e ndodhura pranë tij e jo për ato që ndodhen te personi tjetër i lidhur e në pamundësi marrjeje. Parashikimi në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk është i autorizuar nga Kushtetuta dhe bie në kundërshtim me të. Ky parashikim ligjor ngarkon njësoj me subjektin e rivlerësimit, si personin e lidhur dhe personin tjetër të lidhur. Barra e provës ndaj tij ka mbaruar në momentin që ka dorëzuar kontratat e huas, shlyerjen e detyrimit, përpjekjet për të siguruar dokumente pranë shoqërisë dhe pamundësinë e marrjes së tyre; (ii) Komisioni kishte detyrimin të merrte provat e ndodhura pranë shoqërisë, thirrjen si dëshmitar të administratorit dhe ortakëve, si dhe dokumente të ndodhura në ASHK, noter, banka etj., pasi detyrimi i Komisionit për të hetuar prevalon në raport me detyrimin e subjektit për të provuar elementët e përcaktuar prej ligjit. Pavarësisht detyrimit të subjektit, Komisioni nuk mund të qëndrojë pasiv e të kryejë një hetim të paplotë; (iii) Komisioni nuk ka vlerësuar faktin se dokumentacioni i nevojshëm nuk disponohet nga shoqëria për shkak të kalimit të afatit të ruajtjes, sipas nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008, për pasojë duhet të ishte zbatuar neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016; (iv) aktet e nënshkruara me shoqërinë janë shkresa të thjeshta, të cilat përbëjnë provë të plotë, sipas nenit 246 të Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit Civil, referuar neneve 850 deri 876, si dhe neni 1050, të cilët nuk parashikojnë që kontratat duhet të jenë noteriale. Kontratat janë të vlefshme nga ana ligjore dhe vijnë në harmoni me deklaratat periodike të viteve 2006-2011 dhe 2014 e duhet të ishin vlerësuar në unitet me to; (v) bilancet e viteve 2008-2011 të shoqërisë nuk janë verifikuar për vërtetësinë e tyre nga aktet e kontrollit nga organet tatimore. Në këto kushte, bilancet kanë fuqinë e një shkrese të thjeshtë, sipas nenit 246 të Kodit të Procedurës Civile dhe nuk plotësojnë kriteret e një dokumenti zyrtar. Bazuar në nenin 273 të Kodit të Procedurës Civile, subjekti ka provuar falsitetin e bilanceve, pasi në to nuk janë pasqyruar ngjarje ekonomike, si kredi bankare, kontrata sipërmarrjeje, shitje apo kontratat e huas me subjektin e rivlerësimit. Komisioni nuk duhet t’i kishte vlerësuar si provë bilancet e viteve 2006-2013. Nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, trupi gjyqësor konstaton se:

26.1. Për të provuar mundësinë financiare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për kthimin e huave subjektit të rivlerësimit, Komisioni i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës, me kërkesë për informacion në mënyrë të përmblodhur, për sa më poshtë:

- a ka pasur detyrim ligjor shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, për të deklaruar pranë organeve tatimore huat e marra nga z. Tritan Hamitaj, duke referuar bazën ligjore;
- a kishte detyrim ligjor shoqëria “{\*\*\*}” ShPK që huat e marra t’i përfshinte në bilancin e shoqërisë, referoni bazën ligjore;
- vënien në dispozicion të bilanceve të shoqërisë për vitet 2006-2014;
- a është e lejuar dhënia e huave nga individ në mënyrë periodike, referoni bazën ligjore; dhe
- a kishte detyrim ligjor shoqëria për të përfshirë në bilancin e vitit 2014 kthimin e shumës 51.000 euro z. Tritan Hamitaj, referoni bazën ligjore.

26.2. Drejtorja Rajonale Tatimore Durrës, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.03.2020, informon se tatimpaguesi “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*}, është në status pasiv nga data 29.09.2014. Në sistemin tatimor c@ts, nuk ka të ngarkuara pasqyra financiare për vitin 2014

e, për rrjedhojë, është penalizuar me gjobë. Ndërsa, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.04.2020, informon se të gjithë tatimpaguesit me përgjegjësi tatimore tatim-fitim, bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në nenin 29 “deklarim tatimor dhe llogaritje përfundimtare e detyrimit”, kanë detyrim ligjor të dorëzojnë pranë organit tatimor bilancin e vitit ushtrimor brenda datës 31 mars të vitit pasardhës. Subjektet kanë detyrimin që të gjitha veprimet kontabël që kryhen në vitin ushtrimor t’i përfshijnë në bilancin vjetor, por në mënyrë analitike këto lloj veprimesh disponohen nga vetë subjekti në regjistrat e tij kontabël. Referuar bilanceve të viteve 2006-2012, vënë në dispozicion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, nga verifikimi i postit të “Pasivit” të bilancit [“Detyrime dhe Kapitali”], sipas periudhave, rezultojnë të jenë regjistruar detyrime të shoqërisë ndaj palëve të treta si vijon: për vitin 2006, “të tjera detyrime”, 38.630.000 lekë; për vitin 2007, “të tjera detyrime”, 30.668.000 lekë; për vitin 2008, “hua të tjera”, 2.772.521 lekë; për vitin 2009, “hua të tjera”, “0 lekë”; si dhe “parapagime të arkëtuara”, 64.578.662 lekë.

**26.3.** Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit pretendon se barra e provës për të është zgjeruar tej parashikimeve kushtetuese, neni A, neni Ç, pika 4, fjalia e fundit dhe 5 dhe neni D, pikat 3 dhe 4 e Aneksit të Kushtetutës. Nga ky parashikim rezultojnë se barra e provës është e kufizuar vetëm nëse do të arrihej në përfundimin se pasuria e subjektit do të ishte poshtë dyfishit të pasurisë së ligjshme. Mosadministrimi i dokumenteve që ndodhen te të tretët nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit, pasi ai pretendon të ketë bërë të gjitha përpjekjet për t’i siguruar ato, por nuk ka arritur për rrethana që nuk varen prej tij. *Së pari*, shoqëria nuk disponon dokumente për shkak të afatit ligjor 5 (pesë) vjet për ruajtjen e tyre, bazuar në nenin 48 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në këto kushte, sipas tij, duhet të zbatohet neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. *Së dyti*, subjekti pretendon se ka bërë përpjekje për të siguruar dokumentacion pranë QKB-së dhe ka kontaktuar me administratorin e shoqërisë, por nuk ka arritur të sigurojë dokumentacion. *Së treti*, nga kontakti me ish-ortakët e shoqërisë A. dhe B. Dh. ka mundur të sigurojë lëvizje të llogarive bankare dhe disa kontrata sipërmarrje dhe shitje të realizuara në vitet 2006-2019, me të cilat provohet se shoqëria të dhënat në bilanc nuk i ka të sakta, dhe se ka krijuar të ardhura me të cilat ka pasur mundësi financiare të shlyejë detyrimin ndaj subjektit në vitet 2009, 2011 dhe 2014. Nga kontratat rezultojnë se “{\*\*\*}” ShPK për vitin 2013 ka arkëtuar shumat 465.000 euro dhe 4.700.000 lekë. Në këtë vit, nuk ka kryer aktivitet dhe, si rrjedhim, nuk ka kryer shpenzime. Bilanci i vitit 2013 e ka gjendjen zero, ndërkohë që ka kryer së paku 9 (nëntë) kontrata, të cilat duhet të ishin pasqyruar në bilancin e dorëzuar në Drejtorinë e Tatimeve, por që nuk pasqyrojnë një mori ngjarjesh ekonomike. Duke marrë për bazë këto kontrata, bilancet janë me përmbajtje të falsifikuar dhe në bazë të nenit 273 të Kodit Procedurës Civile, subjekti pretendon se ka provuar që të tilla janë edhe bilancet e viteve 2006-2012. Në lidhje me barrën e provës për personin tjetër të lidhur, ligji nr. 84/2016, neni 32, pika 4 e tij është një parashikim ligjor tej Kushtetutës dhe i paautorizuar prej saj. Një gjë e tillë gjen vend dhe në vendimin nr. 3/2006, të Gjykatës Kushtetuese, [...] *Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet duke i dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës [...].* Në kushtet kur Kushtetuta nuk ka autorizuar vendosjen e barrës së provës për krijimin e të ardhurave nga huamarrësi, Komisioni ka detyrimin ligjor të zbatojë drejtpërdrejtë Kushtetutën, në zbatim edhe të interpretimit të bërë nga Gjykata Kushtetuese, duke mos i dhënë përparësi ligjit nr. 84/2016.

**26.4.** Me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti ka depozituar kontrata sipërmarrje e kontrata shitblerje të nënshkruara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK me individë të ndryshëm, në cilësinë e porositësit ose blerësit, nëpërmjet të cilave ka arkëtuar shumën monetare të konsiderueshme, konkretisht: në vitin 2007 shumën 50.000 euro; në vitin 2008 shumën 507.920 euro dhe 10.466.000 lekë; në vitin 2009 shumën 442.161 euro; në vitin 2010 shumën 68.000

euro; në vitin 2011 shumën 193.696 euro; në vitin 2012 shumën 12.000 euro; në vitin 2013 shumat 465.600 euro dhe 1.700.000 lekë; -- në vitin 2014. Subjekti pretendon se veprimet juridike të kryera nga kjo shoqëri nuk janë reflektuar në bilancet e shoqërisë, të tilla si kontrata huaje me huadhënës E. S. në vitin 2010, kredia bankare disbursuar nga NBG ShA, në vlerën 120.000 euro, në vitin 2007, shlyerja e saj në vitet 2008 dhe 2009. Bilancet e shoqërisë, në vlerësim të subjektit kanë përmbajtje të rreme dhe nuk kanë vlerën e provës, në zbatim të nenit 273 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe nuk mund të përdoren si provë për të kundërshtuar kontratat e huas. Nëse shoqëria “{\*\*\*}”, sipas subjektit, do të ishte kontrolluar nga organi tatimor do të ishte penalizuar dhe këto bilance do të ishin ndryshuar, sipas ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i shfuqizuar.

**26.5.** Po kështu, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dhe lëvizje të llogarive të ortakëve të shoqërisë B. Dh. dhe A. Dh., në “ProCredit Bank” ShA, nga ku rezulton se nëpërmjet këtyre llogarive janë kryer pagesa për llogari të aktivitetit të “{\*\*\*}” ShPK dhe arkëtime nga klient për zbatim kontrata sipërmarrje. Sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, këto llogari nuk mund të pasqyrohen në bilanc, pasi llogaritë personale nuk merren si dokumente për plotësimin e bilancit. Edhe për veprimet e pagesave dhe arkëtimeve të pasqyruara në këto llogari bankare të ortakëve, bilancet janë të pasaktë, pasi nuk janë pasqyruar si ngjarje ekonomike. Këto bilance me këtë nivel pasaktësie, sipas subjektit, nuk mund të marrin vlerën e provës në këtë proces dhe në asnjë mënyrë vlerë të paracaktuar në krahasim me kontratat e huas. Kontratat e huave, sipas subjektit, vijnë në harmoni me deklaratat periodike dhe nuk vijnë në kundërshtim me asnjë dokument tjetër të marrë si provë në këtë proces dhe duhet të vlerësojë se janë dokumente të ligjshme dhe të vlefshme për atë që pasqyrojnë në përmbajtje.

**26.6.** Për të provuar pasaktësitë e bilanceve, subjekti i rivlerësimit ka depozituar me prapësimet dhe “Opinion vlerësimi kontabël” të kontabilistit të miratuar<sup>42</sup>, sipas së cilit pasqyrat financiare të shoqërisë për vitet 2006-2013 kanë karakter deklarativ, pasi referuar shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës shoqëria nuk është kontrolluar asnjëherë dhe pasqyrat financiare nuk janë certifikuar. Sipas kontabilistit të miratuar, shumë veprime kontabël nuk janë pasqyruar ose janë pasqyruar në mënyrë të pasaktë në bilancin e shoqërisë “{\*\*\*}”, fakt ky që ndikon bindshëm në besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe rezultatet e shprehura në to.

**26.7.** Në përgjigje të shkaqeve ankimore të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues arsyeton se neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 e ngarkon subjektin e rivlerësimit dhe personin tjetër të lidhur, që në kuadër të marrëdhënies së huas së konfirmuar, të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë hua dhe kthimit të saj nga huamarrësi. Ky nen nuk është në kundërshtim me Kushtetutën dhe është trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, duke mbajtur në konsideratë edhe kufijtë proporcional të kontrollit pasuror për personat e tjerë të lidhur dhe raportin përpjesëtimor që duhet të ketë ky kontroll me barrën e provës të subjektit të rivlerësimit, në justifikimin e pasurisë objekt huaje. Në rastin konkret, Komisioni me të drejtë ka kërkuar informacion, si pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, ashtu edhe pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës. Në këto kushte, pretendimi se Komisioni<sup>43</sup> kishte detyrimin të merrte provat e ndodhura pranë “{\*\*\*}” ShPK rezulton i plotësuar pavarësisht se kërkesat nuk mbërritën në destinacion. Nga ana tjetër, kërkesa e subjektit se Komisioni duhet të thërriste si dëshmitar administratorin dhe ortakët dhe të merrte dokumente të ndodhura në AShK, noter, banka etj., në vlerësim të trupit gjykues rezulton e pabazuar, pasi barrën e provës në këtë proces e ka subjekti i rivlerësimit dhe, nga ana tjetër, Drejtoria Rajonale Tatimore është institucioni

<sup>42</sup> Kontabilist i miratuar E. K., anëtar i IKM-së, me numër licence {\*\*\*}, datë 25.10.2011 dhe NIPT {\*\*\*}.

<sup>43</sup> Komisioni i ka dy herë “Kërkesë për informacion, shoqëruar me dokument” shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, por në të dyja rastet shkresat e dërguara janë kthyer me shënimin “i panjohur” apo “adresë e pasaktë”.

përgjegjës që disponon informacion dhe dokumentacion, si për bilancet e shoqërisë, fitimin e realizuar, tatimin e paguar, shpërndarjen e dividendit, me pak fjalë situatën financiare të shoqërisë dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore që prej fillimit të aktivitetit të saj.

Trupi gjykues thekson se në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me burimeve të ligjshme dhënien e huave, analizimi i mundësisë financiare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, është bërë në kuadër të mosbesueshmërisë së legjitimitetit të burimeve financiare të dhëna hua, dyshim që përforcohet edhe më tepër nga analizimi në vijim i mundësisë së shoqërisë në kthimin e huave dhe interesave të dhëna.

**26.8.** Nga analizimi i bilanceve për periudhën 2006-2011, të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, pasqyrohen detyrimet e shoqërisë në total ndaj palëve të treta, pa specifikuar analitikisht ndaj kujt kreditor për secilin vit ushtrimor. Në këto kushte, nuk mund të evidentohen konkretisht as detyrimet dhe as interesat e shlyera ndaj subjektit të rivlerësimit. Nga leximi i pasqyrave financiare rezulton që shoqëria: fitimin e vitit 2006 në shumën 1.504.316 nuk e ka shpërndarë, por e ka mbartur në vitin pasardhës; fitimin e vitit 2007 në shumën 6.029.704 lekë e ka kaluar në rezervë statutores; për vitin 2008, shoqëria ka rezultuar me humbje në vlerën 4.585.308 lekë; për vitin 2009, rezultati financiar ka qenë humbje në vlerën 6.485.727 lekë; për vitin 2010, aktiviteti i shoqërisë ka rezultuar me humbje në vlerën 2.203.384 lekë; si dhe në vitin 2011, me humbje në vlerën 6.902.201 lekë. Nga sa sipër, trupi gjykues konstaton se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK nuk ka pasur situatë të shëndoshë financiare.

**26.9.** Të ardhurat, sipas kontratave të sipërmarrjes/shitblerjeve dhe lëvizjet e shumave monetare në llogaritë bankare të ortakëve të shoqërisë, nuk provojnë që destinacioni i përdorimit të tyre ka qenë shlyerja e huave ndaj subjektit të rivlerësimit dhe interesave që buronin prej tyre, në kushtet kur nuk disponohet asnjë dokument i vetëm, që të provojë këtë pretendim. Nga ana tjetër, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka kryer likuidimin e detyrimeve ndaj shtetasit B. R. më 07.01.2011, nëpërmjet llogarisë rrjedhëse bankare, ndërkohë që mbetet i paarsyetuar fakti përse nuk vepron në të njëjtën mënyrë edhe për likuidimin e detyrimeve ndaj subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit Tritan Hamitaj, në zbatim të nenit 3, germa “d” të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, ka qenë subjekt deklarues në ILDKPKI prej vitit 2003 dhe për efekt transparence e provueshmërie, duhet të kishte operuar nëpërmjet sistemit bankar, si për dhënien e huave, ashtu edhe për marrjen pas të kapitalit të investuar e kthimet në investim, interesat e paguara për shumat e marra hua në vitet 2006-janar 2011, me qëllim dokumentimin e transaksioneve e gjurmimin e tyre. Me këtë mënyrë të operuari, subjekti i rivlerësimit duket se ka rënë në dakordësi me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, për të kryer transaksione me para në dorë, ndërkohë që është mëse e qartë se shoqëria ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin tatimor <sup>44</sup> të kohës.

**26.10.** Subjekti në ankim pretendon se: (i) Komisioni në vendim në mënyrë përgjithshme shprehet se subjekti i rivlerësimit ka shkelur detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligji për parandalimin e pastrimit të parave, por nuk përcakton veprimet apo mosveprimet në kundërshtim me dispozitën ligjore konkrete të shkelur nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni duhet t’i bënte me dije subjektit këtë mangësi apo situatë që mund ta çonte drejt prezumimit të masës disiplinore të shkarkimit apo ndonjë mase tjetër, në mënyrë që t’i jepte mundësinë të ushtronte të drejtën për të provuar të kundërtën, për t’u mbrojtur efektivisht e për t’u dëgjuar në kuadër të procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 6, pika 1 e KEDNj-së. Në jurisprudencën e Kolegjit nuk është konstatuar shkelje marrja e huas në vlerën rreth 20.000 euro *cash* nga subjekti i rivlerësimit; (ii) Komisioni nuk ka asnjë provë apo indicie se vullneti i subjektit të

<sup>44</sup> Ligji nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 36/1 dhe ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 120.



rivlerësimit përputhet me atë të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Përpjekjet e subjektit kanë hasur neglizhencë e papajtueshmëri me shoqërinë, mungesa e vullnetit të së cilës e detyroi të kryejë veprime jo në rrugë bankare, por nuk e ngarkon me përgjegjësi për zbatimin nga shoqëria të legjislacionit tatimor. Detyrimi ligjor, për kalimin e shumave nëpërmjet bankës, ka lindur në vitin 2009 dhe përfshin vetëm dhënien e kthimin e huave për vitin 2009 e 2010, por ligji nuk detyron subjektin të bëjë veprime me bankë. Nëpërmjet deklarimit të huas në deklaratat periodike vjetore pranë ILDKPKI-së, subjekti ka përmbushur të vetmin detyrim ligjor që ka pasur në ngarkim të tij.

**26.11.** Në respektim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, konkretisht neni 10, pika 5 e tij parashikon se të gjitha transaksionet dhe ngjarjet trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare. Ashtu siç pretendon dhe subjekti i rivlerësimit nëpërmjet kontabilistit të miratuar, pasqyrat financiare të shoqërisë për periudhën 2006-2013 kanë karakter deklarativ, për vitet 2013 dhe 2014 nuk ka bilance të dorëzuara nga tatimpaguesi, i cili nga data 29.09.2014 rezulton me status pasiv, shoqëria nuk është kontrolluar asnjëherë dhe pasqyrat financiare nuk janë certifikuar. Sipas kontabilistit të miratuar, shumë veprime kontabël nuk janë pasqyruar ose janë pasqyruar në mënyrë të pasaktë në bilancin e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, fakt ky që ndikon bindshëm në besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe rezultatet e shprehura në to. Gjithashtu, vetë subjekti pretendon se përmbajtja e bilanceve të shoqërisë është e rreme e këto bilance nuk kanë vlerën e provës, duke pretenduar se nëpërmjet kontratave të huas, sipërmarrjes, shitjeve, zgjidhjes së kontratës, të depozituara si provë, ka provuar falsitetin e bilanceve, në zbatim të nenit 273 të Kodit të Procedurës Civile. Mbi këto rrethana, mbështetur në legjislacionin e sipërcituar, trupi gjykues çmon se edhe shumat e kthyer të huas dhe interesat e paguara për to afektohen nga paligjshmëria.

**26.12.** Nga ana tjetër, lidhur me konstatimin e Komisionit se subjekti dhe shoqëria duket sikur kanë vepruar në kundërshtim me legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave, pasi nuk i kanë kryer nëpërmjet sistemit bankar, konstatim i kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues, me konsideratë faktin se kontrata e huas apo e sipërmarrjes mund të lidhen edhe pa praninë e noterit dhe subjekti i ka deklaruar në deklaratat e interesave privatë periodike në kuptim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, vlerëson se ky fakt nuk e përjashton subjektin, si gjyqtar e njohës i ligjit, nga detyrimi për të kërkuar që këto shuma monetare të qarkullojnë, sipas kërkesave të ligjit nr. 8610, datë 17.05.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, i ndryshuar dhe, më pas, të ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, për të përjashtuar çdo element dyshimi që këto shuma rrjedhin nga veprimtari kriminale të pastrimit të parave. Fakti që këto shuma janë qarkulluar *cash*, të padeklaruara nga shoqëria në bilancet financiare e bëjnë të cenueshme ligjshmërinë e tyre. Nga ana tjetër, aktiviteti i dhënies së huave në shuma të konsiderueshme, për periudha gjashtëmujore dhe njëvjeçare të përsëritura, të rinovuara në hark kohor prej 5 (pesë) vitesh, me një normë interesi 10 %, trupi gjykues e konsideron në papajtueshmëri me funksionin e gjyqtarit, i cili nuk mund të ushtrojë veprimtari financiare me qëllim fitimi e të paregjistruar.

**26.13.** Në vijim të sa arsyetuar më sipër, në linjë me Komisionin, duke konstatuar paraprakisht se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për dhënien e huave, fakti që këto hua janë dhënë dhe kthyer *cash*, jashtë sistemit bankar, duke shmangur filtrimin e ligjshmërisë së burimit të tyre nga subjektet e përcaktuara me ligj dhe autoriteti përgjegjës, si dhe pamundësia financiare e shoqërisë për kthimin e huave dhe interesave, çojnë trupin gjykues në konkluzionin që të ardhurat nga interesat e huave nuk mund të konsiderohen të ligjshme dhe nuk janë përfshirë në analizën financiare të kryer në Kolegj.

Me këtë arsyetim, kthimi i shumës 51.000 euro nga “Zgjidhje kontrate me mirëkuptim datë 10.01.2014”, e kthyer *cash*, nuk mund të konsiderohet e ardhur e ligjshme.

26.14. Në përfundim, për pasurinë apartament me sipërfaqe 78,24 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Durrës, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e apartamentit më 05.03.2014, në vlerën (-) 6.656.262 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

*Për pasurinë, apartamenti me sipërfaqe 103,82 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Tiranë*

27. Komisioni, për këtë pasuri, ka arritur në përfundimin se: (i) subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e apartamentit në shumën 2.236.145 lekë; (ii) subjekti nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë burimin e ligjshëm të të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b”, të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
28. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, duke paraqitur këto shkaqe ankimore: (i) Komisioni duhet t’i kishte vlerësuar dokumentet në harmoni dhe në raport me njëra-tjetrën dhe me kohën e krijimit të tyre. Veprimet juridike me pasurinë e përbashkët të bashkëshortes me nënën dhe motrën e saj kryer në vitin 2007 janë: dhurimi i apartamentit në Durrës, mbyllur llogaria e bonove të thesarit, si dhe kalimi i shumës 6.000.000 lekë të ndodhur në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, nga R. te M., njëkohësisht deklaruar në deklaratën e interesave privatë 2007; (ii) shuma 900.000 lekë e ka burimin nga kalimi i shumës 6.000.000 lekë nga R. te M. dhe përfitimi i një pasurie apartament me vlerë më të vogël. Kjo vlerë është përfituar nga marrëveshja e pjesëtimit. Subjekti i kërkon përfshirjen e kësaj shume si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2014; (iii) në analizën financiare, subjekti kërkon të përfshihen si të ardhura: shuma prej 3.000 eurosh e përfituar nga “{\*\*\*}” ShPK në datën 10.01.2014; si dhe shuma prej 150.000 lekë e përfituar nga të ardhurat e tokës bujqësore, ullinjve, vreshtit e deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2014, në të kundërt të mos llogariten shpenzimet e jetesës; (iv) llogaritja e shpenzimeve të djalit nga kontrata e donacionit është rrjedhojë e mozbatimit të ligjit, kalimit të barrës së provës në kundërshtim me ligjin, parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit në vlerësimin e provave. Natyra e veçantë e këtyre shpenzimeve e bën të vështirë dokumentimin e tyre. Jo e gjithë shuma e donacionit është shpenzuar për djalin, një pjesë janë bashkë me shpenzimet familjare. Për disa shpenzime nuk janë ruajtur kuponët tatimor, pasi shuma për çdo zë të veçantë nuk e kalonte vlerën 300.000 lekë, që do të detyronte deklaramin dhe dokumentimin e tyre. I vetmi shpenzim që ka pasur mundësi të dokumentojë është blerja e autoveturës në vitin 2015; (v) kontrata e donacionit nuk është vlerësuar në mënyrën e duhur, pasi donacioni mund të jepej edhe pa paraqitur dokumentacion për shpenzimet, pasi shoqëria “{\*\*\*}” ShPK në financim ka vepruar në bazë të bindjes së krijuar dhe nuk ka kërkuar dokumentacion; si dhe (vi) donacioni nuk është bërë si rrjedhojë e shpenzimit dhe as të barazohet me të. Komisioni ka pasur tendencë njëanshmërie dhe pa asnjë provë e ka shpërndarë shpenzimin në mënyrë të barabartë çdo muaj, me arsyetimin se nuk provohet pagesa e kryer në kohën e marrjes së shërbimit apo blerjes. Subjekti kërkon heqjen nga analiza financiare e shpenzimeve të djalit si pasojë e kontratës së donacionit. Trupi gjykues, në analizë të këtyre shkaqeve ankimore, konstaton, si vijon.
- 28.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Apartament me nr. {\*\*\*} pasurie, zona kadastrale {\*\*\*}, Tiranë, me sipërfaqe 103,82 m<sup>2</sup> dhe ambiente të përbashkëta 13,8 m<sup>2</sup>. Blerës R. H. dhe Tritan Hamitaj. Vlera e blerjes: 134.435 euro. Koha e përfitimit të pronës, datë 13.8.2014. Burimi: 50.000 euro kredi tek “Alpha Bank”, 5.028 euro*

mbyllur depozita në “Credins Bank”, 3.000 euro të mbetura nga penaliteti i zgjidhjes së kontratës me “{\*\*\*}” ShPK, 1.100.000 lekë kthim huaje nga G. H. (dhënë pas mbylljes së llogarisë në “ProCredit Bank” dhe “Tirana Bank” dhe të ardhura të akumuluar deri në momentin e dhënies së huas), 900.000 lekë kthim huaje nga M. G. (dhënë pas mbylljes së llogarive bankare), të ardhura të vitit të blerjes dhe gjendje në llogari. Marrë hua A. H. 2.800 euro. Përfitur pjesa e M. G. me shkëmbim apartamenti të ndodhur në L.{\*\*\*}, rr.”{\*\*\*}”, pallati nr. {\*\*\*}, Durrës. Pasuria me nr.{\*\*\*}, {\*\*\*} me sip. 75,58 m<sup>2</sup>. Pjesa takuese: 33.3% Tritan Hamitaj dhe 66.6% R. H.. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 14.10.2019, konfirmon regjistrimin e kësaj pasurie në bashkëpronësi të Tritan dhe R. Hamitaj.

**28.2.** Fillimisht, ky apartament është përfitur me kontratë shitblerje pasurie e paluajtshme (apartament) nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 13.08.2014, me shitës A. G. dhe blerës M. G. dhe R. H., në vlerën 134.435 euro, parashikuar të shlyhet totalisht në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate nga blerësi në llogarinë e shitësit. Referuar deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., të datës 20.08.2014, tri deklaruesit R. H., M. G. dhe Tritan Hamitaj deklarojnë kontributin monetar për blerjen e këtij apartamenti në vlerën 134.435 euro: 50.000 euro janë dhënë nga M. G. (37.1 % në bashkëpronësi); dhe 84.435 euro janë dhënë nga R. H. si pasuri e ardhur gjatë martesës me Tritan Hamitaj që përfaqësojnë 62.9 % të pjesës së tyre në bashkëpronësi, prej të cilave 50.000 euro janë paguar nga kredi e financuar nga “Alpha Bank” ShA.

**28.3.** Referuar lëvizjeve të llogarisë bankare përcjellë Komisionit nga “Alpha Bank” ShA, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 19.09.2019, nga llogaria në euro në emër të A. G., Tritan Hamitaj, M. G. dhe R. H., rezulton të jenë kryer këto veprime bankare: më datë 13.08.2014, derdhje cash nga Tritan Hamitaj në shumën 24.435 euro, transferuar në këtë datë me përshkrimin *Tritan Hamitaj për A. G. likuidim blerje apartamenti [...]*; më datë 14.08.2014, derdhje cash nga Tritan Hamitaj e shumës 10.000 euro, transferuar në këtë ditë me përshkrimin *Tritan Hamitaj për A. G. likuidim blerje apartamenti [...]*; më datë 19.08.2014, transferohet shuma 50.000 euro Tritan Hamitaj për A. G. likuidim përfundimtar blerje apartamenti, datë në të cilën është disbursuar kredia<sup>45</sup> nga “Alpha Bank” ShA. Nga analizimi i lëvizjeve të kësaj llogarie, rezulton që këstet e kredisë të jenë shlyer vetëm nga subjekti i rivlerësimit Tritan Hamitaj.

**28.4.** Nëpërmjet kontratë shkëmbimi nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.11.2016, nënshkruar mes M. G. dhe R. H., përcaktohet se M. G. ka në bashkëpronësi me R. H. dhe Tritan Hamitaj, apartamentin me sipërfaqe 103,82 m<sup>2</sup>, të ndodhur në zonën kadastrale nr. {\*\*\*}, Tiranë. Ndërsa R. H. është pronare e vetme e apartamentit me sipërfaqe 78,58 m<sup>2</sup>, ndodhur në zonën kadastrale nr. {\*\*\*}, Durrës. Palët bien dakord që M. G., pjesën takuese të saj në apartamentin me sipërfaqe 103,82 m<sup>2</sup>, Tiranë, ta shkëmbejë me apartamentin me sipërfaqe 78,58 m<sup>2</sup>, në Durrës<sup>46</sup>, duke hequr dorë respektivisht nga pjesa e shkëmbyer. Në këtë kontratë jep pëlqimin dhe “Alpha Bank” ShA<sup>47</sup>, me kushtin që kjo pasuri të qëndrojë e bllokuar deri në shlyerjen totale të detyrimeve të huamarrësve Tritan Hamitaj, R. H. dhe M. G.

**28.5.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, për të përfshirë si burim të krijimit të

<sup>45</sup> Kontratë huaje [nr. {\*\*\*}, datë 14.08.2014], me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.08.2014, mes “Alpha Bank” ShA, dega Durrës, në cilësinë e huadhënësit dhe Tritan Hamitaj, R. H. dhe M. G., në cilësinë e huamarrësit, A. G. në cilësinë e dorëzanësit, për shumën 50.000 euro, me qëllimin e vetëm për të financuar blerjen e një pasurie të paluajtshme që është apartament, i ndodhur në Durrës (ndërkohë që apartamenti është në Tiranë).

<sup>46</sup> Apartamenti, me sipërfaqe 78,58 m<sup>2</sup>, i shkëmbyer, është fituar më herët nga R. H., nëpërmjet kontratë dhurimi nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 09.11.2007, me palë dhuruese L. H. dhe M. G. (H.)

<sup>47</sup> Nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.11.2016.

kësaj pasurie edhe shumë 900.000 lekë të kthyer nga M. G., në vijim të arsyetimit në paragrafin 25.5.16 të këtij vendimi, duke e konsideruar këtë shumë hua dhënë nga R. H. te M. G. në vitin 2007, për të cilën u konstatua mungesë financiare, Kolegji, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, verifikoi mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, M. G., për kthimin e shumës në vitin 2014, nga ku rezultoi pamjaftueshmëri e burimeve të saj të ligjshme për kthimin e kësaj shume, trajtuar në paragrafin 29.10 të këtij vendimi. Në këto kushte, në analizën financiare të kryer në Kolegji, nuk u përlllogarit në të hyra/e ardhur, shuma prej 900.000 lekësh, hua e kthyer.

**28.6.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se llogaritja përpjesëtimore për 12 muaj e shpenzimeve në vlerën 550.000 lekë në lidhje me djalin, në analizën financiare për periudhën 01.01.2014-13.08.2014, kur është blerë ky apartament, është rrjedhojë e moszbatimit të ligjit, kalimit të barrës së provës në kundërshtim me ligjin dhe provat. Këto shpenzime, sipas subjektit, janë të llojeve të ndryshme e të një natyre të vështirë për t'u dokumentuar dhe jo e gjithë shuma e donacionit është shpenzuar për djalin. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton se donacioni është deklaruar në rubrikën “të dhëna konfidenciale” të deklaratave të interesave privatë periodikë dhe atë *vetting*, si vijon:

- Në deklaratën e interesave privatë 2014, të ardhura nga kontrata e donacionit, përfitues Tritan Hamitaj, donator “{\*\*\*}” ShPK, shuma 1.200.000 lekë. Kontratë donacioni, datë 14.01.2014, shkresë e thjeshtë.
- Në deklaratën e interesave privatë 2015, të ardhura nga kontrata e donacionit, përfitues Tritan Hamitaj, donator “{\*\*\*}” ShPK, shuma 1.200.000 lekë. Kontratë donacioni, datë 14.01.2014, shkresë e thjeshtë.
- Në deklaratën e interesave privatë 2016, të ardhura nga donatori “{\*\*\*}” ShPK, përfitues Tritan Hamitaj, shuma 600.000 lekë.
- Në deklaratën e interesave privatë 2017, të ardhura nga donatori “{\*\*\*}” ShPK, përfitues Tritan Hamitaj, shuma 600.000 lekë.
- Në deklaratën e pasurisë *vetting*, të ardhura nga donatori “{\*\*\*}” ShPK, përfitues Tritan Hamitaj, dokumente: kontratë e datës 14.01.2014, shkresë e thjeshtë, në vlerën 3.000.000 lekë.

**28.6.1.** Me deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit depoziton “Kontratë donacioni”, datë 14.01.2014, nënshkruar mes administratorit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, F. Xh. dhe subjektit të rivlerësimit Tritan Hamitaj, sipas së cilës donatori merr përsipër të paguajë të gjitha shpenzimet për rehabilitimin e djalit të subjektit të rivlerësimit, por jo më shumë se 1.200.000 lekë në vit. Këto shpenzime, donatori merr përsipër t'i paguajë çdo gjashtë muaj me paraqitjen e dokumentacionit për shpenzimin e kryer apo sipas bindjes së tij.

**28.6.2.** Pas kërkesës së Komisionit, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, nëpërmjet shkresës<sup>48</sup>, me lëndë “Informacion për donacion për fëmijën e z. Tritan Hamitaj”, bën me dije se, z. Hamitaj ka dashur ta formalizojë këtë donacion me kontratë, por ortaku i shoqërisë, z. S. M., nuk ka qenë dakord e, për këtë shkak, nuk ka ruajtur dokumentacion.

Bashkëlidhur shkresës, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka dërguar dokumentacionin kontabël ku pasqyrohet deklarimi i shumave të transferuara në favor të subjektit Tritan Hamitaj dhe shoqatës “{\*\*\*}”. Dokumentacioni konsiston në:

(i) nxjerrjen e llogarisë bankare të shoqërisë në “Alpha Bank” ShA, në të cilën evidentohet derdhja e shumës 1.200.000 lekë në llogari nga administratori i saj, më datë 29.12.2014 dhe, në të njëjtën datë, transferimi në llogarinë e subjektit me përshkrimin “{\*\*\*} ShPK kalim për Tritan Hamitaj donacion [...]”;

<sup>48</sup> Administruar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. {\*\*\*} prot., datë 18.06.2020.

(ii) fletë nga pasqyra financiare e vitit 2014 “Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve 2014”, ku në rreshtin 7, “Shpenzime të tjera” është shtuar me shkrim dore “ + *donacione*”;

(iii) nxjerrje llogarie bankare e shoqërisë pranë “Alpha Bank” ShA, në të cilën evidentohet derdhja e shumës 600.000 lekë nga administratori më datë 25.11.2015, si dhe transferimi në të njëjtën datë në llogarinë e subjektit, me përshkrimin “Nga {\*\*\*} ShPK për Tritan Hamitaj *donacion* [...]”;

(iv) transferim nga llogaria bankare e shoqërisë në “Alpha Bank” ShA, më datë 05.10.2016, me përshkrimin “Nga {\*\*\*} ShPK për Tritan Hamitaj *donacion* [...]”;

(v) me të njëjtën mënyrë e përshkrim të veprimit bankar, më datë 28.03.2017, transferohet shuma 600.000 lekë dhe më 28.05.2018, shuma 500.000 lekë; si dhe

(vi) një transferim i vlerës 5.065 euro nga llogaria e shoqërisë në “Raiffeisen Bank” ShA, më datë 20.02.2017, në favor të “{\*\*\*}”.

**28.6.3.** Subjekti në ankim parashtron se kontrata e donacionit nuk është vlerësuar në mënyrën e duhur, pasi, sipas saj, donacioni mund të jepet edhe pa paraqitur dokumentacion për shpenzimet. Shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka zbatuar bindjen e saj në financim pa e lidhur financimin me shumën e shpenzimeve të kryera nga subjekti për djalin. Kontrata është lidhur më tepër nga insistimi i subjektit për të dokumentuar financimin.

**28.6.4.** Lidhur me mungesën e dokumentacionit për të provuar shpenzimet e kryera, në kushtet kur donacioni i përfutur për herë të parë në vitin 2014 ka qenë në një vlerë të konsiderueshme, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit për të mos ruajtur dokumentacionin provues të këtyre shpenzimeve. Për më tepër, nisur nga vetë përmbajtja e kontratës, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK mund të kërkonte këtë lloj dokumentacioni në çdo kohë.

**28.6.5.** Sa i takon pretendimit të subjektit se mund të provonte me dokument vetëm shpenzimin për blerjen e automjetit “Mercedes-Benz” në vitin 2015, për t’i shërbyer nevojave të djalit e që duhet të llogaritet si e blerë nga donacioni i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në vitin 2015, trupi gjykues konstaton se automjeti është blerë me kontratë shitblerje automjeti nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 09.06.2015, me palë shitëse shtetasin A. Dh. dhe blerës Tritan Hamitaj, në vlerën 600.000 lekë, deklaruar në deklaratën e interesave privatë 2015, me burim të ardhurat e donatorit “{\*\*\*}” ShPK dhe në deklaratën e pasurisë *vetting* me të ardhurat e vitit. Ky automjet rezulton që me kontratë huapërdorje<sup>49</sup> automjeti nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 01.07.2015, t’i jetë dhënë në përdorim pashpërbllim shtetasit R. M., për një periudhë pa afat.

**28.6.6.** Nisur nga fakti që në kushtet e kontratës është përcaktuar qartë destinacioni i shumave të dhuruara, nga trupi gjykues i Kolegjit, në linjë me Komisionin, mbulimi i shpenzimeve rehabilituese për djalin e subjektit të rivlerësimit nga vlera e donacionit u përlllogarit i barabartë me shpenzimet e posaçme të djalit të subjektit A. H. dhe jo për destinacione të tjera, kjo sa i përket analizës vjetore 2014, 2015 dhe 2016, me efekt zero në këtë analizë. Ndërsa sa i përket analizës së fragmentuar deri në datën e krijimit të një pasurie, si në rastin e blerjes së apartamentit me sipërfaqe 78,24 m<sup>2</sup> më 05.03.2014, të blerjes së apartamentit me sipërfaqe 103,82 m<sup>2</sup> më datë 13.08.2014, në kushtet kur kontrata e donacionit është nënshkruar më 24.01.2014, ndërkohë që financimi i shumës së dhuruar prej 1.200.000 lekësh është bërë më 29.12.2014, me të drejtë, Komisioni bën ndarje proporcionale të këtyre shpenzimeve të posaçme për periudhën 01.01.2014-13.08.2014. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar këtë mënyrë përlllogaritje, duke e konsideruar tendencë e njëanshmëri, në kushtet e mungesës së dokumentacionit për saktësimin e këtyre shpenzimeve dhe periudhën e saktë të

<sup>49</sup> Përcjell nga notere F. A., me shkresën e datës 06.06.2020, administruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 09.06.2020.

kryerjes së tyre, kjo mënyrë e shpërndarjes së shpenzimeve është e drejtë dhe mbetet e vetmja mënyrë e arsyeshme për shpërndarjen e tyre.

28.7. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, për periudhën 05.03.2014-19.08.2014, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të likuiduar shumën 24.435 euro të çmimit të apartamentit me sipërfaqe 103,82 m<sup>2</sup> më 13.08.2014 dhe shumën 10.000 euro më datë 14.08.2014, si dhe për të justifikuar shpenzimet e tjera të kryera deri më 19.08.2014, në diferencën negative prej (-) 2.212.850 lekësh, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

29. Subjekti i rivlerësimit në ankim ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit për pamundësinë financiare të motrës së bashkëshortes, M. G., për pagesën e shumës 8.368.900 lekë, duke e cilësuar në kundërshtim me ligjin, provat e marra në hetim, parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, pasi: (i) referuar jurisprudencës<sup>50</sup> së Kolegjit, subjekti i rivlerësimit nuk ka detyrim të provojë aftësinë e saj paguese, në kushtet e nenit 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur M. G. nuk është person tjetër i lidhur në këtë proces. Burimi i pronësisë prej 37.1 % së bashkëshortes së subjektit në apartamentin në Tiranë vjen nga apartamenti në pronësi të saj në Durrës dhe hetimi i mëtejshëm për pasurinë e motrës M. G. ka qenë i panevojshëm; (ii) Komisioni nuk ka vlerësuar apo arsyetuar tërheqjen prej saj të shumës 2.000.000 lekë nga llogaria bankare nr. {\*\*\*}, në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, ndonëse provohet me dokument bankar; (iii) Komisioni duhet të kishte përfshirë në të ardhurat e shtetases M. G. të gjitha burimet e deklaruar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, përfshirë të ardhurat e të ndjerës L. H. në shumën 3.500.000 lekë, për pjesën takuese 1/12 nga pjesëtimi i bashkëpronësisë të sipërfaqes truall dhe ndërtesë, në Lushnjë. Kjo shumë duhej të llogaritej si e ardhur e ligjshme në vitin 2003 për krijimin e llogarisë bankare triemërore në vitin 2004, në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA; (iv) dy depozitat në “Intesa Sanpaolo Bank” që kanë shërbyer për krijimin e llogarisë bankare në emër të M. G., nr. {\*\*\*}, në lekë dhe nr. {\*\*\*}, në euro, janë krijuar nga të ardhura të ligjshme dhe Komisioni duhet t’i kishte vlerësuar të ligjshme; (v) Komisioni nuk ka llogaritur të ardhurat e A. G. nga punësimi pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për periudhën 15.10.2007-01.11.2009, shpërblimet në fund të vitit dhe orët jashtë orarit deri në ndërprerjen e marrëdhënies së punës më 03.09.2013, në shumën totale prej 2.015.000 lekësh nga pagat, 180.000 lekë të ardhurat e periudhës 2005-2006 nga punësimi pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, përfshirjen e vlerës së plotë të kontratës së qirasë të apartamentit dhe të pjesës takuese 2/3 të shumës 2.250.000 lekë. Trupi gjykues, në analizë të këtyre pretendimeve, konstaton, si vijon.

29.1. Referuar informacionit të përcjellë nga “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.03.2020, rezulton se më datë 02.07.2007, llogaria bankare nr. {\*\*\*} e M. H. G. kreditohet me shumën 6.000.000 lekë, transferuar nga llogaria e të motrës R. H., në të njëjtën bankë. Më datë 02.07.2009, në këtë llogari, M. H. depoziton *cash* shumën 2.000.000 lekë dhe më datë 28.08.2014, transferon shumën 8.368.900 lekë në favor të A. A. G. me përshkrimin “*Likuidim për blerje apartamenti*”.

29.2. Shuma prej 8.368.900 lekësh konvertuar në 60.000 euro, përfaqëson pjesën takuese prej 50.000 eurosh që duhet të paguhet nga M. G., për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi, si dhe çmimin e sendeve jo të domosdoshme, luksi si televizorë, home cinema, piktura, vazo dekorative, kristaliere etj., që shitësja A. G. vendosi t’ia shiste në vlerën 9.800 euro. Kjo shumë nuk përfshihej në çmimin e apartamentit dhe për formalizimin e saj u nënshkrua “Kontratë shitje e sendeve të luajtshme”, më datë 13.08.2014. Kjo shumë parashikohet të paguhet së bashku me shumën 50.000 euro, si pjesë e çmimit të shitjes së apartamentit në shumën 134.435 euro.

<sup>50</sup> *Shih vendimet nr. 15, datë 17.07.2019 dhe nr. 20, datë 08.09.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.*

**29.3.** Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të M. G. në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, me nr. {\*\*\*} në monedhën lekë, konstatohet transferimi i shumës 6.000.000 lekë në këtë llogari nga R. H.. Nga kjo llogari, M. G. investon në bono thesari shumën 5.556.945 lekë, më datë 05.07.2007 dhe tërheq *cash* shumën 394.249 lekë. Riinveston përsëri në datën 17.07.2008, në letra me vlerë (bono thesari) shumën 5.545.737,79 lekë dhe tërheq pas maturimit, shumën 403.830 lekë. Me maturimin e shumës së investuar për herë të dytë, riinveston përsëri në letra me vlerë shumën 7.321.990,14 lekë dhe me maturimin tërheq shumën 668.000 lekë. Më datë 02.07.2010, depoziton *cash* në arkë shumën 1.066.300 lekë, të cilën e bashkon me shumën e investimit të maturuar dhe e riinveston më datë 28.08.2014, kur shuma bëhet 8.400.000 lekë nga e cila transferon shumën 8.368.900 lekë, në të njëjtën datë, për llogari të shitëses së apartamentit A. A. G., me përshkrimin *pagesë, likuidim për blerje apartamenti*.

**29.4.** Në kushtet kur kjo shumë rrjedh nga shuma 6.000.000 lekë gjendje në llogarinë bankare triemërore, trupi gjykues, me asistencën e Njësisë së Shërbimit Ligjor, analizoi lëvizjet e llogarive bankare të L., M. dhe R. H. në bankat e nivelit të dytë dhe konstaton se në llogarinë bankare të përbashkët L., M. dhe R. H., me nr. {\*\*\*}, në monedhën lekë, më datë 09.06.2004, është depozituar *cash* shuma 6.000.000 lekë. Më datë 03.11.2004 rezulton të jetë tërhequr *cash* nga M. G. shuma 2.000.000 lekë dhe të jetë transferuar më datë 22.06.2006, në llogarinë bankare të R. H. në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, shuma 3.910.000 lekë, të cilën R. H. e ka investuar në blerje letrash me vlerë. Në po këtë llogari bankare të R. H., rezulton të jetë transferuar shuma 2.111.151 lekë nga llogaria bankare e nënës së saj, L. H., me nr. {\*\*\*}, në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, më datë 28.06.2007. Totali i gjendjes së llogarisë bankare të R. H. më datë 28.06.2007 bëhet 6.000.000 lekë, e cila investohet në depozitë dhe pas maturimit, më datë 02.07.2007, transferohet në llogarinë bankare të motrës së saj M. G., në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, me nr. {\*\*\*}, e cila vijon ta investojë në blerje letrash me vlerë. Më datë 02.07.2009, M. H. [G.], derdh *cash* në arkë shumën 2.000.000 lekë dhe më datë 02.07.2010, derdh *cash* në arkë shumën 1.066.300 lekë. Ka vijuar të riinvestojë shumën e akumuluar, e cila bëhet 8.400.000 lekë, deri sa në datën 28.08.2014 e transferon për llogari të shitëses së apartamentit A. A. G., me përshkrimin *pagesë, likuidim për blerje apartamenti*.

**29.5.** Sa i takon burimit të ligjshëm të shumës 2.000.000 lekë të depozituar *cash* më datë 09.08.2006, në llogarinë bankare të L. H., me nr. {\*\*\*}, në monedhën lekë, në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, e investuar disa herë në letra me vlerë, pasuar nga derdhje *cash* në arkë të shumave 500.000 dhe 6.500 lekë më datë 19.03.2007 dhe 20.03.2007 përkatësisht, të shumave 250.000 dhe 50.000 lekë më datë 19.11.2007, derdhur shuma 1.000.000 lekë nga R. H. më datë 26.05.2008 dhe shuma 500.000 lekë më datë 16.06.2008, po nga R. H.. Shuma 2.000.000 lekë rezulton të jetë tërhequr nga L. H. në *cash* nga arka, më datë 24.07.2008. Në këto kushte, nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se burimet e krijimit të shumës 2.000.000 lekë nga 6.000.000 lekë transferuar në llogarinë e M. G. nga R. H. në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, më datë 02.07.2007, janë nga shuma 3.500.000 lekë e përfituar si e ardhur nga L. H. në vitin 2003, pasi, si arsyetuar në paragrafin 25.5.29 të këtij vendimi, të ardhurat e pretenduara nga pjesëtimi i pasurisë në Lushnjë nuk provohen me dokument justifikues ligjor dhe deklaratimet e bashkëpronarëve të tjerë J. T., A. T., E. I., E. S. dhe Gj. T. mbeten në nivel deklarativ, të pa provuara me dokumente ligjor.

**29.6.** Ndërsa provohet fakti që me kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 05.04.2004, L. H. i ka shitur pasurinë e paluajtshme “truall”, me nr. {\*\*\*}, ndodhur në z.k. {\*\*\*}, lagjia “{\*\*\*}”, Lushnjë, me sipërfaqe 1239 m<sup>2</sup>, shtetases Sh. T., në vlerën 4.000.000 lekë, për shumën 2.000.000 lekë, të depozituar në llogarinë e tyre të përbashkët në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA më datë 09.06.2004, analiza financiare tregoi se L. H., M. H. dhe R. H. nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme krijimin e kësaj shume, në vlerën (-) 1.935.644 lekë.

29.7. Pavarësisht se trupi gjykues nuk administroi në cilësinë e provës aktet shkresore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet në Kolegj, efekti i tyre nuk do të ndryshonte situatën financiare të L., M. dhe R. H., sa i takon mundësisë së krijimit të depozitës, pasi edhe nëse në analizë përfshihen të ardhurat sipas: (i) vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 21.09.2022, i Bashkisë Durrës, për shtesë invaliditeti përfituar nga L. H., në shumën 2.200 lekë në muaj, për periudhën shkurt 2004 - shkurt 2015; (ii) vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 20.10.2022, i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Durrës, për të ardhurat e përfituara nga L. H., për ndryshim çmimi të energjisë elektrike për vitet 01.10.1994 - 31.12.2004, në shumën 82.500 lekë, diferenca negative thjesht do të reduktohej në vlerën (-) 1.862.348 lekë.

29.8. Në kushtet kur analiza financiare e kryer tregoi pamundësi financiare nga burime të ligjshme për krijimin e shumës 6.000.000 lekë në llogari bankare të L., R. dhe M. H., trupi gjykues i Kolegjit, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, verifikoi mundësinë financiare të shtetasve M. dhe A. G. për krijimin e shumës 8.368.900 lekë në periudhën 2007-28.08.2014, shumë e transferuar shitëses A. G., si dhe kthimin e huas 900.000 lekë bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

29.9. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në llogaritje të të ardhurave të shtetasit A. G. nga punësimi pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për periudhën 15.10.2007-01.11.2009, shpërblimet në fund të vitit dhe orët jashtë orarit deri në ndërprerjen e marrëdhënies së punës më 03.09.2013, në një shumë totale prej 2.015.000 lekësh pagë dhe 180.000 lekë, të të ardhurave në vitin 2005-2006 nga punësimi pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, përfshirjen edhe të pjesës takuese 2/3 e shumës 2.250.000 lekë nga kontrata e qirasë së apartamentit, trupi gjykues mori në konsideratë të ardhurat nga punësimi i bashkëshortëve M. dhe A. G., sipas dokumentacionit justifikues ligjor të administruar në dosjen gjyqësore e që përmban të dhëna financiare për të ardhurat nga punësimi, për të cilat janë paguar kontributet. Ndërsa të ardhurat nga qiraja e banesës në Tiranë u konsideruan në masën 1/3 e totalit të të ardhurave, ekuivalente me pjesën takuese të shtetasit A. G. në këtë pronë<sup>51</sup>, pasi subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion sa pretendon për këtë të ardhur.

29.10. Bazuar në sa arsyetuar më sipër, rezultatet e analizës financiare treguan bilanc negativ në vlerën (-) 2.172.135 lekë. Ndryshimi në diferencën negative të konstatuar nga Komisioni në vendim në vlerën (-) 1.782.069 lekë me atë në Kolegj, vjen për faktin se në Komision analiza financiare është kryer me bazë vjetore, ndërsa në Kolegj deri në kryerjen e pagesës të pjesës takuese të çmimit të apartamentit më 28.08.2014. Në zbatim të parimit të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të konfirmuar diferencën negative që ka rezultuar nga analiza financiare e kryer në Komision.

29.11. Në përfundim, për pasurinë apartament me sipërfaqe 103,82 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, geramat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

*Për pasurinë, garazh me sipërfaqe 48 m<sup>2</sup>, me dy vendparkime, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Durrës*

30. Komisioni, për këtë pasuri, vlerëson se: (i) subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e 2 (dy) garazheve në shumën 2.808.404 lekë; (ii) subjekti është përpjekur të mos deklarojë në mënyrë të saktë dhe të plotë blerjen e pasurisë garazh nga shtetasi V. Ç..

---

<sup>51</sup> Referuar certifikatës për vërtetim pronësie nr. {\*\*\*}, datë 13.01.2020, apartamenti me sipërfaqe 65 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Tiranë, është i regjistruar në emër të bashkëpronarëve A. G., L. G. dhe M. H., me pjesë takuese 1/3 secili.



Si rrjedhë, subjekti ka kryer deklarin të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b”, të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

31. Subjekti i rivlerësimit në ankim, pretendon se: (i) konkluzioni i Komisionit se subjekti nuk ka depozituar gjatë hetimit administrativ zgjidhjen e kontratës së shitjes me kusht, datë 26.12.2009, është i pavërtetë, pasi subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit të datës 03.04.2020 ka depozituar dokumentin pa asnjë kundërshtim; (ii) mosnënshkrimi i kontratës së dytë në vitin 2011 para noterit nuk e bën atë fiktive. Deklarata noteriale e shtetasit V. Ç. ka vlerë në kushtet kur nga Komisioni është hedhur dyshimi se kontrata e vitit 2011 nuk ka vullnetin e shitësit. Subjekti nuk ka refuzuar të saktësojë situatën për këtë pasuri. Komisioni nuk ka vlerësuar si prova të ligjshme zgjidhjen e kontratës së shitjes me kusht të vitit 26.12.2009, marrjen e huas nga “{\*\*\*}” ShPK, datë 20.08.2009, mandatar-këtimin nr. 2612, datë 26.12.2009, të kësaj shoqërie dhe kontratë shitje të vitit 2011, të cilat janë shkresa të thjeshta që kanë fuqi provuese, sipas nenit 246 të Kodit të Procedurës Civile dhe duhen vlerësuar në harmoni me deklaratat e interesave privatë, deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe qëndrimet e subjektit gjatë hetimit administrativ; (iii) barra e provës, për huan 12.000 euro shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, është në kundërshtim me ligjin, parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit; (iv) përfundimi i Komisionit se shuma e kthyer nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK nuk mund të shërbejë si burim të ardhurash me arsyetimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar aftësinë financiare të shoqërisë në vitin 2011 është i gabuar, në kushtet kur edhe subjekti ka pasur aftësi pagueuse për dhënie hua, edhe shoqëria për kthimin e shumën 3.500.000 lekë. Nga analizimi i këtyre pretendimeve, trupi gjykues konstaton, si vijon.

31.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaron: *Garazh 48 m<sup>2</sup> nr. 8, me dy vende parkimi, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, pallati i firmës “{\*\*\*}” (ka qenë porositur në bashkëpronësi nga V. Xh. dhe V. Ç.). Vlera e blerjes: 24.000 euro. Koha e përfitimit: viti 2011. Në bashkëpronësi me R. H., 1/2 pjesë. Burimi: një pjesë e shumës së kthyer nga “{\*\*\*}”. Deklarim, i cili përputhej me atë në deklaratën e interesave privatë të vitit 2011, kontratë blerje me kusht datë 05.07.2011, garazh 48 m<sup>2</sup>, afër Muzeut Arkeologjik, pallati i firmës “{\*\*\*}”, shitës V. Xh., V. Ç., në vlerën 24.000 euro. Burimi i krijimit nga kontratat e huave dhe interesi i saj dhënë në vitin 2010, vlera e së cilës është në shumën 8.400.000 lekë dhe 840.000 lekë interesa.*

31.2. Pas kërkesës së Komisionit, me shkresën e datës 07.03.2020, notere F. A., ndër të tjera, përcjell; (i) kontratën e shitjes me kusht, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 05.07.2011, nënshkruar mes shitësit V. Xh. dhe blerësit Tritan Hamitaj, me objekt garazhin nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe 24 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Durrës, në vlerën 12.000 euro, nga e cila 10.000 euro likuiduar në zyrën noteriale dhe 2.000 euro parashikuar të likuidohet deri në festat e fundit të vitit; (ii) kontratën e shitjes me kusht, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.12.2011, mes shitësit V. dhe G. Xh. dhe blerës Tritan Hamitaj, ku përcaktohet likuidimi i shumës së mbetur prej 2.000 eurosh. Në përmbajtje të kësaj kontrate, përcaktohet se garazhi i përket pjesës fundore të garazhit, pasi pjesa e parë në hyrje është blerë prej Tritan Hamitaj nga V. dhe V. Ç..

31.3. Me kërkesë të Komisionit për dërgimin e të gjithë akteve noteriale të përgatitura prej saj, me shkresën<sup>52</sup> e datës 06.06.2020 (administruar me nr. {\*\*\*} prot., datë 09.06.2020) notere F. A., përcjell edhe kontratën e shitjes me kusht, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.08.2009, nënshkruar mes palës shitëse V. e V. Ç. dhe blerësve Tritan e R. H., me objekt garazhin nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe 24 m<sup>2</sup>, në vlerën 12.000 euro, likuiduar totalisht nga pala blerëse duke

<sup>52</sup> Me këtë shkresë përcillet, gjithashtu, në Komision edhe kontratë huapërdorje automjeti nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 01.07.2015, për automjetin e përcaktuar në paragrafin 28.6.5 të këtij vendimi.

marrë në dorëzim pasurinë. Për këtë kontratë ka dhënë pëlqimin edhe shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, pasi kjo pasuri nuk ishte regjistruar ende dhe për përfitimin e saj V. dhe V. Ç. kishin lidhur kontratën e sipërmarrjes, datë 14.08.2002.

**31.4.** Komisioni, nëpërmjet e-mail-it datë 11.06.2020, i kërkon shpjegime subjektit lidhur me mospërputhjet në kontratën e shitjes me kusht, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.08.2009, në të cilën cilësohet se shuma 12.000 euro është likuiduar totalisht dhe garazhi është marrë në dorëzim, ndërkohë në dokumentacionin depozituar me deklaratën e pasurisë *vetting* është depozituar kontratë shitje, datë 11.06.2011, me palë shitëse V. Ç., ku cilësohet se pagesa prej 12.000 eurosh është bërë në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe Komisioni konstaton se nënshkrimi i shitësit nuk përputhet. Në përgjigje të këtij konstatimi, subjekti shprehet se kontratat janë nënshkruar nga shtetasi V. Ç. dhe kanë vullnetin e tij të pavesuar. Në lidhje me vitin kur është përfituar garazhi, subjekti i rivlerësimit me prapësimet mbi rezultatet e hetimit ka sqaruar se pjesa e garazhit prej 24 m<sup>2</sup> është blerë në vitin 2009 në shumën 12.000 euro dhe është likuiduar atë vit. Garazhi në projekt është 48 m<sup>2</sup> në bashkëpronësi të shtetasve V. Xh. dhe V. Ç., një i tërë, pa mundësi ndarje. Kjo vështirësi ka bërë që nga të dy bashkëpronarët të jetë kërkuar blerja e pjesës takuese së garazhit me qëllim që i gjithë garazhi të ishte në pronësi vetëm të një personi. Duke mos gjetur mirëkuptim, kjo situatë ka vazhduar për disa vite. Subjekti pretendon ta ketë blerë këtë garazh në vitin 2009, por për shkak të problemeve në përdorimin e tij nga bashkëpronari tjetër, në dhjetor 2009 anuloi kontratën e shitblerjes me një kontratë të thjeshtë jonoteriale “*Zgjidhje e kontratës së shitjes me kusht*”, datë 26.12.2009, nëpërmjet të cilës palët u kthyen në gjendjen fillestare, sa i përket posedimit dhe kthimit të shumës së paguar. Me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti depoziton dokumentin “*Zgjidhje kontratës së kontratës së shitjes me kusht*”, datë 26.12.2009 dhe kontratë shitje e thjeshtë jo noteriale, datë 10.06.2011, mes shitësit V. Ç. dhe blerësit Tritan Hamitaj të pjesës së tij të garazhit prej 24 m<sup>2</sup>, në vlerën 12.000 euro, likuiduar ditën e nënshkrimit të kontratës, si dhe deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 16.07.2020, të shtetasit V. Ç., me të cilat ka pretenduar të provojë anulimin e kontratës së shitblerjes me kusht nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.08.2009, si dhe kërkon të vlerësohet si e vlefshme kontrata e lidhur në vitin 2011.

**31.5.** Lidhur me pamundësinë financiare për blerjen e garazhit, në këtë vit, në vitin 2009, të konstatuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit sqaron se shumën 12.000 euro ia kishte marrë hua shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK<sup>53</sup> në datën 20.08.2009, me mandatpagesën nr. {\*\*\*}, datë 20.08.2009 dhe pas kthimit të shumës nga V. Ç., ia kishte kthyer mbrapsht huan shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, sipas mandatarkëtimit nr. {\*\*\*}, datë 26.12.2009, të kësaj shoqërie. Me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti depoziton dhe dokumentin me objekt “Dhënie huaje”, datë 20.08.2009, jonoterial, nënshkruar mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe R. H. (H.), ku R. H. deklaron se ka nevojë për shumën 12.000 euro, si hua deri në fund të vitit dhe P. G., administrator i kësaj shoqërie, pranon që në emër të firmës t’i japë R. shumën 12.000 euro, pa interes, me kushtin që ajo ta kthejë brenda vitit 2009 në arkën e shoqërisë. Nëse nuk e kthen këtë shumë brenda datës 31.12.2009, për periudhën në vazhdim, ajo duhet të paguajë një interes 10 %, llogaritur me bazë vjetore.

**31.6.** Nga analizimi i këtyre kontratave noteriale dhe jonoteriale, lidhur me garazhin dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, në kushtet kur kontrata noteriale e vitit 2009 me shtetasin V. Ç. nuk është deklaruar as në deklaratën periodike të vitit 2009 dhe as në atë *vetting*, ndërkohë që në deklaratën e interesave privatë 2011 dhe atë *vetting* subjekti i rivlerësimit deklaron blerjen e garazhit me sipërfaqe 48 m<sup>2</sup>, me shitës shtetasit V. Xh. dhe V. Ç. dhe blerës Tritan Hamitaj,

---

<sup>53</sup> Sipas dokumentit “Vërtetim për bazën e vlerësueshme” dorëzuar me deklaratën e pasurisë *vetting*, rezulton se R. H. ka punuar pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për periudhën 01.01-21.05.2001.

në vlerën 24.000 euro, si dhe në kushtet kur kontrata e blerjes së garazhit në vitin 2009 me V. Ç. është nënshkruar përpara noterit, ndërsa dokumenti “Zgjidhje e kontratës së shitjes me kusht” në vitin 2009 dhe kontratë shitje e datës 10.06.2011, nuk janë noteriale, trupi gjykues kreu analizën financiare në dy mënyra, sipas arsytimit të Komisionit dhe sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit se e gjithë vlera e garazhit 48 m<sup>2</sup> është likuiduar në vitin 2011. Analiza financiare e kryer në Kolegj, në të dyja rastet, tregoi se subjekti i rivlerësimit ndodhet me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e garazhit, përkatësisht në vlerën (-) 1.486.345 lekë, nëse pagesa konsiderohet e kryer 12.000 euro në vitin 2009 dhe 12.000 euro në vitin 2011 dhe mungesa financiare arrin vlerën (-) 3.182.038 lekë për vitin 2011, nëse e gjithë shuma 24.000 euro konsiderohet e likuiduar në këtë vit.

31.7. Në përfundim, për pasurinë garazh me sipërfaqe 48 m<sup>2</sup>, me dy vendparkime, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Durrës, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me burimin e blerjes së kësaj pasurie dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj, sipas nenit 33, pika 5, germat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

*Për pasuritë, 2 apartamente me sipërfaqe 126 m<sup>2</sup> secili, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Durrës*

32. Komisioni arriti në konkluzionet se: (i) subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtyre njërive në shumën 605.834 lekë; (ii) subjekti është përpjekur të mos deklarojë në mënyrë të saktë dhe të plotë pasuritë njësi/apartament; (iii) mbeten dyshimet që subjekti mund të ketë fshehur faktin e pagesës së një vlere më të lartë se ajo që ka paguar sipas kontratës. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.
33. Subjekti në ankim i qëndron pretendimeve të ngritura gjatë hetimit administrativ në Komision dhe provave të depozituara prej tij, të cilat nuk janë argumentuar në vendim, duke pretenduar se: (i) parashikimi i pagesës së shumës 63.800 euro në momentin e regjistrimit të pasurisë në ASHK nuk është një parashikim kontraktor fiktiv, por real dhe ka ndodhur për faktin e imazhit negativ të shoqërisë ndërtuese në regjistrimin e objekteve të ndërtuara prej saj, pasiguria në realizimin e kontratës përfundimtare të shitjes, si dhe rreziku i rishitjes disa herë prej shoqërisë; (ii) përdorimi i tyre si njësi nuk është fshehur pasi është deklaruar në deklaratën e interesave privatë 2015 dhe atë *vetting*, shoqëruar me kontratat e qirasë së apartamentit, gjë që tregon destinacionin e përdorimit; (iii) dyshimet e Komisionit për çmimin e blerjes poshtë vlerës së tregut, subjekti i rivlerësimit pretendon se çmimi referues është orientues për administratën fiskale në llogaritjen e tatimit dhe nuk mund të ketë vlerë të paracaktuar. Çmimi i blerjes përcaktohet në marrëveshje të lirë mes palëve dhe rrethanave në të cilat lidhet një kontratë, në përputhje me nenin 706 të Kodit Civil, ligj që ka përparësi në zbatim përpara udhëzimit për përcaktimin e çmimeve të referencës; (iv) kontrata premtim shitje ka fuqi të plotë ligjore në përputhje me nenin 246 të Kodit të Procedurës Civile. Çmimi i nxjerrë nga Komisioni përfshin dhe ambientin e përbashkët dhe është bërë për njësi jo për apartament, ndërkohë, sipas udhëzimit duhet të llogaritet për sipërfaqe të shfrytëzueshme, i cili rezulton më i lartë se 350 euro/m<sup>2</sup>; (v) konkluzioni i Komisionit se subjekti është përpjekur të mosdeklarojë në mënyrë të saktë dhe të plotë pasuritë njësi/apartament është i gabuar dhe vjen në kundërshtim me deklaratën e pasurisë *vetting*, përgjigjet e ASHK-së Durrës, të paargumentuara nga Komisioni në vendim, kontratën e shitjes, planimetritë, kontratën e sipërmarrjes dhe dorëzimit, kontratat nënshkruar mes shoqërive “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK, si dhe argumentet e subjektit. Trupi gjykues, nga aktet në dosjen gjyqësore, konstaton, si vijon.

33.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaron: *Apartament (ka qenë njësi shërbimi në projekt) 2 x 126 m<sup>2</sup>, kati parë, Nr. {\*\*\*} në projekt. Ndodhur në lagjen nr. 3,*

rruga “{\*\*\*}”, Durrës, pa hipotekë. Vlera e blerjes: 88.200 euro. Paguar më 17.11.2015, në BKT shuma prej 24.400 eurosh në favor të “{\*\*\*}”. Pa paguar diferenca e vlerës prej 63.800 eurosh. Burimi: 20.000 euro nga të ardhurat e vitit dhe 4.400 hua nga A. H.. Këto pasuri deklarohen për herë të parë në deklaratën e interesave privatë 2015.

33.2. Këto pasuri përfitohen përmes kontratë premtim shitje e nënshkruar më datë 14.11.2015, jonoteriale, mes shitësve, shoqëria ndërtimore “{\*\*\*}” ShPK dhe shoqëria “{\*\*\*}” ShPK dhe blerës R. H., me objekt blerjen e 2 (dy) ambienteve me sipërfaqe 252 m<sup>2</sup> dhe 126 m<sup>2</sup> secili, ndodhur në katin e parë të objektit. Në këtë kontratë përcaktohet se ambientet janë ndërtuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK dhe janë porositur nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, e cila i ka paguar plotësisht ato, nëpërmjet punimeve në kantieret e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Këto ambiente shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ia shet bashkëshortes së subjektit R. H. dhe shoqëria “{\*\*\*}” ShPK është dakord me të. Çmimi i përcaktuar në nenin 4 të kontratës është në total 88.200 euro (çmimi është pa TVSh në shitje). Referuar nenit 6 të kontratës, pagesa është parashikuar të kryhet: kësti i parë 24.400 euro, menjëherë me lidhjen e kësaj kontrate në llogari bankare në monedhën euro të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK; dhe kësti i dytë prej 63.800 eurosh të likuidohet në të njëjtën llogari, ditën që do të lidhet kontrata e shitjes, pas regjistrimit të objektit në ZVRPP-në Durrës.

33.3. Në raportin e kontrollit të pasurisë për këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar dyshime lidhur me çmimin e blerjes prej 88.200 eurosh të apartamentit me sipërfaqe 252 m<sup>2</sup>, në vitin 2015, si dhe kryerjen e një pagese të vetme prej 24.400 eurosh me nënshkrimin e kontratës për apartamentin në vitin 2015 (pagesë e padokumentuar nga subjekti në vetting përveç paraqitjes së kontratës së premtim shitjes) dhe i pjesës tjetër të pagesës të pakryer, me afat deri në regjistrimin e objektit në ZVRPP.

33.4. Pas kërkesës së Komisionit, “{\*\*\*}” ShPK në informacionin<sup>54</sup> e përcjellë informon se ka nënshkruar dy kontrata me R. H., konkretisht më datë 14.11.2015, kontratë premtim shitje për prenotimin e dy apartamenteve me sipërfaqe totale 252 m<sup>2</sup>, (me nga 126 m<sup>2</sup> secili, përfshirë sipërfaqet e përbashkëta), dhe më 23.01.2016, kontratë për prenotimin e dy poste makinash. Sipas shoqërisë, apartamentet janë shitur me një çmim të tillë, pasi, shoqëria u detyrua të modifikonte ambientet që ishin projektuar për zyra në apartamente banimi, të cilat të ndodhura edhe në katin e parë nuk shiteshin prej vitesh si zyra apo apartamente normale. Ndryshimi i destinacionit është kërkuar edhe në AShK. Përveç sa më sipër, shoqëria ka qenë në vështirësi të mëdha likuiditeti. Apartamentet janë dorëzuar me kontratë dorëzimi në datën 19.01.2016.

33.5. Referuar akteve të përcjella nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 10.01.2003, të KRRT-së Durrës është miratuar leja e ndërtimit për godinë me 12 kate dhe bodrum [10 kate banim + 2 kate lokale]. Në vijim, rezultojnë të jenë administruar disa kontrata shitje me kusht dhe kontrata porosie në këtë godinë, për të vërtetuar çmimin e shitjes, për të provuar që çmimi i përcaktuar për R. H. nuk është preferencial.

33.6. Në përgjigje të pyetësorit të datës 03.04.2020, subjekti i rivlerësimit shpjegon se në projektin e miratuar në lejen e ndërtimit, kati i parë ka qenë njësi dhe jo me ndarjet si blerë nga bashkëshortja. Ndërtuesi ka pasur vështirësi në shitjen e këtij kati dhe ka ndryshuar zbatimin e projektit duke i kthyer në apartamente. Lidhur me çmimin e ulët të blerjes së tyre në raport me çmimin e tregut, arsyeja për subjektin ishte se pallati nuk ishte i regjistruar në ZVRPP-në Durrës dhe ndërtuesi kishte imazh jo pozitiv sa i përket regjistrimit të pallateve të ndërtuara prej tij. Në dijeni të subjektit nuk ka të regjistruar asnjë godinë në ZVRRP, madje as atë ku banon subjekti i rivlerësimit. Ndërkohë, administratori i shoqërisë u vetëofrua duke kërkuar blerjen e apartamenteve në katin e parë, me çmim më të ulët se tregu. Për ta bërë shitësin të

<sup>54</sup> Administruar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 13.07.2020.

interesuar për regjistrimin e pronës në ZVRPP-në Durrës, u arrit marrëveshja që blerësi të mos jepte të gjithë çmimin e shitjes dhe u vendos një penalitet nëse pallati nuk regjistrohej. Pra, për subjektin, çmimi poshtë referencës ishte për shkak të mosregjistrimit të sendit në ZVRPP-në Durrës. Shkaqe të tjera ishin pozicionimi jo i favorshëm për një pasuri, si dhe arsye të tjera të shitësit për të cilat subjekti ishte në dijeni.

Sa i përket destinacionit të përdorimit, subjekti sqaron se një nga apartamentet {\*\*\*} deri në datën 06.07.2017 ka qenë i papërdorur dhe nga kjo datë është dhënë me qira, ndërsa apartamenti tjetër {\*\*\*} është përdorur nga shoqëria e thjeshtë “{\*\*\*}”, për ushtrimin e aktivitetit të saj, nga viti 2016 e në vazhdim.

**33.7.** Në përgjigjet e pyetësorit të datës 03.04.2020, subjekti depoziton: (i) kontratën e qirasë nr. {\*\*\*} kol., nr. {\*\*\*} rep., datë 06.07.2017, me qiradhënës R. H. dhe qiramarrës shoqëria “{\*\*\*}” ShPK e subjektet persona fizikë si: “{\*\*\*}”, “{\*\*\*}”, “{\*\*\*}”, “{\*\*\*}”, “{\*\*\*}” dhe “{\*\*\*}”, për dhënien me qira të ambientit për zyra ku ushtronin aktivitetin privat; (ii) kontratën e qirasë nr. {\*\*\*} kol., nr. {\*\*\*} rep., datë 09.05.2018, me qiradhënës R. H. dhe qiramarrës personat fizikë “{\*\*\*}” e “{\*\*\*}”, në të cilën përshtatet se ambienti është pasuri e paluajtshme “apartament”, që do të përdoret për aktivitet privat; (iii) kontratën e qirasë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.09.2018, me qiradhënës R. H. dhe qiramarrës person juridik “{\*\*\*}”, për dhënien me qira të ambientit të shërbimit me sipërfaqe 118 m<sup>2</sup>, me afat 12-mujor, kundrejt qirasë 35.000 lekë/muaj.

**33.8.** Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti, ndër të tjera, sqaron se sipas dokumentacionit shoqëruar në kontratën mes palëve nuk ka asnjë dokument nga shitësi që provon se këto apartamente në momentin e blerjes kanë qenë njësi. Ai pretendon se deklarimi i tij përputhet me planimetrinë dhe dokumentet e tjera dhe është i saktë. Përdorimi i këtyre apartamenteve për qëllime biznesi është një gjë tjetër dhe nuk duhet të ngatërrohet me atë se çfarë blen. Subjekti pretendon se ka përfutuar nga momenti që firma ndryshoi projektin duke i përshtatur njësitë në apartamente për t’i blerë më lirë dhe bashkëshortja kishte ide biznesi të cilat mund të realizoheshin edhe në një banesë. Realizimi i biznesit në një apartament nuk e kthen atë në njësi për efekt të të drejtave të pronësisë, por ambient që përdoret për biznes. Nga bashkëshortja nuk është bërë asnjë ndryshim në strukturë dhe planimetrinë e apartamentit, por vetëm mobilim në përshtatje të funksionimit të biznesit. Apartamenti tjetër është dhënë me qira pa kushtëzuar përdorimin vetëm për banim. Qiramarrësi rastisi të ishte i tillë që e donte për biznes dhe kështu u lidh kontrata pa i bërë ndryshime strukturore apartamentit.

**33.9.** Në lidhje me çmimin më të ulët se vlera e tregut, ashtu si dhe në ankim, subjekti pretendon se çmimi i tregut është orientues, i nxjerrë nga shteti për qëllime fiskale, ndërkohë që palët me marrëveshje të lirë lidhën kontratën në përputhje me nenin 706 të Kodit Civil dhe prevalon ndaj VKM-ve apo udhëzimeve për përcaktimin e çmimeve të referencave. Kontrata është dokument zyrtar me fuqi të plotë ligjore në përputhje me nenin 246 të Kodit të Procedurës Civile. Çmimi i nxjerrë përfshin dhe sipërfaqen e përbashkët, ndërkohë sipas udhëzimit duhet të llogaritet sipërfaqe e shfrytëzueshme. Duke marrë për bazë këtë fakt, çmimi i blerjes së apartamenteve rezulton më i lartë se 350 euro/m<sup>2</sup>. Në vijim të përgjigjeve të pyetësorit nr. 1, subjekti sqaron se janë depozituar kontrata të tjera të ngjashme për të provuar se çmimi i shitjes është real dhe në kundërshtim me rregullat e tregut.

**33.10.** Me e-mail-in e datës 03.09.2020, subjekti i rivlerësimit vë në dispozicion të Komisionit dy përgjigjet e AshK-së, Drejtoria Durrës: (i) shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 29.07.2020, me anë të së cilës e njofton se në bazë të kërkesës së tij u ngrit një grup pune për të verifikuar objektin e deklaruar nga “{\*\*\*}” ShPK, nga ku u konstatua se sipërfaqja e blerë nga R. H. është e përbërë nga dy pasuri, të cilat, referuar kompozimit planimetrik të ambienteve, janë të

llojit apartament. Një apartament përdoret si i tillë dhe tjetri, si qendër kursesh profesionale: (ii) shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 24.08.2020, referuar të cilës, nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, rezulton se planimetria e katit të parë është me funksion banimi.

**33.11.** Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit i deklaron në deklaratën e pasurisë *vetting* këto dy pasuri si apartamente (*ka qenë njësi shërbimi në projekt*) dhe shoqëria “{\*\*\*}” ShPK dhe AShK Durrës, në bazë të shkresave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, konfirmojnë destinacionin *banim* të tyre, në kushtet kur këto dy ambiente përdoren për ushtrim aktiviteti ekonomik nga subjekte privatë, si ambienti ku ushtron veprimtarinë shoqëria “{\*\*\*}”, ashtu dhe ambienti tjetër i dhënë me qira, po për aktivitet ekonomik, krijojnë bindjen që destinacioni i përdorimit të këtyre pasurive prej blerjes së tyre ka qenë për biznes dhe jo për banim. Destinacioni i një ambienti afekton dhe çmimin e tij, pasi referuar rregullave të tregut të lirë të pasurive të paluajtshme e njëjta sipërfaqe kushton më shumë, nëse përdoret për aktivitet ekonomik (njësi), sesa për banim (apartament).

**33.12.** Nga ana tjetër, subjekti ka dashur të justifikojë çmimin prej 88.200 eurosh për një sipërfaqe 252 m<sup>2</sup>, duke bërë një vlerësim të rendit hierarkik të normave ligjore, me pretendimin se çmimi i blerjes përcaktohet nga një marrëveshje e lirë kërkesë-ofertë mes palëve, për të cilat lidhet një kontratë në përputhje me nenin 706 të Kodit Civil, që prevalon ndaj akteve nënligjore dhe ka përparësi në zbatim përpara udhëzimit të çmimeve të referencës. Në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues vlerëson se vullneti i palëve në tregun e lirë nuk është i pakufishëm, por ai duhet të respektojë edhe rregullat e vendosura nga shteti, nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore. Në rastin konkret, nëse çmimi do të përllogaritej sipas vlerës mesatare të shitblerjeve të banesave në tregun e lirë për qytetin e Durrësit, 68.540 lekë/m<sup>2</sup>, të miratuara me udhëzimin nr. 4, datë 30.09.2015, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2015”, atëherë çmimi për ambientet 252 m<sup>2</sup> do të ishte 17.272.080 lekë (të konvertuara 125.478 euro), ndërkohë çmimi për njësi shërbimi do të ishte edhe më i lartë.

**33.13.** Përpos sa sipër, fakti që shoqëria nuk kishte një imazh të mirë, në lidhje me procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nuk do ta çonte atë të shiste me çmime më të ulëta se vlerat e imponuara nga tregu i lirë, por kjo mund të orientonte palët të vendosnin mënyra pagese me këste, siç edhe ka ndodhur, por pa efekt në çmimin e shitjes. Nga ana tjetër, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit se një shoqëri me vështirësi në likuiditete nuk do të ishte e interesuar të shiste dy ambiente me sipërfaqe totale 252 m<sup>2</sup> gati në vlerën e kostos së ndërtimit, e të përfitonte këstin e parë prej vetëm 24.400 euro, ndërkohë që nga këto ambiente subjekti i rivlerësimit realizon fitime, pasi në njërin ushtron aktivitet ekonomik bashkëshortja dhe njësia tjetër gjeneron të ardhura nëpërmjet qirasë. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit nuk arrijnë të shuajnë dyshimet e ngritura nga Komisioni në vendim se subjekti mund të ketë fshehur faktin e pagesës së një vlere më të lartë nga vlera e paguar sipas kontratës. Megjithatë në linjë me Komision edhe në Kolegj, në analizën financiare të kryer u konsiderua vlera e përcaktuar në kontratën premtim shitje.

**33.14.** Nga analiza financiare e kryer në Kolegj rezultoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për pagesën e shumës 24.400 euro më datë 17.11.2015, në vlerën (-) 1.037.999 lekë. Nëse përfshihen në analizë, sikundër Komisioni, të ardhurat nga fatkeqësia e vdekjes së nënës 200.000 lekë, diferenca negative rezulton (-) 837.999 lekë. Në përfundim, për pasuritë, *dy apartamente* me sipërfaqe 126 m<sup>2</sup> secili, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Durrës, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë sa i përket destinacionit të përdorimit të këtyre pasurive, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e tyre, sipas nenit 33, pika 5, gjerat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

34. Komisioni vlerëson se subjekti duhet të kishte deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* rrethanat faktike të pasurisë apartament më sipër, për të cilat ka qenë në dijeni të plotë, duke shfaqur vullnetin e tij për deklarim të saktë e duke mos e lënë zbulimin ose jo të tyre në kuadër të hetimit administrativ, me qëllim shmangien e përgjegjësisë disiplinore për deklarim të pasaktë, në kundërshtim me ligjin. Komisioni çmon sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, si jo bashkëpunues, pasi nuk ka deklaruar saktë burimet që kanë shërbyer për shlyerjen e këtij apartamenti, si dhe faktin që ka paguar shumën 40.940 euro për këtë apartament. Komisioni çmon se kjo sjellje duhet të jetë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të analizës së fakteve dhe provave, Komisioni vlerëson se subjekti është përpjekur të mos deklarojë në mënyrë të saktë dhe të plotë pasurinë apartament e, për rrjedhojë, subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germave “a” dhe “b”, të nenit 33, pika 5 të ligjit nr. 84/2016.
35. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit me pretendimet: (i) aludimet e Komisionit se ky apartament mund të jetë pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit bien poshtë me kontratën e shitjes me kusht dhe shlyerjen e çmimit nga blerësi, babai i subjektit të rivlerësimit dhe faktin që ai përdor apartamentin në pronësi të subjektit; (ii) konstatimi i Komisionit se ky apartament është në të njëjtin kat dhe lidhet me apartamentin tjetër në pronësi të subjektit është i pavërtetë dhe i pabazuar në prova. Vendimi i Komisionit në këtë pjesë është i paarsyetuar; (iii) për pasuritë në përdorim, detyrimi i subjektit ka qenë të deklarojë përdorimin dhe jo burimin e krijimit të pasurisë, duke e kuptuar kështu ligjin e duke mos pasur asnjë qëllim tjetër për mosdeklarimin e burimit dhe mosshoqërimin me dokumentacion të të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e tij. Babai i subjektit nuk klasifikohet në cilësinë e personit tjetër të lidhur, parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pasi posedimi nuk është asnjë nga kategoritë e marrëdhënieve që përcakton dispozita e, në këto kushte, nuk ka pasur detyrimin të dorëzojë me deklaratën e pasurisë *vetting* dokumentacion që provonte të ardhurat e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie; (iv) Komisioni ka konstatuar se babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme për të blerë këtë apartament e, si rrjedhojë, sipas subjektit, nuk ka pasur arsye të mos ishte bashkëpunues dhe transparent; (v) marrëdhënia e huas me babain nuk është deklaruar si burim në përgjigjet e pyetësorit, pasi subjekti ka menduar se pyetja i referohej burimit të të ardhurave deri ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting* e, pas kësaj date, Komisioni nuk ka të drejtë të hetojë. Trupi gjykues nga analizimi i akteve të dosjes konstaton, si vijon.

35.1. Komisioni në vendim shprehet se: (i) subjekti, ndryshe nga sa ka deklaruar në deklaratën *vetting*, pas prapësimeve ka pranuar faktin se apartamenti i porositur nga babai është blerë realisht për nevojat e subjektit të rivlerësimit; (ii) nuk ka deklaruar se prindërit e tij kanë në përdorim apartamentin në pronësi të tij; (iii) gjatë hetimit administrativ ka fshehur faktin se i ka dhënë hua babait të tij shumën 40.940 euro për shlyerjen e plotë të pagesës së këtij apartamenti; (iv) ky apartament nuk është përdorur asnjëherë nga babai i subjektit, pavarësisht se është blerë prej tij; (v) apartamenti është në të njëjtin kat dhe lidhet me apartamentin tjetër në pronësi të subjektit; si dhe (iv) apartamenti është përdorur gjithmonë nga subjekti i rivlerësimit.

35.2. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi se është *posedues edhe i apartamentit të ndodhur në lagjen nr. {\*\*\*}, rruga “{\*\*\*}”, Durrës, me sipërfaqe 146,3 m<sup>2</sup>, kati i dytë banim me nr. {\*\*\*} në projekt, ndërtuar nga “{\*\*\*}”, kulla perëndimore, pa hipotekë. Apartamenti është i kontraktuar me kontratë me kusht nga Rr. H..* Posedimin e këtij apartamenti, subjekti e deklaroi edhe me përgjigjet e pyetësorit standard të Komisionit.

35.3. Kjo pasuri është përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes së pasurisë të paluajshme apartament, me kusht, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 31.12.2016, nënshkruar mes shitësit B. Dh. dhe blerësit Rr. H., me objekt blerjen e apartamentit me sipërfaqe 146,3 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Durrës, në vlerën totale 73.150 euro, shumë e cila likuidohet: 7.000 euro likuiduar në datën e nënshkrimit të kontratës dhe 66.150 euro do të likuidohen sipas marrëveshjes private mes palëve, por jo më vonë se 3 vjet nga data e nënshkrimit të kontratës.

35.4. Në përgjigje të pyetësorit të datës 03.04.2020, lidhur me burimin e të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti, subjekti sqaron se kanë shërbyer: (i) paga dhe shpërblime të tjera nga marrëdhëniet e punës së nënës për periudhën 1991- gusht 2001, në Komunën {\*\*\*} dhe pensioni i saj; (ii) paga dhe shpërblime të tjera nga marrëdhëniet e punës të babait për periudhën 1991- 2011, në Komunën {\*\*\*} dhe pensioni i tij; (iii) të ardhurat nga toka bujqësore, në të cilën përfshihen ullinjë, vreshti dhe pemë të tjera rreth shtëpisë në {\*\*\*} të familjes, si dhe ato nga tokat bujqësore të gjyshes; (iv) shitje apartamenti në Ballsh; (v) dëmshpërblimi si ish të përndjekur politik në emër të H. H.<sup>55</sup>, përfituar si trashëgimtar nga Rr. H.; (vi) subjekti rezervon të drejtën për ndonjë burim tjetër që për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar mund ta ketë harruar. Subjekti sqaron se e posedon këtë apartament, pasi prindërit posedojnë apartamentin në pronësinë e tij të blerë në vitin 2002, me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup>. Arsyeja e blerjes së këtij apartamenti nga babai është se ai kishte vendosur të jetonte në Durrës. Pas pyetjes së Komisionit, subjekti sqaron se apartamenti në posedim të tij ndodhet në të njëjtin kat me apartamentin me sipërfaqe 78,24 m<sup>2</sup> të blerë prej tij, më 05.03.2014 dhe këto apartamente kanë mur të përbashkët, por nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin. Subjekti ka depozituar dhe foto me kërkesë të Komisionit.

35.5. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ku Komisioni kishte konstatuar mungesë të të ardhurave të ligjshme në shumën (-) 2.129.681 lekë për blerjen e apartamentit, subjekti i rivlerësimit sqaron për likuidimin e kësteve: më datë 31.12.2016 është paguar nga Rr. H., shuma 7.000 euro; më datë 04.01.2018 është paguar nga Rr. H. me transfertë nga llogaria e tij bankare në “Raiffeisen Bank” ShA në llogarinë personale të B. Dh. në NBG ShA, shuma 2.000.000 lekë; më datë 26.03.2018, po në llogarinë bankare të B. Dh., është bërë pagesa e shumave 5.000 euro dhe 5.200 euro; më datë 25.03.2016 është paguar nga Tritan Hamitaj shuma prej 40.940 eurosh në llogarinë personale të B. Dh. në “Alpha Bank” ShA, me qëllim shlyerjen totale në emër të Rr. H. të çmimit të apartamentit, sipas kontratës së blerjes. Subjekti kërkon që në analizën financiare të Rr. H. të mos përfshihet shuma prej 40.940 eurosh<sup>56</sup>, pasi nuk është paguar prej babait, por nga të ardhurat e vitit 2020 të krijuara nga subjekti i rivlerësimit. Duke kërkuar, gjithashtu, të merren në konsideratë të ardhurat nga toka bujqësore, sipas aktit të ekspertimit agronomik deri në datën e pagesës së këstit të fundit, më 23.05.2016.

35.6. Në vijim të prapësimeve, sa i përket dyshimit që ky apartament është në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit, subjekti parashtron se prindërit kishin vendosur të jetonin në Durrës dhe nuk dispononin banesë e duke qenë se edhe vetë ai kishte nevojë për një sipërfaqe më të madhe banimi nga sa dispononte, pasi ishte me tre fëmijë dhe në moshë jo të vogël, do të duhej të shiste apartamentin që kishte në pronësi, veprime këto me kosto fiskale e noteriale, ndërsa babai do të blinte apartamentin e nevojshëm për të, i cili, gjithashtu, do të kishte kosto noteriale.

<sup>55</sup> Referuar urdhrin nr. {\*\*\*}, datë 09.03.2010, të Ministrisë të Drejtësisë “Për pranimin e kërkesës për përfitimin e dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarin e regjimit komunist z. H. Q. H.”, është pranuar kërkesë për dëmshpërblim financiar në masën 5.579.000 lekë.

<sup>56</sup> Vërtetuar me dokumentin financiar “Fund transfer with charge”, datë 25.03.2020, pranë “Alpha Bank” ShA, nga Tritan Hamitaj te B. Dh. [dokument i sjellë nga subjekti me prapësimet mbi rezultatet e hetimit], me referencë: “Tritan Hamitaj për Dh. B. kalim për përmbushje të detyrimit të babait tim z. Rr. H., për kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 31.12.2016 [...] shuma i jepet hua babait tim pa afat dhe pa interes”.



Për të shmangur kostot e tepërta, në dakordësi me babain, vendosën që ky i fundit të jetonte te banesa e subjektit e mjaftueshme për dy veta e babai të blinte një apartament me sipërfaqen e nevojshme për subjektin. Banesa nuk është pronësi e fshehur e tij, por rezultat i një kontrate të rregullt noteriale që pasqyron vullnetin e palëve, që është dokument zyrtar me fuqi të plotë juridike. Subjekti shpjegon se prindërit jetonin pa qira në banesën e tij dhe detyrim për prindërit kishin edhe tri vëllezërit e tjerë. Nga ana tjetër, ekzistenca e këtij apartamenti ngjitur me apartamentin në pronësi të subjektit me sipërfaqe 78,24 m<sup>2</sup> nuk tregon që janë të dy në pronësi të subjektit, por qëllimi ishte që më vonë të përdorej nga fëmijët e tij për t'i pasur afër. Sipas subjektit, nëse prindërit do të jetonin diku tjetër dhe ai pa arsye do të përdorte banesën e tyre, mund të krijoheshin dyshime të tilla.

**35.7.** Në analizë të shkaqeve të ankimit të ngritura nga subjekti, trupi gjykues vlerëson se në kuadër të parashikimit në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, lidhur me pasuritë në përdorim/posedim të subjekteve të rivlerësimit, Komisioni ka detyrimin të analizojë dhe evidentojë saktë marrëdhënien juridike që lidh subjektin me pasurinë në përdorim, në drejtim të verifikimit të çdo rrethane që mund të ngrëjë dyshime për fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurive në përdorim të tij, që mund të rezultojnë të jenë krijuar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ngarkohet me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë në posedim/përdorim. Rrethanat e kësaj çështje, si blerja e këtij apartamenti të kontraktuar nga babai i subjektit për nevoja të subjektit të rivlerësimit, përdorimi i këtij apartamenti nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pagesa prej tij e shumës 40.940 euro, ngrë dyshime që ky apartament mund të jetë pasuri e subjektit të rivlerësimit.

**35.8.** Komisioni, referuar përcaktimeve në kontratë se diferenca e çmimit prej 66.150 eurosh do të likuidohet sipas marrëveshjes private mes palëve, por jo më vonë se 3 vjet nga data e nënshkrimit të kontratës, ka vlerësuar të konsiderojë shumën 40.940 euro në analizën financiare si të paguar nga babai i subjektit Rr. H. në kuadër të detyrimit kontraktor për likuidimin total të çmimit deri në vitin 2019 (3 vjet pas nënshkrimit, më 31.12.2016). Nga verifikimi i mundësisë financiare për krijimin e kësaj pasurie, prindërit e subjektit kanë rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën (-) 2.129.681 lekë. Me konsideratë pretendimin e subjektit me parashtrimet në Kolegj për përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës në masën 30 % të të ardhurave, përsëri analiza financiare tregon se Rr. H. është në pamundësi financiare në masën (-) 2.005.815 lekë, duke mos ndryshuar situatën financiare të tij.

**35.9.** Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit pretendon se i ka dhënë hua shumën 40.940 euro të likuiduar më 25.03.2020, për të cilën ka depozituar dokument transferte bankare me përshkrimin: "*Tritan Hamitaj për Dh. B. kalim për përmbushje të detyrimit të babait tim z. Rr. H., për kontratë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 31.12.2016 [...] shumë i jepet hua babait tim pa afat dhe pa interes*", nuk rezulton e shpjeguar prej tij në mënyrë shteruese arsyeja e dhënies hua të kësaj shume, e paformalizuara me kontratë huaje, burimi i dhënies së kësaj shume pa u justifikuar me faktin që është përtej periudhës së rivlerësimit, si dhe fakti që nuk e ka deklaruar këtë si burim për krijimin e kësaj pasurie në përgjigje të pyetjes nr. 7 të pyetësorit të datës 03.04.2020, përcjellë Komisionit në qershor 2020, edhe pse kishin kaluar disa muaj nga pagesa e shumës 40.940 euro në favor të shoqërisë e, në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se në këtë rast veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit janë përpjekje e tij për t'iu shmangur të vërtetës dhe janë për pasojë të pabesueshme.

**35.10.** Në këto kushte, trupi gjykues, pasi kreu analizën financiare në linjë me Komisionin, duke konsideruar shlyerjen e kësteve të apartamentit sipas kontratës me kusht, arrin në përfundimin se babai i subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të likuiduar këstet e apartamentit në vitet 2016, 2018 dhe 2019, në vlerën (-) 2.331.120 lekë

dhe në zbatim të parimit të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit, trupi gjykues konfirmon balancën negative konstatuar nga Komisioni.

Për pasurinë, apartament me sipërfaqe 146,3 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Durrës, përfituar me kontratë shitblerje me kusht nga Rr. H. dhe poseduar nga subjekti i rivlerësimit, ky i fundit ka kryer deklaram të pasaktë sa i përket burimit të krijimit dhe babai i tij rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, sipas nenit 33, pika 5, geramat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

*Lidhur me të ardhurat nga qiratë e apartamentit me sipërfaqe 103,82 m<sup>2</sup>, në Tiranë dhe apartamentit me sipërfaqe 78,24 m<sup>2</sup>, në Durrës*

36. Në lidhje me dy kontratat e qirasë, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të deklarojë në mënyrë të pasaktë të ardhurat e përfituara nga qiraja me qëllim justifikimin e të ardhurave të tij, duke e vënë në kushtet e deklaramit të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a”, të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

37. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, duke pretenduar se të ardhurat nga qiraja e apartamentit me sipërfaqe 103,82 m<sup>2</sup>, në Tiranë, në shumën 14.283 euro, nuk vijnë në kundërshtim me asnjë provë dhe kontrata e qirasë, datë 13.08.2014, për këtë apartament është reale dhe jo fiktive. Gjithashtu, për të ardhurat nga qiraja e apartamentit me sipërfaqe 78,24 m<sup>2</sup>, në Durrës, kontrata e qirasë e datës 05.03.2014 është reale dhe subjekti nuk është përpjekur të rrisë në mënyrë fiktive të ardhurat. Komisioni duhet të kishte vlerësuar me objektivitet datën e kontratës së shitjes, pagesat e çmimit të bërë dhe kontratën e qirasë, prova të ligjshme dhe të pakontestuara nga Komisioni, për secilin nga apartamentet. Trupi gjykues, në analizë të akteve në dosjen gjyqësore, konstaton, si vijon.

37.1. Nga analizimi i deklaratave periodike, rezulton se të ardhurat nga qiraja e këtyre apartamenteve janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, si në deklaratat e interesave privatë të viteve përkatëse 2014, 2015 dhe 2016, ashtu edhe në deklaratë e pasurisë *vetting*, konkretisht:

37.1.1. Në deklaratën e interesave privatë: në vitin 2014 janë deklaruar qira në shumat 2.283 euro për apartamentin në Tiranë dhe 220.000 lekë për apartamentin në Durrës; në vitin 2015, qira në shumat 6.000 euro për apartamentin në Tiranë dhe 300.000 lekë për apartamentin në Durrës; dhe në vitin 2016, qira në shumat 6.000 euro për apartamentin në Tiranë dhe 300.000 lekë për apartamentin në Durrës.

37.1.2. Në deklaratën e pasurisë *vetting*: të ardhurat nga qiraja e apartamentit me sipërfaqe 78,24 m<sup>2</sup>, rruga “{\*\*\*}”, Durrës, kanë qenë në shumën 25.000 lekë në muaj, duke filluar nga data 05.03.2014. Të ardhurat nga qiraja për vitet 2014-2016, në vlerën 820.000 lekë; të ardhura nga qiraja e apartamentit me nr. {\*\*\*} pasurie, zona kadastrale {\*\*\*}, Tiranë, shuma e qirasë 500 euro në muaj, duke filluar nga data 13.08.2014. Të ardhurat, nga kjo qira për vitet 2014-2016, kanë qenë në shumën 14.283 euro.

37.2. Me deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti depoziton; (i) për vitet 2014 dhe 2015, kontratë qiraje jonoteriale me qiradhënës Tritan Hamitaj dhe qiramarrës F. J., për apartamentin me sipërfaqe 103,82 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në vlerën 500 euro/muaj, duke filluar nga data 13.08.2014. Pagesat janë konfirmuar me letra të thjeshta; (ii) prej datës 1 janar 2016, nëpërmjet kontratës së qirasë ky apartament i jepet me qira shtetasit D. L. për një vit, në vlerën 6.000 euro, pagesa e të cilit është kryer në llogarinë bankare të shtetasve Tritan Hamitaj, R. H., A. G. dhe M. G. në “Alpha Bank” ShA (datë 28.09.2016); (iii) kontratë qiraje (jonoteriale) nënshkruar mes shtetasve Tritan Hamitaj dhe D. Gj., për apartamentin me sipërfaqe 78,24 m<sup>2</sup>,

në Durrës, me afat njëvjeçar, duke filluar nga data 05.03.2014, në vlerën 25.000 lekë në muaj, parapaguar shuma 200.000 lekë, që i korrespondon qirasë për 8 (tetë) muaj. Apartamenti është dorëzuar më 05.03.2014 dhe pagesat janë dokumentuar me shkresa të thjeshta.

37.3. Sa i përket lidhjes së kontratës së qirasë në të njëjtën ditë me përfitimin e pronësisë së këtyre apartamenteve, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit të datës 03.04.2020, për qiranë e datës 13.08.2014, për apartamentin në Tiranë, shpjegon se nga shitësi i ishte premtuar shitblerja më herët se data 13 gusht, por u vonua në marrjen e certifikatës së pronësisë së apartamentit, ndërkohë që subjekti kishte siguruar qiramarrësin dhe i kishte premtuar se do ta merrte me qira më herët se data e shitjes, duke besuar fjalën e shitësit. Me realizimin e kontratës së shitblerjes dhe pagesën e një pjese të mirë të çmimit të apartamentit, ku njëkohësisht ishte miratuar dhe kredia, nga shitësi nuk u prit edhe pagesa e fundit, por u realizua dorëzimi i apartamentit në datën 13.08.2014. Për blerjen e apartamentit, subjekti sqaron se mori hua 5.000 euro nga i vëllai A. H. dhe deri në fund të vitit, shumën e qirasë së marrë e ka përdorur për të ulur huan ndaj të vëllait në shumën 2.800 euro. Në lidhje me qiranë e apartamentit tjetër me sipërfaqe 78,24 m<sup>2</sup>, në Durrës, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se ndërkohë që ishte arritur marrëveshja e blerjes dhe pritej formalizimi përpara noterit, ndodhën vonesa për shkaqe neglizhence. Nga momenti i arritjes së marrëveshjes verbale për çmimin, u interesua të gjente qiramarrës të mundshëm dhe rezultoi qiradhënien menjëherë nga momenti i blerjes.

37.4. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni, edhe pse ka ngritur dyshime për fiktivitetin e kontratave të qirasë, ka përfshirë në analizën e tij financiare këto të ardhura duke i konsideruar të ligjshme. Në vlerësim të trupit gjykues, nënshkrimi i kontratave të qirasë, në të njëjtën ditë me nënshkrimin e kontratave për përfitimin e pronësisë mbi këto apartamente, jo domosdoshmërisht krijojnë dyshimin se janë fiktive. Në kushtet kur këto të ardhura janë deklaruar, si në deklaratat periodike vjetore, ashtu dhe në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe rezultojnë e provuar pagesa e detyrimit tatimor në vlerat 53.962 lekë, 171.000 lekë dhe 175.859 lekë, përkatësisht për këto të ardhura, trupi gjykues në linjë me Komisionin i përfshiu në analizën financiare të kryer në Kolegj.

*Lidhur me krijimin e depozitave në shumën 520.000 lekë dhe 2.000.000 në Bankën Amerikane, nga bashkëshortja*

38. Lidhur me këto depozita bankare, Komisioni konstatoi se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme në shumën (-) 2.318.287 lekë për krijimin e dy depozitave.
39. Subjekti i rivlerësimit e gjen konkluzionin e Komisionit në kundërshtim me nenin D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, ligjin nr. 84/2016, provat e marra, si dhe me parimin e ligjshmërisë, objektivitetit, proporcionalitetit në barrën e provës, fuqisë prapavepruese të ligjit. Subjekti i rivlerësimit, në ankim parashton: (i) Komisioni duhet të mbante në konsideratë provat e administruara, komunikimet elektronike dhe deklaratën noteriale të përgjegjëses I. K., që provojnë marrëdhënien e punës, pranë Institutit të Kulturës Italiane për periudhën 2001- 2003. Në lidhje me provueshmërinë dhe vlerën e të ardhurave, duhej të merrej parasysh fakti që bashkëshortja nuk ishte subjekt deklarimi, kohën e largët, punën në informalitet, duke iu referuar të ardhurave për periudhën 2004 e në vazhdim, e duke i llogaritur 600.000 lekë në periudhën 2001-2003 dhe 200.000 lekë për vitin 2004; (ii) Komisioni nuk ka përfshirë të ardhurat e bashkëshortes nga puna pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, sipas dokumentit zyrtar librezë e punës, në shumën 100.000 lekë, pasi nuk analizon vlerën e këtij dokumenti, siç ka vepruar për të ardhurat nga puna e shtetasit A. G.; (iii) Komisioni duhet të kishte përfshirë të ardhurat nga dëmshpërblimi i ish të përndjekurve politikë me vlerë të saktë dhe të ardhurat nga pasuritë në Gjirokastër, shtëpitë, hoteli, qira kullotash e dyqanesh për vitet 1994-2004, në

shumën 904.524 lekë. Mosdeklarimi i tyre si burime në deklaratën e pasurisë *vetting* nuk sjell përjashtimin nga analiza. Të ardhurat janë krijuar kur bashkëshortja nuk ishte person i lidhur. Për to nuk është e nevojshme të provohet shlyerja e detyrimeve tatimore, pasi disa janë krijuar para miratimit të ligjit për tatimin mbi të ardhurat e për disa është dokumentuar tatim i paguar. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton, si vijon.

**39.1.** Në deklaratën e interesave privatë 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dy depozita bankare me afat 6-mujor në Bankën Amerikane të Shqipërisë, në emër të bashkëshortes R. H. (H.) në vlerat 520.000 lekë dhe 2.000.000 lekë, vitet 2003 dhe 2004, me burim të ardhura nga puna dhe shitje trualli nga e ëma. Nga të ardhurat e pretenduara si burim krijimi për këto depozita në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dokumenti kryesor për vlerësimin e pasurisë në kuadër të këtij procesi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) të ardhura pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK për periudhën 01.12.1998-31.03.1999; (ii) të ardhura për periudhën 01.02.2000-01.11.2000, pranë “{\*\*\*}” ShPK, për të cilat deklarohet se nuk ka të dhëna të sakta për pagesën; (iii) paga pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK për periudhën 01.01.2001-31.05.2001, në vlerën 97.955 lekë; (iv) paga pranë personit fizik “{\*\*\*}” për periudhën 01.10.2003 - 28.02.2004, në vlerën 45.925 lekë; (v) të ardhura nga leje e lindjes për periudhën 10.03.2004-01.02.2005, në vlerën 72.665 lekë; si dhe (vi) të ardhura nga “Instituti i Kulturës Italiane” për vitet 2004-2008, në shumën 1.138.000 lekë.

**39.2.** Trupi gjykues, në analizën financiare të kryer në Kolegj, ka përfshirë të ardhurat e ligjshme të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit R. H., të provuara me dokumentacion justifikues ligjor, konkretisht: (i) të ardhurat nga punësimi në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK në masën 48.000 lekë, provuar me *vërtetim për bazën e vlerësueshme*; (ii) të ardhurat nga përfitimi i bursës për periudhën 1994-1998, sipas vërtetimit nr. {\*\*\*} prot., datë 24.07.2020, lëshuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, në vlerën 120.900 lekë; (iii) të ardhurat nga punësimi pranë “{\*\*\*}” person fizik për vitet 2003 dhe 2004, sipas vërtetimit nr. {\*\*\*} prot., datë 21.10.2016, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Durrës. Trupi gjykues nuk mori në konsideratë në analizë financiare: (i) të ardhurat nga punësimi i R. H. pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, pasi referuar shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 06.07.2020, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Durrës, për këtë shoqëri, nuk ka listëpagesa për vitet 1999-2000; (ii) të ardhurat nga punësimi pranë Shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK; (iii) të ardhurat nga dëmshpërblimi si ish të përndjekur politikë, si arsyetuar në paragrafin 25.5.32 të këtij vendimi; si dhe (iv) të ardhurat e pretenduara nga shitja dhe qiratë e pasurive në Gjirokastrë, si arsyetuar paragrafin 25.5.26 të këtij vendimi.

**39.3.** Lidhur me të ardhurat nga punësimi pranë Institutit të Kulturës Italiane, për periudhën 2001-2003, trupi gjykues vlerësoi të mos konsiderojë në analizën financiare të ardhurat e pretenduara nga subjekti në vlerën 600.000 lekë, pasi edhe pse subjekti i rivlerësimit ka depozituar komunikime elektronike të mbajtura nga ky institut me përgjegjësen e kurseve në Durrës, përveçse këto të ardhura nuk janë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk provohet me dokumentacion shuma konkrete e përfituar. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen si burim në depozitën bankare të vitit 2003 edhe të kontributit dhënë prej tij, në cilësinë e të fejuarit në atë kohë, në shumën 125.000 lekë, trupi gjykues konsideron se ky kontribut mbetet në nivel deklarativ dhe nuk mund përfshihet në analizë financiare.

**39.4.** Trupi gjykues, pas verifikimit të mundësisë financiare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit për të krijuar dy depozitat në shumat 520.000 dhe 2.000.000 lekë në vitet 2003 dhe 2004, përkatësisht, konfirmoi diferencën negative në vlerën (-) 2.318.287 lekë të konstatuar nga Komisioni, që provon pamjaftueshmërinë e të ardhurave të ligjshme të bashkëshortes së subjektit për krijimin e tyre.

## Gjendja cash në fund të vitit 2016

40. Komisioni konstaton se në fund të vitit 2016 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* shumë prej 980.000 lekësh. Shuma 860.000 lekë në deklaratën *vetting* vjen si pakësim i kursimeve *cash* nga dhjetori i vitit 2016. Për sa i takon mundësisë që subjekti ka pasur për të krijuar gjendjen *cash* në fund të vitit 2016, rezulton se nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme, në shumën (-) 437.025 lekë.
41. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, pasi e gjen atë të pabazuar dhe të paarsyetuar, duke pretenduar se: (i) në analizën financiare të vitit 2016, nuk janë përfshirë të ardhurat nga toka bujqësore në shumën 150.000 lekë; (ii) nuk duhet të përfshihen shpenzimet e udhëtimit të bashkëshortes dhe të birit, pasi shpenzimet e bashkëshortes janë mbuluar nga O.B., ndërsa nga të dhënat e sistemit *TIMS* nuk rezulton që djali J. H. të ketë udhëtuar në Itali në vitin 2016; (iii) gjendja e llogarisë në emër të shoqërisë së thjeshtë “{\*\*\*}”, në “Raiffeisen Bank” ShA, nuk duhet të llogaritet si likuiditet për R. H. në shumën 550.000 lekë, pasi në këtë llogari janë kryer pagesa vetëm për llogari të aktivitetit ekonomik të shoqërisë, sipas mandatarëtimeve për klientët të ndryshëm dhe jo për llogari të R. H..

Lidhur me depozitimin e shumës 6.000 euro më datë 06.07.2016, në “Alpha Bank” ShA, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit për këtë depozitë nuk është i bazuar në vlerësimin objektiv të provave, pasi në datën 22.01.2016 janë tërhequr 15.000 euro nga llogaria, me burim të ligjshëm kontratën e shitjes, përdorur për nevoja të subjektit, pasi e motra e bashkëshortes pjesën e saj prej 8.000 eurosh nga kontrata e shitjes nuk e mori menjëherë nga momenti i derdhjes në llogari.

42. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, lidhur me këto pretendime, trupi gjykues:

42.1. E gjen të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit, lidhur me mospërfshirjen në analizën financiare të likuiditeteve në llogarinë bankare të shoqërisë së “{\*\*\*}”, në “Raiffeisen Bank” ShA, pasi nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë bankare u verifikua që likuiditetet në të i përkasin aktivitetit ekonomik të shoqërisë, nga e cila personi i lidhur R. H. përfiton të ardhura prej pagës dhe/ose fitimit *neto*.

42.2. Referuar dokumentacionit në dosje, trupi gjykues konstaton se më datë 03.01.2010 nënshkruhet aktmarrëveshje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 03.01.2010, mes shtetases L. H. dhe shoqërisë sipërmarrëse “{\*\*\*}” ShPK, për ndarjen dhe përcaktimin e sipërfaqes së ndërimit, sipas projektit të objektit të godinës shumëfunktionale, që kjo shoqëri do të ndërtojë në truallin e saj. Në këtë aktmarrëveshje parashikohet që znj. L. H. do të përfitojë 482 m<sup>2</sup>, apartamente dhe dy njësi [dyqan dhe bodrum] prej 36,28 m<sup>2</sup> secili.

42.3. Me “Ndryshim i pjeshëm i kontratës noteriale” nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 06.01.2016, mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe R. H. e M. G., nëpërmjet të cilit palët vendosën të ndryshojnë kontratën e sipërmarrjes sa i përket ndryshimit të sipërfaqes së bodrumit (dy vende parkimi) prej 36,28 m<sup>2</sup>, me shumën 13.000 euro. Sipërmarrësi do të paguaj në favor të porositësit edhe një shumë prej 3.000 eurosh, si dëmshpërblim për përcaktim të njërës prej hyrjeve në një pozicion jo të mirë në raport me pozicionin ndaj diellit. Pagesa totale prej 16.000 eurosh do të derdhej nga sipërmarrësi në numrin e llogarisë në euro që porositësit kanë së bashku në “Alpha Bank” ShA. Kjo shumë u transferua më datë 18.01.2016 në llogarinë e përbashkët të A. G., Tritan Hamitaj, M. G. dhe R. H., në “Alpha Bank” ShA (llogari që përdorej për shlyerjen e kredisë për apartamentin me sipërfaqe 103,82 m<sup>2</sup>, në Tiranë).

42.4. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se më datë 22.01.2016, ka tërhequr nga kjo llogari shumën 15.000 euro, por nga kjo shumë nuk është

shlyer detyrimi për motrën e bashkëshortes M. G., në shumën 8.000 euro. Këtë shumë, subjekti pretendon ta ketë mbajtur për nevoja të mobilimit të shoqërisë së thjeshtë “{\*\*\*}” PF. Shoqëria krijoi të ardhura e në mobilimin e saj kontribuoi edhe ortakja tjetër dhe njëkohësisht disa fatura janë paguar në fund të vitit, një pjesë e shumës prej 15.000 eurosh u përdor si derdhje për 6.000 euro në të njëjtën llogari në datën 06.07.2016, me qëllim shlyerjen në avancë të kredisë. Shuma prej 8.000 eurosh që i takonte znj. M. G., nga kontrata nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 06.01.2016, me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, i është dhënë në dorë nga ana e subjektit në tetor-nëntor të vitit 2016. Për të provuar pretendimet e tij, subjekti depoziton deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.07.2020, të shtetases M. G..

42.5. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, verifikoi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit, për të blerë dy poste parkimi në vlerën 8.000 euro<sup>57</sup> më datë 30.05.2016, për të likuiduar kredinë në shumën 6.000 euro më datë 06.07.2016, për të likuiduar shumën 8.000 euro shtetases M. G. në periudhën tetor-nëntor 2016, likuidimin e kredisë në shumën 10.000 euro më 30.12.2016, si dhe për të kursyer shumën 980.000 lekë në fund të vitit 2016. Rezultatet e analizës financiare treguan diferencë pozitive për periudhën 01.01.2016 -30.05.2016, lidhur me likuidimin e shumës 8.000 euro në këtë datë. Për periudhën 30.05.2016-06.07.2016, analiza tregoi pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme të subjekti dhe personit të lidhur në vlerën (-) 735.609 lekë, për të krijuar shumën 6.000 euro. Diferencë negative në shumën (-) 478.075 lekë ka rezultuar edhe nga analiza e kryer për periudhën 06.07.2016-30.12.2016, që tregon pamjaftueshmëri për të krijuar depozitën në shumën 10.000 euro, në datën 30.12.2016. Ndërsa, analiza financiare vjetore 2016 rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 949.475 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

#### *Lidhur me analizën financiare për periudhën e rivlerësimit*

43. Komisioni në vendim arriti në konkluzionin se për periudhën 2003-2016 subjekti i rivlerësimit rezulton se nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të blerë pasurinë, krijuar likuiditetet dhe mbuluar shpenzimet në shumën (-) 14.836.427 lekë.
44. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, që, sipas tij, nuk është rezultat i provave të marra në këtë proces, si dhe vetë burimeve të pranuar nga Komisioni: (i) në momentin që nga Komisioni pranohet se toka bujqësore krijon të ardhura dhe kjo e ardhur është e shtrirë për periudhën 1991-2016, ajo afekton shifrën e nxjerrë nga Komisioni. Komisioni nuk mund të përcaktojë një shifër, kur nuk është në gjendje të vlerësojë në sasi numerike një të ardhur; (ii) analizën financiare të Komisionit e afekton e ardhura nga puna *part-time* e bashkëshortes në Institutin e Kulturës Italiane në vitet 2004-2008, burim i njohur nga Komisioni, që lë të pacaktuar sa është e ardhura; (iii) Komisioni pranon se huaja e dhënë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK nuk mbulohet e gjitha me të ardhura të ligjshme dhe, si rrjedhim, nuk e ka vlerësuar si të dhënë hua. Komisioni duhet të kishte përfshirë të ardhurat e ligjshme për çdo vit ose në momentet që ka bërë investimet. Mënyra si është nxjerrë analiza, për vitet e dhënies dhe marrjes së shumave të huas, ka paqartësi dhe pasaktësi, të cilat vijnë si pasojë e mosarsyetimit dhe mungesës së analizës së detajuar. Subjekti është i paqartë e nuk arrin të kuptojë rezultatin total të diferencës negative pa pasur një analizë të detajuar.

44.1. Trupi gjykues, në vlerësim të këtyre pretendimeve, në mbështetje të arsyetimit në këtë vendim, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën për të verifikuar situatën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për periudhën 2003-2016, rezultatet e të cilës treguan mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive,

<sup>57</sup> Me kontratë sipërmarrje të nënshkruar nga R. H. dhe shoqëria ndërtimore “{\*\*\*}” ShPK më datë 23.01.2016.

për shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara në vlerën (-) 11.947.121 lekë. Edhe nëse në analizë do të përfshiheshin të ardhurat nga tokat bujqësore dhe ato nga puna e bashkëshortes në Institutin e Kulturës Italiane, si deklaruar në deklaratat e interesave privatë periodikë, përsëri diferenca do të rezultonte në vlerën (-) 8.527.122 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

45. Në këto kushte, trupi gjykues në Kolegj, mbështetur në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë.
46. Lidhur me zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si rrjedhojë e vlerësimit tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2 e po këtij ligji, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, subjekti ka ngritur disa pretendime në ankim dhe në parashtrimet në Kolegj. Në vlerësim të tij: (i) rastet e shkarkimit të magjistratit janë të parashikuar në mënyrë shteruese në Kushtetutë dhe nuk mund të shtohen me ligj. Neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 është dispozitë antikushtetuese, pasi nuk është parashikuar në Kushtetutë dhe as deleguar prej saj. Termi “besim i publikut” është evaziv dhe i papërkufizuar në ligj; (ii) e gjen të paarsyetuar vendimin e Komisionit, sa i përket lidhjes së tij me publikun; (iii) neni 48 i ligjit nr. 84/2016 është një dispozitë procedurale që ndikon në mënyrën e vlerësimit të deklarimeve të subjektit, por nuk sjell masë disiplinore. Subjekti ka të drejtën e heshtjes, e cila nuk mund të sjell penalizim, të drejtë të cilën subjekti nuk e shfrytëzoi në këtë hetim administrativ, por dha pohim për faktet; (iv) përdor si argument qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në jurisprudencën<sup>58</sup> e tij për zbatimin e parimit të mosndëshkimit dy herë për të njëjtën shkelje. Trupi gjykues, vlerëson se:

46.1. Në kuptim të dispozitave kushtetuese e ligjore, cenimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, i formësuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që parashikon shkarkimin nga detyra nëse rezulton se subjekti ndodhet në këtë situatë ligjore, vjen si zbërthim i nevojës për të cilën u krijua sistemi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, që gjen vend në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës dhe parashikon qëllimin e ligjit nr. 84/2016 në nenin 1 të tij. Në këto kushte pretendimi i subjektit për antikushtetueshmërinë e kësaj dispozite, është i pabazuar. Mospërkufizimi në ligj i termit “besim i publikut” nuk e bën evaziv këtë term, pasi veprimet dhe mosveprimet e një gjyqtari kundrejt zbatimit të ligjit gjatë ushtrimit të detyrës dhe jashtë saj, si dhe gjatë procesit të rivlerësimit duhet të tregojnë nivelin më të lartë të përgjegjshmërisë personale dhe profesionale, në drejtim të rritjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe dhënies së një shembulli të mirë.

46.2. Ligjvënësi, në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikoi të drejtën e Komisionit dhe Kolegjit, në kuadër të këtij procesi për të marrë vendime, jo vetëm bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, por edhe në vlerësimin tërësor të procedurave, duke paraparë në nenin 48 të këtij ligji se gatishmëria dhe sjellja e subjektit të rivlerësimit gjatë këtij procesi mbahen parasysh nga këto organe në marrjen e vendimit. Në këto kushte, cenimi i besimit të publikut, që passjell dhe zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, vjen në harmoni me dispozitat e sipërcituara të këtij ligji, nëse ndodhemi përpara një sjellje jo korrekte të subjekteve të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit. Situata faktike në rastin objekt shqyrtimi nuk është në të njëjtat kushte me rastin kur Kolegji ka zbatuar parimin e mosndëshkimit dy herë për të njëjtën shkelje, pasi në këtë rast zbatimi i nenit 61, pika 5 e

---

<sup>58</sup> *Shih vendimin nr. 21, datë 15.07.2021, paragrafi 100, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Hysni Vata.*

ligjit nr. 84/2016 nuk ka të bëjë me shkelje ligjore të subjektit gjatë periudhës së rivlerësimit, por me sjelljen e tij gjatë procesit të rivlerësimit. Nga ana tjetër, duket sikur subjekti konfondon këtë proces të natyrës administrative, në të cilin barra e provës parashikohet si detyrim ligjor i subjektit e ku vendimmarrja bazohet në hetimin kryesisht të Komisionit, si dhe shpjegimet dhe provat e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, me procesin penal, ku janë të aplikueshme e drejta për të heshtur apo ndalimi i vetinkriminimit.

**46.3.** Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit, përveçse nuk është treguar bashkëpunues mbi informacionin e kërkuar nga Komisioni, në kuadër të hetimit administrativ përgjatë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur në disa raste se nuk mban mend apo nuk disponon dokumentacion, nuk ka treguar një sjellje korrekte gjatë procesit të rivlerësimit, veprimet e tij të krijojnë bindjen se nuk kanë pasur për qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, por zvarritjen e këtij procesi, deri në pamundësimin e tij, gjë që konstatohet dukshëm me kërkesat në mënyrë të vazhdueshme, të përsëritura dhe haptazi të pabazuara, para dhe gjatë seancave dëgjimore të datave 14.09.2020 dhe 15.09.2020. Në çdo rast, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të paraqesë kërkesa procedurale të bëra në kuadër të këtij procesi, por jo ato të cilat dukshëm kalojnë kufirin e ligjores për të rënë në abuzivitet.

**46.4.** Trupi gjykues sjell në vëmendje kërkesat e subjektit të rivlerësimit, përpara dhe gjatë seancave dëgjimore, të rrëzuara me të drejtë nga Komisioni si të pabazuara, konkretisht, kërkesën për shtyrjen e seancës dëgjimore të datës 10.09.2020, dy ditë përpara zhvillimit të saj, të pashoqëruar me provë shkresore e, pas refuzimit të saj, subjekti paraqet një kërkesë tjetër të shoqëruar këtë radhë me raport mjekësor. Për të vijuar, më pas, me kërkesën verbale në fillim të seancës dëgjimore të datës 14.09.2020, për shtyrjen e saj për një afat kohor 3 muaj, në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, për të pasur mundësi të paraqesë provat e nevojshme dhe kthimin në gjendje normale shëndetësore. Pas refuzimit të kësaj kërkesë nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit paraqet një tjetër kërkesë, këtë radhë lidhur me mënyrën e organizimit të ONM-së, mënyrën e zgjedhjes së vëzhguesve ndërkombëtarë, mandatin dhe zëvendësimin e tyre, për të cilën u sqarua gjatë seancës nga vëzhguesi ndërkombëtar. Për të vijuar, më tej, me kërkesën e tij “Gjykim nga një trup gjykues i formuar sipas ligjit”, lidhur me përhershmerinë e përbërjes së trupit gjykues të Komisionit, për të cilën u vendos refuzimi si e pabazuar e saj. Subjekti i rivlerësimit vijoi me paraqitjen e kërkesës me 17 pika, për të cilat më herët kishte marrë vendim të arsyetuar nga Komisioni. Më pas, subjekti i rivlerësimit paraqet kërkesë tjetër me shkrim duke kërkuar përjashtimin e tre komisionerëve të trupit gjykues. Gjithashtu, gjatë seancës dëgjimore të datës 15.09.2020, pasi relatorja e çështjes kishte mbaruar relatimin dhe subjekti i rivlerësimit ishte pothuajse në përfundim të parashtrimeve, prej tij, u paraqit kërkesa për përjashtimin nga trupa gjykuese të kryesueses, me arsyetimin se sapo ishte vënë në dijeni të një rrethane të re, lidhur me procedurat e zgjedhshmërisë së saj.

**46.5.** Nga aktet në fashikullin gjyqësor, rezulton se shorti për përcaktimin e trupit gjykues në Komision, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Tritan Hamitaj, është zhvilluar më datë 15.03.2019 dhe subjekti i rivlerësimit në komunikimet elektronike me Komisionin, në asnjë rast deri në datën 14.09.2020, nuk ngriti pretendimin lidhur me ligjshmërinë e trupit gjykues të Komisionit të shortuar për të shqyrtuar çështjen e tij, por e ngriti pas një viti e gjysmë. Mosserioziteti i treguar nga subjekti i rivlerësimit është i dukshëm dhe në mënyrën e paraqitjes së kërkesave paraprake një e nga një, duke e bërë trupin gjykues të Komisionit të ndërpriste disa herë seancën e të tërhiqej për shqyrtimin e tyre. Këtë tendencë, për të ngritur kërkesa të pajustificuara e të pabazuara, subjekti i rivlerësimit e ka treguar edhe ndaj Kolegjit, duke paraqitur kërkesa të ndryshme: për përjashtimin e secilit anëtar të trupit gjykues të caktuar për gjykimin e kësaj çështjeje; kërkesat e parashtruara në paragrafët 10.1 dhe 10.2 të këtij vendimi; kërkesa për konstatimin e paligjshmërisë së trupave gjykues në Komision dhe Kolegj; kërkesa



për pezullimin e shqyrtimit të çështjes në Kolegj, etj. Përveç të tjerave, me parashtrimet e datës 10.01.2023, subjekti ka pretenduar se trupi gjykues i Kolegjit është përzgjedhur në kundërshtim me nenin 69, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 19 të Rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, duke parashtruar se nga ana e Kolegjit nuk janë dhënë argumente apo arsye objektive për hedhjen e shortit në mënyrë manuale dhe jo nëpërmjet sistemit të integruar të çështjeve e duke kërkuar, gjithashtu, rihedhjen e çështjes përsëri në short. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se caktimi i trupit gjykues, për shqyrtimin e kësaj çështjeje në Kolegj, është realizuar në përputhje me ligjin dhe në asnjë rast nuk cenon parimet e një procesi të rregullt ligjor, siç pretendon subjekti.

46.6. Në përfundim të sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit, për vlerësimin tërësor të procedurave të parashikuara nga neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 e, për rrjedhojë, zbatimin e nenit 6, pika 5 të këtij ligji, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

47. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 297, datë 17.09.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 297, datë 17.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Tritan Hamitaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 06.02.2023.

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*